

(Akte legislative)

RREGULLORE

RREGULLORE (BE) 2016/679 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT

e datës 27 prill 2016

Mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Direktivës 95/46/EC (Rregullore e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave)

(Tekst me rëndësinë e EEA-së)

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN

Duke pasur parasysh Traktatin mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian dhe veçanërisht Nenin 16 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit Evropian,

Pas transmetimit të projekt aktit legjislativ tek parlamentet kombëtare,

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian (1), Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit të Rajoneve (2),

Duke vepruar në pajtim me procedurën e zakonshme legislative (3),

Ndërsa:

(1) Mbrojtja e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale është një e drejtë themelore. Neni 8(1) i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ('Karta') dhe Neni 16(1) i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) parashikojnë që kushdo ka të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me të.

(2) Parimet dhe rregullat për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave

të tyre personale, pavarësisht shtetësisë ose vendbanimit të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë e tyre themelore, veçanërisht të drejtën e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo Rregullore synon të kontribuojë në realizimin e një sfere lirie, sigurie dhe drejtësie dhe të një bashkimi ekonomik, në përparimin ekonomik dhe social, në fuqizimin dhe konvergjencën e ekonomive brenda tregut të brendshëm dhe në mirëqenien e personave fizikë.

(3) Direktiva 95/46/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (4) synon të harmonizojë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë në lidhje me aktivitetet e përpunimit dhe të sigurojë fluksin e lirë të të dhënave personale ndërmjet Shteteve Anëtare.

(4) Përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë në shërbim të njerëzimit. E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale nuk është një e drejtë absolute; ajo duhet të konsiderohet në lidhje me funksionin e saj në shoqëri dhe të balancohet kundrejt të drejtave të tjera themelore, në pajtim me parimin e proporcionalitetit. Kjo Rregullore respekton të gjitha të drejtat themelore dhe merr parasysh liritë dhe parimet e njohura në Kartën siç konkretizohen në Traktate, veçanërisht respektimin e jetës private dhe familjare, banesës dhe komunikimeve, mbrojtjen e të dhënave personale, lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, lirinë e shprehjes dhe informimit, lirinë për të bërë biznes, të drejtën për mbrojtje të efektshme dhe gjykim të drejtë dhe diversitetin kulturor, fetar dhe gjuhësor.

(5) Integrimi ekonomik dhe social që rrjedh nga funksionimi i tregut të brendshëm ka sjellë si rezultat një rritje thelbësore të fluksit ndërkufitar të të dhënave personale. Shkëmbimi i të dhënave personale ndërmjet aktorëve publikë dhe privatë, duke përfshirë personat fizikë, shoqatat dhe sipërmarrjet në të gjithë Bashkimin është rritur. Autoriteteve të brendshme në Shtetet Anëtare u kërkohet nga e drejta e Bashkimit të bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë të dhëna personale për të qenë në gjendje të përmbushin detyrat e tyre ose të përmbushin detyra të tjera në emër të një autoriteti në një Shtet tjetër Anëtar.

(6) Zhvillimet e shpejta teknologjike dhe globalizimi kanë sjellë sfida të reja për mbrojtjen e të dhënave personale. Shkalla e mbledhjes dhe e shkëmbimit të të dhënave personale është rritur në masë të konsiderueshme. Teknologjia u lejon shoqërive private dhe autoriteteve publike të përdorin të dhënat personale në një masë të paprecedentë me qëllim që të përmbushin aktivitetet e tyre. Personat fizikë gjithmonë e më shumë ofrojnë informacion personal publikisht dhe globalisht. Teknologjia ka transformuar si ekonominë dhe jetën sociale dhe duhet të lehtësojë më tej lëvizjen e lirë të të dhënave personale brenda Bashkimit dhe transferimin tek vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, duke siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale.

(7) Këto zhvillime kërkojnë një kuadër të fuqishëm dhe më koherent për mbrojtjen e të dhënave në Bashkim, të mbështetur nga një ekzekutim i fuqishëm, duke ditur rëndësinë e krijimit të besimit që do të lejojë ekonominë digjitale të zhvillohet në të gjithë tregun e brendshëm. Personat fizikë duhet të kenë kontroll mbi të dhënat e tyre personale. Siguria ligjore dhe praktike për personat fizikë, operatorët ekonomikë dhe autoritetet publike duhet të fuqizohet.

(8) Nëse kjo Rregullore parashikon specifikime ose kufizime të rregullave të saj nga e drejta e Shteteve Anëtare, Shtetet Anëtare, në masën që është e nevojshme për koherencën dhe për ti bërë dispozitat e brendshme të kuptueshme për personat për të cilët ato zbatohen, i përfshijnë elementët e kësaj Rregulloreje në të drejtën e tyre të brendshme.

(9) Objektivat dhe parimet e Direktivës 95/46/BE mbeten të vlefshme, por ajo nuk ka parandaluar fragmentimin në zbatimin e mbrojtjes së të dhënave në mbarë Bashkimin, pasigurinë ligjore ose një perceptim të gjerë publik që ka rreziqe të konsiderueshme për mbrojtjen e personave fizikë, veçanërisht në lidhje me aktivitetin e tyre *online*. Diferencat në nivelin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të personave fizikë, veçanërisht e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në Shtetet Anëtare mund të pengojnë fluksin e lirë të të dhënave personale në mbarë Bashkimin. Ato diferenca mund të përbëjnë një pengesë për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në nivelin e Bashkimit, deformojnë konkurrencën dhe pengojnë autoritetet në përmbushjen e përgjegjësisive sipas së drejtës së Bashkimit. Një diferencë e tillë në nivelet e mbrojtjes është për shkak të ekzistencës së diferencave në realizimin dhe zbatimin e Direktivës 95/46/BE.

(10) Me qëllim që të garantohet një nivel i njëtrajtshëm dhe i lartë i mbrojtjes së personave fizikë dhe të hiqen pengesat e fluksit të të dhënave personale brenda Bashkimit, niveli i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të personave fizikë në lidhje me përpunimin e këtyre të dhënave duhet të jetë i barasvlershëm në të gjithë Shtetet Anëtare. Zbatimi i njëtrajtshëm dhe homogjen i rregullave për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale duhet të garantohet në mbarë Bashkimin. Në lidhje me përpunimin e të dhënave personale për përmbushjen e një detyrimi ligjor, për kryerjen e një detyre që bëhet në interes publik ose në përmbushje të autoritet zyrtar që i është caktuar kontrolluesit, Shteteve Anëtare duhet t'u lejojë të mbajnë ose prezantojnë dispozita të brendshme për të specifikuar më tej zbatimin e rregullave të kësaj Rregulloreje. Në lidhje me të drejtën e përgjithshme dhe horizontale për mbrojtjen e të dhënave që zbaton Direktivën 95/46/BE, Shtetet Anëtare kanë disa ligje specifike sipas sektorëve në sferat që kërkojnë më shumë dispozita specifike. Kjo Rregullore ofron gjithashtu një marzh diskrecioni për Shtetet Anëtare për të specifikuar rregullat e saj, duke përfshirë përpunimin e kategorive të veçanta të të dhënave personale ('të dhëna sensitive'). Në këtë masë, kjo Rregullore nuk e përjashton të drejtën e Shtetit Anëtar që përcakton rrethanat për situata specifike të përpunimit, duke përfshirë përcaktimin më saktë të kushteve në të cilat është i ligjshëm përpunimi i të dhënave personale.

(11) Mbrojtja e efektshme e të dhënave personale në të gjithë Bashkimin kërkon fuqizimin dhe përcaktimin me hollësi të të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe të detyrimeve të atyre që përpunojnë dhe përcaktojnë përpunimin e të dhënave personale, si dhe kompetenca të njëjta për monitorimin dhe sigurimin e respektimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sanksione të njëjta për shkeljet në Shtetet Anëtare.

(12) Neni 16(2) TFBE autorizon Parlamentin Evropian dhe Këshillin të vendosin rregulla në lidhje me mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe rregulla në lidhje me lëvizjen e lirë të të dhënave personale.

(13) Me qëllim që të garantohet një nivel i njëtrajtshëm i mbrojtjes për personat fizikë në të gjithë Bashkimin dhe për të parandaluar divergjencat që pengojnë lëvizjen e lirë të të dhënave personale brenda tregut të përbashkët, një Rregullore është e nevojshme për të dhënë siguri ligjore dhe transparencë për operatorët ekonomikë, duke përfshirë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, dhe për tu dhënë personave fizikë në të gjithë Shtetet Anëtare të njëjtin nivel për të drejtat e zbatueshme ligjrisht dhe detyrime dhe përgjegjësitë e kontrolluesve dhe përpunuesve, për të siguruar një monitorim të njëtrajtshëm për përpunimin e të dhënave personale, dhe sanksione të njëjta në të

gjitha Shtetet Anëtare, si dhe bashkëpunim të efektshëm ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse të Shteteve të ndryshme Anëtare. Funksionimi i duhur i tregut të brendshëm kërkon që lëvizja e lirë e të dhënave personale brenda Bashkimit Evropian të mos kufizohet ose ndalohe për shkaqe që kanë të bëjnë me mbrojtjen e personave fizikë për sa i takon përpunimit të të dhënave personale. Duke marrë parasysh situatën specifike të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, kjo Rregullore përfshin një shmangie për organizatat me më pak se 250 punëtorë për sa i takon mbajtjes së regjistrave. Përveç kësaj institucionet dhe organet e Bashkimit dhe Shtetet Anëtare dhe autoritetet e tyre mbikëqyrëse inkurajohen të marrin parasysh nevojat specifike të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në zbatimin e kësaj Rregulloreje. Koncepti i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme duhet të rrjedhë nga Neni 2 i Aneksit të Rekomandimit të Komisionit 2003/361/EC(5).

(14) Mbrojtja e ofruar nga kjo Rregullore duhet të zbatohet për personat fizikë, cilado qoftë shtetësia e tyre apo vendimi banimit, në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale. Kjo Rregullore nuk mbulon përpunimin e të dhënave personale që ka të bëjë me personat juridikë dhe veçanërisht ndërmarrjet e krijuara si persona juridikë, duke përfshirë emrin dhe formën e personit juridik dhe të dhënat e kontaktit të personit juridik.

(15) Për të parandaluar rrezikun serioz të anashkalimit, mbrojtja e personave fizikë nuk duhet të ndikohet nga teknologjia dhe të mos varet nga teknikat e përdorura. Mbrojtja e personave fizikë duhet të zbatohet për përpunimin e të dhënave personale me mjete automatike, si dhe në përpunimin manual, nëse të dhënat personale gjenden ose janë të destinuara të gjenden në një sistem skedimi. Dosjet ose kompletet e dosjeve si dhe dokumentet e tyre shoqëruese, të cilat nuk janë strukturuar sipas kriterëve specifike nuk duhet të përfshihen në objektin e kësaj Rregulloreje.

(16) Kjo Rregullore nuk zbatohet për çështjet e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore ose fluksin e lirë të të dhënave personale në lidhje me aktivitetet që dalin jashtë objektivit të së drejtës së Bashkimit, siç janë aktivitetet në lidhje me sigurinë kombëtare. Kjo Rregullore nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nga shtetet Anëtare gjatë kryerjes së aktivitetëve në lidhje me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së Bashkimit.

(17) Rregullorja (EC) Nr 45/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (7) zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit. Rregullorja (EC) Nr 45/2001 dhe aktet e tjera ligjore të Bashkimit të zbatueshme për këtë përpunim të të dhënave personale duhet të përshtatet me parimet dhe rregullat e përcaktuara në këtë Rregullore dhe të zbatohet në pajtim me këtë Rregullore. Me qëllim që të shërbejë si një kuadër i fuqishëm dhe koherent i mbrojtjes së të dhënave, pas miratimit të kësaj Rregulloreje duhet të pasojnë përshtatjet e nevojshme të Rregullores (EC) Nr 45/2001, me qëllim që të lejojnë zbatimin në të njëjtën kohë si edhe kjo Rregullore.

(18) Kjo Rregullore nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nga një person fizik në kuadrin e një aktiviteti thjesht personal apo familjar dhe në këtë mënyrë nuk ka lidhje me një aktivitet profesional ose tregtar. Aktivitetet personale ose familjare mund të përfshinin korrespondencën dhe mbajtjen e adresave, ose rrjetet sociale dhe aktivitetin *online* të ndërmarra në kontekstin e këtyre aktivitetëve. Megjithatë, kjo Rregullore zbatohet për kontrolluesit ose përpunuesit që ofrojnë mjetet për përpunimin e të dhënave personale për këto aktivitete personale ose familjare.

(19) Mbrojtja e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllimet e parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë garantimin dhe parandalimin e kërcënimeve për sigurinë publike dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave është objekti i një akti specifik ligjor të Bashkimit. Kështu, kjo Rregullore nuk zbatohet për aktivitetet përpunuese për këto qëllime. Megjithatë, të dhënat personale të përpunuara nga autoritetet publike sipas kësaj Rregulloreje, nëse përdoren për ato qëllime, rregullohen nga një akt ligjor më specifik i Bashkimit, që është Direktiva (BE) 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (7). Shtetet Anëtare mund tu ngarkojnë autoriteteve kompetente në kuptimin e Direktivës (BE) 2016/680 detyra që nuk kryhen domosdoshmërisht me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale të veprave penale ose të ekzekutimit të dënimeve penale, duke përfshirë garantimin dhe parandalimin e kërcënimit të rendit publik, në mënyrë që përpunimi i të dhënave personale për këto qëllime të tjera, për sa kohë është në objektin e së drejtës së Bashkimit, përfshihet në objektin e kësaj Rregulloreje.

Në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga ato autoritete kompetente për qëllimet që përfshihen në objektin e kësaj Rregulloreje, Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të ruajnë ose të prezantojnë dispozita më specifike për të përshtatur zbatimin e rregullave të kësaj Rregulloreje. Këto dispozita mund të përcaktojnë më saktë kërkesat specifike për përpunimin e të dhënave personale nga ato autoritetet kompetente për ato qëllime të tjera, duke marrë parasysh strukturën kushtetuese, organizative dhe administrative të Shteteve Anëtare përkatëse. Nëse përpunimi i të dhënave personale nga organet private futet në objektin e kësaj Rregulloreje, kjo Rregullore duhet të parashikojë mundësinë për Shtetet Anëtare në kushte specifike për të kufizuar me ligj detyrime dhe të drejta të caktuara kur një kufizim i tillë përbën një masë të nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike për të garantuar interesat e rëndësishëm specifikë duke përfshirë sigurinë publike dhe parandalimin, hetimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë garantimin dhe parandalimin e kërcënimeve për rendin publik. Për shembull, kjo është e rëndësishme në kuadrin e aktiviteteve kundër pastrimit të parave ose të laboratorëve të mjekësisë ligjore.

(20) Ndërmjet të tjerash, kjo Rregullore zbatohet për aktivitetet e gjykatave ose autoriteteve të tjera gjyqësore, e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar mund të specifikojë operacionet përpunuese dhe procedurat përpunuese në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga gjykatat dhe organet e tjera gjyqësore. Kompetenca e autoriteteve mbikëqyrës nuk duhet të përfshijë përpunimin e të dhënave personale nëse gjykatat veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore, me qëllim që të garantojnë pavarësinë e gjyqësorit në përmbushjen e detyrave gjyqësore, duke përfshirë vendimmarrjen. Duhet të jetë e mundur që mbikëqyrja e këtyre operacioneve për përpunimin e të dhënave tu ngarkohet organeve specifike brenda sistemit gjyqësor të Shtetit Anëtar, i cili, veçanërisht për të garantuar respektimin e rregullave të kësaj Rregulloreje, duhet të fuqizojë ndërgjegjësimin ndërmjet anëtarëve të gjyqësorit për detyrimet e tyre sipas kësaj Rregulloreje dhe të trajtojnë ankesat në lidhje me këto operacione për përpunimin e të dhënave.

(21) Kjo Rregullore nuk cenon zbatimin e Direktivës 2000/31/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (8), veçanërisht në lidhje me rregullat për përgjegjësinë e ofruesve të shërbimit ndërmjetës në Nenin 12 deri 15 të kësaj Direktive. Kjo Direktivë synon të kontribuojë në funksionimin e duhur të tregut të brendshëm duke garantuar lëvizjen e lirë të shërbimeve të shoqërisë së informacionit ndërmjet Shteteve Anëtare.

(22) Çdo përpunim i të dhënave personale në kontekstin e aktiviteteve të një strukture të një kontrolluesi ose përpunuesi në Bashkim duhet të kryhet në pajtim me këtë Rregullore, pavarësisht nëse përpunimi kryhet brenda Bashkimit. Struktura nënkupton ushtrimin e efektshëm dhe real të aktivitetit nëpërmjet masave të qëndrueshme. Forma ligjore e këtyre masave, nëpërmjet një dege apo nëpërmjet një filiali me personalitet juridik, nuk është faktori përcaktues në këtë aspekt.

(23) Për të garantuar që personave fizikë nuk u hiqet mbrojtja që u takon atyre sipas kësaj Rregulloreje, përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave që ndodhen brenda Bashkimit nga një kontrollues ose përpunues që nuk është i vendosur në Bashkim duhet ti nënshtrohet kësaj Rregulloreje nëse aktivitetet përpunuese lidhen me ofrimin e mallrave ose shërbimeve për këto subjekte të dhënash pavarësisht nëse kanë të bëjnë me një pagesë. Për të përcaktuar nëse një kontrollues ose përpunues i tillë ofron mallra ose shërbime për subjektet e të dhënave që janë brenda Bashkimit, duhet të konstatohet nëse është e dukshme që kontrolluesi ose përpunuesi synon ofrimin e shërbimeve për subjektet e të dhënave në një ose më shumë Shtete Anëtare në Bashkim. Ndërsa thjesht mundësia për të hyrë në faqen e internetit të kontrolluesit, përpunuesit ose ndërmjetësit në Bashkim, në një adresë elektronike ose në të dhënat e tjera të kontaktit, ose përdorimi i një gjuhe që përdoret përgjithësisht në një vend të tretë ku është vendosur kontrolluesi është e pamjaftueshme për të konstatuar një synim të tillë, faktorë të tillë si përdorimi i një gjuhe ose e një monedhe që përdoret gjerësisht në një ose më shumë Shtete Anëtare me mundësinë e porosisë së mallrave dhe shërbimeve në atë gjuhë tjetër, ose përmendja e klientëve ose përdoruesve që gjenden në Bashkim mund ta bëjnë të dukshme që kontrolluesi synon ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për këta subjekte të dhënash në Bashkim.

(24) Përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave që janë në Bashkim nga një kontrollues ose përpunues që nuk është i vendosur në Bashkim duhet ti nënshtrohet kësaj Rregulloreje nëse kjo ka të bëjë me monitorimin e sjelljes së këtyre subjekteve të të dhënave në masën që sjellja e tyre kryhet brenda Bashkimit. Me qëllim që të përcaktohet nëse një aktivitet përpunues mund të konsiderohet se monitoron sjelljen e subjekteve të të dhënave, duhet të konstatohet nëse personat fizikë gjurmohen në internet duke përfshirë përdorimin e mëvonshëm të mundshëm të teknikave përpunuese të të dhënave personale që konsistojnë në ngritjen e një profili për një person fizik, veçanërisht për të marrë vendime në lidhje me të ose për të analizuar apo parashikuar preferencat, sjelljet dhe qëndrimet e tij ose të saj personale.

(25) Nëse e drejta e një Shteti Anëtar zbatohet bazuar në të drejtën ndërkombëtare publike, duhet të zbatohet edhe kjo Rregullore për një kontrollues që nuk është i vendosur brenda Bashkimit, si ai në një mision diplomatik apo zyrë konsullore e një Shteti Anëtar.

(26) Parimet e mbrojtjes së të dhënave duhet të zbatohen për çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm. Të dhënat personale që i janë nënshtuar anonimizimit, të cilat mund ti visheshin një personi fizik nëpërmjet përdorimit të një informacioni shtesë, duhet të konsiderohen si informacion për një person fizik të identifikueshëm. Për të përcaktuar nëse një person fizik është i identifikueshëm, duhet të merren parasysh të gjitha mjetet që normalisht mund të përdoren, si veçimi, qoftë nga kontrolluesi apo një person tjetër për të identifikuar personin fizik drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë. Për të përcaktuar nëse mjetet janë normalisht të përshtatshme për tu përdorur për identifikimin e personit fizik, duhet të merren parasysh të gjithë

faktorët objektivë, sikkosto dhe sasia e kohës që kërkohet për identifikimin, duke marrë parasysh teknologjinë e disponueshme në momentin e përpunimit dhe zhvillimet teknologjike. Parimet e mbrojtjes së të dhënave nuk duhen përdorur për informacionin anonim, që është informacioni i cili nuk lidhet me një person fizik të identifikueshëm ose të identifikuar ose me të dhënat personale të bëra anonime në një mënyrë të tillë që subjekti i të dhënave nuk është ose nuk vazhdon të jetë i identifikueshëm. Kjo Rregullore nuk ka të bëjë me përpunimin e atij informacioni anonim, duke përfshirë atë për qëllimet statistikore ose kërkimore.

(27) Kjo Rregullore nuk zbatohet për të dhënat personale të personave të vdekur. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë rregulla në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të personave të vdekur.

(28) Zbatimi i pseudonimizimit për të dhënat personale mund të ulë rreziqet për subjektet përkatës të të dhënave dhe mund të ndihmojë kontrolluesit dhe përpunuesit për të përmbushur detyrimet e tyre për mbrojtjen e të dhënave. Prezantimi shprehimisht i ‘anonimizimit’ në këtë Rregullore nuk synon të përjashtojë masat e tjera për mbrojtjen e të dhënave.

(29) Me qëllim që të krijohen shtysa për zbatimin e anonimizimit gjatë përpunimit të të dhënave personale, masat e anonimizimit, ndërkohë që lejojnë analizën e përgjithshme, duhet të jenë të mundshme brenda të njëjtit kontrollues nëse ka kontrollues ka marrë masat teknike dhe organizative të nevojshme për të garantuar, për përpunimin përkatës, që kjo Rregullore të zbatohet dhe që informacioni shtesë për ndërlidhjen e të dhënave personale me një subjekt konkret të të dhënave të mbahet veçmas. Kontrolluesi që përpunon të dhënat personale duhet të tregojë personat e autorizuar tek ai kontrollues.

(30) Personat fizikë mund të bashkërenditen me identifikues online të dhëna nga aparatet, aplikimet, mjetet dhe protokollat e tyre, si adresat e protokollit në internet, identifikuesit cookie, ose identifikues të tjerë i identifikuesit e frekuencave të radios. Kjo mund të lërë gjurmë që, veçanërisht nëse kombinohen me identifikuesit unikë dhe informacionin tjetër të marrë nga serverat, mund të përdoret për krijimin e profileve të personave fizikë dhe të identifikojë ata.

(31) Autoritetet publike të cilëve u deklarohen të dhënat personale në përmbushje të një detyrimi ligjor për ushtrimin e misionit të tyre zyrtar, si autoritetet tatimore dhe doganore, njësitë e hetimit financiar, autoritetet e pavarura administrative, ose autoritetet e tregut financiar përgjegjëse për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të letrave me vlerë nuk duhet të konsiderohen si marrës nëse ata marrin të dhëna personale që janë të nevojshme për të kryer një hetim të caktuar në interesin e përgjithshëm, në pajtim me të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar. Kërkesat për deklarim të dërguara nga autoritetet publike duhet të jenë gjithmonë me shkrim, të arsyetuara dhe konkrete dhe nuk duhet të kenë të bëjnë me tërësinë e sistemit të skedimit ose të çojnë në ndërlidhjen e sistemeve të skedimit. Përpunimi i të dhënave personale nga këto autoritete publike duhet të respektojë rregullat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave sipas qëllimit të përpunimit.

(32) Pëlqimi duhet të jepet nëpërmjet një veprimi pohues dhe të qartë që tregon një shprehje të dhënë lirisht, të informuar dhe të qartë të pëlqimit të subjektit të të dhënave për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të, si nëpërmjet një deklarimi me shkrim, duke përfshirë nëpërmjet mjeteve elektronike, ose nëpërmjet një deklarimi gojor. Kjo mund të përfshijë shënjimin në një vend të caktuar gjatë hyrjes në një faqe interneti, duke zgjedhur specififikimet teknike për shërbimet e

shoqërisë së informacionit ose një deklaramin aposjellje tjetër që tregon qartazi në këtë kontekst pranimin nga subjekti i të dhënave i përpunimit të propozuar të të dhënave të tij ose të saj personale. Heshtja, fushat e para-shënjuara ose mosveprimi nuk konsiderohen dhënie pëlqimi. Pëlqimi duhet të mbulojë të gjitha aktivitetet përpunuese që kryhen për të njëjtin qëllim ose qëllime. Nëse përpunimi ndjek disa qëllime, pëlqimi duhet të jepet për të gjitha ato. Nëse pëlqimi i subjektit të të dhënave duhet të jepet pas një kërkese me mjete elektronike, kërkesa duhet të jetë e qartë, koncize dhe jo-penguese për përdorimin e shërbimit për të cilin jepet.

(33) Shpesh nuk është e mundur të identifikohet plotësisht qëllimi i përpunimit të të dhënave personale për qëllime të kërkimit shkencor në momentin e mbledhjes së të dhënave. Kështu, subjektet e të dhënave duhet të lejohen të japin pëlqimin e tyre për sfera të caktuara të kërkimit shkencor nëse kjo është në pajtim me standardet e njohura etike për kërkim shkencor. Subjektet e të dhënave duhet të kenë mundësinë për të dhënë pëlqimin e tyre vetëm për sfera të caktuara të kërkimit ose pjesë të projekteve të kërkimit në masën e lejuar nga qëllimi i synuar.

(34) Të dhënat gjenetike duhet të përkufizohen si të dhëna personale në lidhje me karakteristikat gjenetike të trashëguara ose të përfutuara të një personi fizik që rezulton nga analiza e një kampioni biologjik të personit fizik në fjalë, veçanërisht analizën kromozomale, nga acidi dezoksiribonukleik (ADN) ose nga acidi ribonukleik (ARN), ose nga analiza e një elementi tjetër që mundëson marrjen e informacionit të barasvlershëm.

(35) Të dhënat personale në lidhje me shëndetin duhet të përfshijnë të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me gjendjen shëndetësore të një subjekti të dhënash që tregojnë informacionin në lidhje me gjendjen shëndetësore fizike dhe mendore të shkuar, të tashme ose të ardhme të subjektit të të dhënave. Kjo përfshin informacionin në lidhje me personin fizik të marrë në kuadrin e regjistrimit ose dhënies së shërbimeve të kujdesit shëndetësor sipas referimit në Direktivën 2011/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (1) atij personi fizik; një numër, simbol ose hollësi e caktuar një personi fizik për të unifikuar në mënyrë unike personin fizik për qëllime shëndetësore; informacioni i marrë nga testimi ose vizita e një pjese të trupit ose substance të trupit, duke përfshirë nga të dhënat gjenetike dhe kampionët biologjikë; dhe çdo informacion, për shembull, në lidhje me një sëmundje, paaftësi, rrezik serioz, sëmundje të mëparshme, trajtim mjekësor ose gjendje fiziologjike ose bio-mjekësore të subjektit të të dhënave pavarësisht nga burimi, për shembull nga një mjek ose një profesionist tjetër i shëndetit, një spital, aparat mjekësor ose një testim diagnostikues in vitro.

(36) Selia qendrore e një kontrolluesi në Bashkim duhet të jetë vendimi i administratës së tij qendrore në Bashkim, përveç kur vendimet për qëllimet dhe mjetet e përpunimit të të dhënave personale merren në një seli tjetër të kontrolluesit në Bashkim, rast në të cilin ajo seli tjetër duhet të konsiderohet të jetë selia kryesore. Selia kryesore e një kontrolluesi në Bashkim duhet të përcaktohet sipas kriterëve objektive dhe duhet të nënkuptojnë ushtrimin efektiv dhe real të aktiviteteve menaxheriale që diktojnë vendimet kryesore në lidhje me qëllimet dhe mjetet e përpunimit nëpërmjet masave të qëndrueshme. Ky kriter nuk duhet të varet nëse përpunimi i të dhënave personale kryhet në atë vendndodhje. Prania dhe përdorimi i mjeteve teknike dhe teknologjive për përpunimin e të dhënave personale ose aktivitetet përpunuese, në vetvete, nuk përbëjnë selinë kryesore dhe në këtë mënyrë nuk janë kritere përcaktuese për një seli kryesore. Selia kryesore e përpunuesit duhet të jetë vendi i administratës së tij qendrore në Bashkim ose, nëse ai nuk ka administratë qendrore në Bashkim, vendi ku zhvillohen në Bashkim aktivitetet kryesore përpunuese. Në rastet e përfshirjes së

kontrolluesit dhe përpunuesit, autoriteti kompetent drejtues dhe mbikëqyrës duhet të mbetet autoriteti mbikëqyrës i Shtetit Anëtar ku kontrolluesi ka selinë e tij kryesore, por autoriteti mbikëqyrës i përpunuesit duhet të konsiderohet të jetë autoriteti mbikëqyrës i interesuar dhe ky autoritet mbikëqyrës duhet të marrë pjesë në procedurën e bashkëpunimit të parashikuar në këtë Rregullore. Në çdo rast, autoritetet mbikëqyrëse e Shtetit Anëtar ose Shteteve Anëtare ku përpunuesi ka një ose më shumë seli nuk duhet të konsiderohen të jenë autoritete mbikëqyrëse të interesuara nëse projekt-vendimi ka të bëjë vetëm me kontrolluesin. Nëse përpunimi kryhet nga një grup ndërmarrjesh, selia kryesore e ndërmarrjes kontrolluese duhet të konsiderohet të jetë selia kryesore e grupit të ndërmarrjeve, përveç kur qëllimet dhe mjetet e përpunimit përcaktohen nga një ndërmarrje tjetër.

(37) Një grup ndërmarrjesh duhet të mbulojë një ndërmarrje kontrolluese dhe ndërmarrjet e kontrolluara prej saj, ku ndërmarrja kontrolluese duhet të jetë ndërmarrja që mund të ushtrojë një ndikim dominues mbi ndërmarrjet e tjera, për shembull, në bazë të pronësisë, pjesëmarrjes financiare ose rregullave që rregullojnë atë ose kompetencën për zbatimin e rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale. Një ndërmarrje që kontrollon përpunimin e të dhënave personale në ndërmarrjet ortake të saj duhet të konsiderohet, së bashku me ato ndërmarrje, si një grup ndërmarrjesh.

(38) Fëmijët meritojnë mbrojtje specifike në lidhje me të dhënat e tyre personale, pasi ata mund të jenë më pak të ndërgjegjshëm për rreziqet, pasojat dhe garancitë përkatëse dhe të drejtat e tyre në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Kjo mbrojtje specifike duhet të zbatohet veçanërisht për përdorimin e të dhënave personale të fëmijëve për qëllimet e tregtimit ose krijimit të profileve të personalitetit ose përdoruesit dhe mbledhjen e të dhënave personale në lidhje me fëmijët gjatë përdorimit të shërbimeve që i ofrohen drejtpërdrejtë fëmijës. Pëlqimi i personit që ushtron përgjegjësinë prindërore nuk duhet të jetë i nevojshëm në kontekstin e shërbimeve parandaluese ose këshillimore që i ofrohen drejtpërdrejtë një fëmije.

(39) Çdo përpunim i të dhënave personale duhet të jetë i ligjshëm dhe i drejtë. Duhet të jetë transparente për personat fizikë që të dhënat personale në lidhje me ta mblidhen, përdoren, konsultohen ose përpunohen ndryshe dhe në cilën masë të dhënat e tyre personale po përpunohen apo do të përpunohen. Parimi i transparencës kërkon që çdo informacion dhe komunikim në lidhje me përpunimin e atyre të dhënave personale të jetë lehtësisht i aksesueshëm dhe i lehtë për tu kuptuar dhe që të përdoret gjuhë e qartë dhe e thjeshtë. Ky parim ka të bëjë veçanërisht me informacionin për subjektet e të dhënave mbi identitetin e kontrolluesit dhe qëllimet e përpunimit dhe informacionet shitesë për të siguruar një përpunim të drejtë dhe transparent në lidhje me personat fizikë të interesuar dhe të drejtën e tyre për të marrë konfirmimin dhe komunikimin e të dhënave personale në lidhje me ta i cili po përpunohet. Personat fizikë duhet të bëhen të ndërgjegjshëm për rreziqet, rregullat, garancitë dhe të drejtat në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe si të ushtrojnë të drejtat e tyre në lidhje me një përpunim të tillë. Veçanërisht, qëllimet specifike për të cilat përpunohen të dhënat personale duhet të jenë të qarta dhe legjitime dhe të përcaktuara në momentin e mbledhjes së të dhënave personale. Të dhënat personale duhet të jenë të përshtatshme, të rëndësishme dhe të kufizuara në atë që është e nevojshme për qëllimet për të cilat ato përpunohen. Kjo kërkon veçanërisht garantimin që periudha për të cilën ruhen të dhënat personale të jetë e kufizuar në një minimum rigoroz. Të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm nëse qëllimi i përpunimit nuk mund të përmbushet në masë të arsyeshme me mjete të tjera. Me qëllim që të garantohet që të dhënat personale nuk mbahen më gjatë nga sa është e nevojshme, kontrolluesi duhet të përcaktojë afatet kohore nga për fshirjen ose për një rishikim periodik. Duhet të merret çdo masë e arsyeshme për të

garantuar që të dhënat personale që janë të pasakta të korrigojnë ose fshihen. Të dhënat personale duhet të përpunohen në një mënyrë që garanton sigurinë dhe konfidencialitetin e duhur për të dhënat personale, duke përfshirë parandalimin e aksesit ose përdorimit të paautorizuar të të dhënave personale dhe pajisjeve që përdoren për përpunimin e tyre.

(40) Me qëllim që përpunimi të jetë i ligjshëm, të dhënat personale duhet të përpunohen mbi bazën e pëlqimit të subjektit të të dhënave të interesuar ose mbi një bazë tjetër të ligjshme, të parashikuar me ligj, në këtë Rregullore ose në një akt tjetër të Bashkimit ose Shtetit Anëtar sipas referimit në këtë Rregullore, duke përfshirë domosdoshmërinë për respektimin e detyrimit ligjor të cilit i nënshtrohet kontrolluesi ose domosdoshmërinë për përmbushjen e një kontrate ku subjekti i të dhënave është palë ose me qëllim që të ndërmerren hapat me kërkesën e subjektit të të dhënave para lidhjes së kontratës.

(41) Nëse kjo Rregullore i referohet një baze ligjore ose një mase legislative, kjo nuk kërkon domosdoshmëri që një akt legjislativ të miratohet nga Parlamenti, pa cenuar kërkesat në pajtim me rendin kushtetues të Shtetit Anëtar të interesuar. Megjithatë, një bazë e tillë ligjore ose masë legislative duhet të jetë e qartë dhe e saktë dhe zbatimi i saj duhet të jetë i parashikueshëm për personat që i nënshtrohen, në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (Gjykata e Drejtësisë) dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

(42) Nëse përpunimi mbështetet në pëlqimin e subjektit të të dhënave, kontrolluesi duhet të jetë në gjendje të demonstrojë që subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për operacionin e përpunimit. Veçanërisht në kontekstin e një deklarimi me shkrim për një çështje tjetër, garancitë duhet të sigurojnë që subjekti i të dhënave të jetë në dijeni të faktit dhe të masës në të cilën është dhënë pëlqimi. Në pajtim me Direktivën e Këshillit 93/13/EEC (10), një deklaram pëlqimi i formuluar nga kontrolluesi duhet të jepet në një formë të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme, duke përdorur gjuhë të pastër dhe të thjeshtë dhe ajo nuk duhet të ketë kushte të padrejta. Me qëllim që pëlqimi të jetë i informuar, subjekti i të dhënave duhet të jetë në dijeni për të paktën identitetin e kontrolluesit dhe qëllimet e përpunimit për të cilat janë të destinuara të dhënat personale. Pëlqimi nuk duhet të konsiderohet i dhënë lirisht nëse subjekti i të dhënave nuk ka zgjedhje reale ose të lirë apo nuk është në gjendje të refuzojë ose tërheqë pëlqimin pa pasoja.

(43) Me qëllim që të garantohet që pëlqimi është dhënë lirisht, pëlqimi nuk duhet të përbëjë një shkak të vlefshëm ligjor për përpunimin e të dhënave personale në një çështje të caktuar nëse ka një disbalancë të qartë ndërmjet subjektit të të dhënave dhe kontrolluesit, veçanërisht nëse kontrolluesi është një autoritet publik dhe nuk duket e mundshme që pëlqimi është dhënë lirisht në të gjitha rrethanat e asaj situate specifike. Pëlqimi konsiderohet të mos jetë dhënë lirisht nëse ai nuk lejon dhënien e pëlqimit të veçantë për operacione të ndryshme të përpunimit të të dhënave personale, pavarësisht nëse është i përshtatshëm në çështjen konkrete, ose nëse përmbushja e një kontrate, duke përfshirë dhënien e një shërbimi, varet nga pëlqimi pavarësisht, nëse ky pëlqim nuk është i nevojshëm për një përmbushje të tillë.

(44) Përpunimi është i ligjshëm nëse është i nevojshëm në kontekstin e një kontrate ose synimit për të lidhur një kontratë.

(45) Nëse përpunimi kryhet në pajtim me një detyrim ligjor të cilit i nënshtrohet kontrolluesi ose

nëse përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një detyre që kryhet në interesin publik ose në ushtrim të autoritetit zyrtar, përpunimi duhet të ketë një bazë në një akt të Bashkimit ose të Shtetit Anëtar. Kjo Rregullore nuk kërkon një akt të veçantë për çdo përpunim individual. Si bazë për disa operacione përpunimi bazuar në një detyrim ligjor që i nënshtrohet kontrolluesit apo nëse përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një detyre të kryer në interes publik ose në ushtrim të autoritetit zyrtar mund të jetë i mjaftueshëm një ligj. Qëllimi i përpunimit duhet të përcaktohet nga një akt i Bashkimit ose i një Shteti Anëtar. Për më tepër, ky akt mund të specifikojë kushtet e përgjithshme të kësaj Rregulloreje që rregullon ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale, përcaktojë specifikimet për caktimin e kontrolluesit, tipin e të dhënave personale që i nënshtrohen përpunimit, subjektet e të dhënave të interesuar, subjektet të cilëve mund t'u deklarohen të dhënat personale, kufizimet e qëllimit, afatin e ruajtjes dhe masa të tjera për të garantuar përpunimin e ligjshëm dhe të drejtë. Duhet gjithashtu të jetë akti i Bashkimit ose Shtetit Anëtar që duhet të përcaktojë nëse kontrolluesi që përmbush një detyrë që kryhet në interes publik ose në ushtrim të një autoriteti zyrtar duhet të jetë një autoritet publik apo një person tjetër fizik apo juridik që rregullohet nga e drejta publike ose, nëse është në interes publik për ta bërë këtë, duke përfshirë për qëllimet shëndetësore si shëndeti publik ose mbrojtja sociale dhe menaxhimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor, nga e drejta private, si një shoqatë profesionale.

(46) Përpunimi i të dhënave personale duhet të konsiderohet si i ligjshëm nëse është i nevojshëm për të mbrojtur një interes që është thelbësor për jetën e subjektit të të dhënave ose atë të një personi tjetër fizik. Përpunimi i të dhënave personale bazuar në interesin jetik të një personi tjetër fizik në parim duhet të zhvillohet vetëm nëse përpunimi duket se nuk mund të bazohet në një bazë tjetër ligjore. Disa lloje përpunimesh mund t'u shërbejnë si shkaqe të rëndësishme të interesit publik ashtu edhe interesit jetik të subjektit të dhënave, si për shembull, në rast se përpunimi është i nevojshëm për qëllime humanitare, duke përfshirë për monitorimin e epidemive dhe përhapjen e tyre ose në situatat e emergjencave humanitare, veçanërisht në situatat e fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu.

(47) Interesat legjitime të një kontrolluesi, duke përfshirë ato të një kontrolluesi të cilit mund ti deklarohen të dhënat personale, ose të një pale të tretë, mund të ofrojnë një bazë ligjore për përpunimin, me kusht që interesat ose të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave të mos jenë mbizotëruese, duke marrë parasysh pritshmërinë e arsyeshme të subjekteve të të dhënave bazuar në marrëdhënien e tyre me kontrolluesin. Një interes i tillë legjitim mund të ekzistonte, për shembull, nëse ka një marrëdhënie të qenësishme dhe të përshtatshme ndërmjet subjektit të të dhënave dhe kontrolluesit në situata të tilla kur subjekti i të dhënave është klient ose në shërbimin e kontrolluesit. Në çdo rast, ekzistenca e një interesi legjitim do të kërkojë vlerësim të kujdesshëm duke përfshirë nëse një subjekt të dhënash mund të presë në mënyrë të arsyeshme në momentin dhe në kontekstin e mbledhjes së të dhënave personale që mund të bëhet përpunimi për atë qëllim. Interesat dhe të drejtat themelore të subjektit të të dhënave mund të mbizotërojnë interesin e kontrolluesit të të dhënave veçanërisht nëse të dhënat personale përpunohen në rrethanat kur subjektet e të dhënave normalisht nuk presin përpunim të mëtejshëm. Duke ditur që i takon ligjvënësit të parashikojë me ligj bazën ligjore për autoritet publike të përpunojnë të dhëna personale, kjo bazë ligjore nuk duhet të zbatohet për përpunimin e autoriteteve publike në përmbushje të detyrave të tyre. Përpunimi i të dhënave personale që janë domosdoshmërisht të nevojshme për qëllimet e parandalimit të mashtrimit përbën gjithashtu një interes legjitim të kontrolluesit përkatës të të dhënave. Përpunimi i të dhënave personale për qëllime të drejtpërdrejta marketingu mund të konsiderohet sikur kryhet për një interes legjitim.

(48) Kontrolluesit që janë pjesë e një grupi ndërmarrjesh ose institucionesh asociuar me një organ qendror mund të kenë një interes legjitim në transmetimin e të dhënave personale brenda grupit të ndërmarrjeve për qëllime të brendshme administrative, duke përfshirë përpunimin e të dhënave personale të klientëve ose të të punësuarve. Parimet e përgjithshme për transferimin e të dhënave personale brenda një grupi ndërmarrjesh tek një ndërmarrje që ndodhet në një vend të tretë mbeten të pacënuara.

(49) Përpunimi i të dhënave personale në masën rigorozisht të nevojshme dhe proporcionale me qëllimet e garantimit të sigurisë së rrjetit dhe të informacionit, d.m.th., aftësisë së një rrjeti ose sistemi informativ për ti rezistuar, në një nivel të caktuar të besimit, ngjarjeve aksidentale ose veprimeve të paligjshme ose dashakeqe që komprometojnë disponibilitetin, autenticitetin, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të ruajtura ose të transmetuara dhe sigurinë e shërbimeve përkatëse të ofruara ose që mund të aksesohen nëpërmjet këtyre rrjeteve dhe sistemeve, nga autoritetet publike, nga ekipet e ndihmës për emergjencat kompjuterike (CERTs), ekipet e ndihmës gjatë incidenteve të sigurisë kompjuterike (CSIRTs), nga ofruesit e rretheve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik dhe nga ofruesit e teknologjisë dhe shërbimeve të sigurisë, përbën një interes legjitim të kontrolluesit përkatës të të dhënave. Për shembull, kjo mund të përfshijë shmangien e aksesit të paautorizuar në rrjetet e komunikimit elektronik dhe shpërndarjes së kodeve dashakeqe dhe ndalimin e sulmeve nëpërmjet ‘refuzimit të shërbimit’ dhe dëmtimin e sistemeve kompjuterike dhe të komunikimit elektronik.

(50) Përpunimi i të dhënave personale për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë mbledhur fillimisht të dhënat personale duhet të lejohet vetëm nëse përpunimi është i përputhshëm me qëllimet për të cilat janë mbledhur fillimisht të dhënat personale. Në një rast të tillë, nuk është e nevojshme një bazë tjetër ligjore e veçanta nga ajo që ka lejuar mbledhjen e të dhënave personale. Nëse përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një detyre që kryhet në interes publik ose në ushtrim të autoritetit zyrtar që i është veshur kontrolluesit, e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar mund të përcaktojë dhe specifikojë detyrat dhe qëllimet për të cilat përpunimi i mëtejshëm duhet të konsiderohet si i përputhshëm dhe i ligjshëm. Përpunimi i mëtejshëm për qëllime arkivimi në interes publik, për qëllime të kërkimeve shkencore ose historike ose për qëllime statistikore duhet të konsiderohet të jetë i përputhshëm me operacionet e përpunimit të ligjshëm. Baza ligjore e ofruar nga e drejta e Bashkimit ose Shtetit Anëtar për përpunimin e të dhënave personale mund të ofrojë bazë ligjore edhe për përpunimin e mëtejshëm. Me qëllim që të konstatohet nëse një qëllim i përpunimit të mëtejshëm është i përputhshëm me qëllimin për të cilin janë mbledhur fillimisht të dhënat personale, kontrolluesi, pas përmbushjes së të gjitha kërkesave për ligjshmërinë e përpunimit fillestar, duhet të marrë parasysh, ndër të tjera: çdo lidhje ndërmjet atyre qëllimeve dhe qëllimeve të përpunimit të mëtejshëm të synuar; kontekstin në të cilin të dhënat personale janë mbledhur, veçanërisht pritshmëritë e arsyeshme të subjekteve të të dhënave bazuar në marrëdhënien e tyre me kontrolluesin në lidhje me përdorimin e mëtejshëm; natyrën e të dhënave personale; pasojat e përpunimit të mëtejshëm të synuar për subjektet e të dhënave; dhe ekzistencën e garancive të përshtatshme në operacionet e përpunimit fillestar dhe të mëtejshëm të synuar.

Nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin ose përpunimi bazohet në të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar që përbën një masë të nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike për të garantuar, veçanërisht, objektivat e rëndësishëm me interes të përgjithshëm publik, kontrolluesi duhet

të lejohet të përpunojë më tej të dhënat personale pavarësisht përputhshmërisë së qëllimeve. Në çdo rast, duhet të garantohet zbatimi i parimeve të parashikuara në këtë Rregullore dhe veçanërisht informacioni i subjektit të të dhënave për këto qëllime apo të tjera dhe për të drejtat e tij ose të saj, duke përfshirë të drejtën për të kundërshtuar. Vënia në dukje e veprimeve të mundshme kriminale apo e kërcënimeve për sigurinë publike nga kontrolluesi dhe transmetimi i të dhënave përkatëse personale në raste konkrete apo në disa raste konkrete në lidhje me të njëjtin veprim kriminal apo kërcënimeve për sigurinë publike për një autoritet kompetent duhet të konsiderohet sikur është në interesat legjitime të ndjekura nga kontrolluesi. Megjithatë, një transmetim i tillë në interesin legjitim të kontrolluesit ose përpunimi i mëtejshëm i të dhënave personale duhet të ndalohet nëse përpunimi nuk është në pajtim me detyrimin ligjor, profesional apo tjetër të fshehtësisë.

(51) Të dhënat personale që, sipas natyrës së tyre, janë tepër të ndjeshme në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore meritojnë mbrojtje të veçantë pasi në kontekstin e përpunimit të tyre mund të krijohen rreziqe të konsiderueshme për të drejtat dhe liritë themelore. Këto të dhëna personale duhet të përfshijnë të dhënat personale që tregojnë origjinën racore ose etnike, ku përdorimi i termit 'origjinë racore' në këtë Rregullore nuk nënkupton ndonjë pranim nga Bashkimi i teorive që përpiqen të përcaktojnë ekzistencën e racave të veçanta njerëzore. Përpunimi i fotografive nuk duhet të konsiderohet sistematikisht të jetë përpunim i kategorive të veçanta të të dhënave personale, siç mbulohen nga përkufizimi i të dhënave biometrike, përveç kur përpunohen nëpërmjet një mjeti teknik specifik që lejon identifikimin unik ose legjitimimin e një personi fizik. Këto të dhëna personale nuk duhet të përpunohen, përveç kur përpunimi lejohet në raste të veçanta të përcaktuara në këtë Rregullore, duke marrë parasysh që e drejta e Shtetit Anëtar mund të parashikojë dispozita specifike për mbrojtjen e të dhënave me qëllim që të përshtatë zbatimin e rregullave të kësaj Rregulloreje për përshtatje me detyrimin ligjor ose për përmbushjen e një detyre që kryhet në interes publik ose në ushtrim të autoritetit zyrtar që i është veshur kontrolluesit. Përveç kërkesave specifike për një përpunim të tillë, parimet e përgjithshme dhe rregullat e tjera të kësaj Rregulloreje duhet të zbatohen veçanërisht në lidhje me kushtet për përpunimin e ligjshëm. Shmangiet nga ndalimi i përgjithshëm për përpunimin e këtyre kategorive të të dhënave personale duhet të parashikohen shprehimisht, ndërmjet të tjerash, kur subjekti i të dhënave jep pëlqimin e tij ose të saj shprehimisht ose në lidhje me nevojat specifike veçanërisht nëse përpunimi kryhet në vazhden e aktiviteteve legjitime nga shoqata ose fundacione të caktuara qëllimi i të cilave është lejimi i ushtrimit të lirive themelore.

(52) Shmangia nga ndalimi i përpunimit të kategorive të veçanta të të dhënave personale duhet të lejohet edhe nëse kjo parashikohet në të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar dhe duke iu nënshtruar garancive të përshtatshme, për të mbrojtur të dhënat personale dhe të drejta të tjera themelore, nëse është në interesin publik për ta bërë këtë, veçanërisht përpunimi i të dhënave personale në fushën e së drejtës së punësimit, së drejtës së mbrojtjes sociale duke përfshirë pensionet dhe për sigurinë shëndetësore, qëllimet e monitorimit dhe paralajmërimit, parandalimin ose kontrollin e sëmundjeve infektive dhe kërcënime të tjera serioze për shëndetin. Një shmangie e tillë mund të bëhet për qëllime shëndetësore, duke përfshirë shëndetin publik dhe menaxhimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, veçanërisht për të garantuar cilësinë dhe ekonominë e procedurave të përdorura për zgjidhjen e pretendimeve për përfitimet dhe shërbimet në sistemin e sigurimeve shëndetësore ose për qëllime arkivimi në interesin publik, qëllimet e kërkimeve shkencore ose historike apo qëllime statistikore. Një shmangie duhet të lejohet përpunimin e atyre të dhënave personale kur janë të nevojshme për ngritjen, ushtrimin dhe mbrojtjen e pretendimeve ligjore, qoftë në procedime gjyqësore apo në një procedurë administrative apo jashtë-gjyqësore.

(53) Kategoritë e veçanta të të dhënave personale që meritojnë mbrojtje më të lartë duhet të përpunohen për qëllimet në lidhje me shëndetin vetëm nëse është e nevojshme për të arritur ato qëllime në të mirë të personave fizikë dhe shoqërisë si e tërë, veçanërisht në kontekstin e menaxhimit të shërbimeve dhe sistemeve të shërbimit shëndetësor dhe social, duke përfshirë përpunimin nga administrata dhe autoritetet kombëtare qendrore të shëndetit të këtyre të dhënave për qëllimet e kontrollit të cilësisë, informacionit mbi menaxhimin dhe mbikëqyrjes së përgjithshme kombëtare dhe lokale të sistemit të kujdesit shëndetësor dhe social dhe duke siguruar vazhdimësinë e kujdesit shëndetësor ose social dhe kujdesit shëndetësor ndër-kufitar ose sigurinë shëndetësore, qëllimet e monitorimit dhe paralajmërimit, ose për qëllime arkivimi në interes publik, qëllimet e kërkimeve shkencore ose historike, bazuar në të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar i cili duhet të përmbushë një objektiv në interes publik, si dhe për studimet e zhvilluara në interes publik në sferën e shëndetit publik. Kështu, kjo Rregullore duhet të parashikojë kushtet e harmonizuara për përpunimin e kategorive të veçanta të të dhënave personale në lidhje me shëndetin, në lidhje me nevojat e veçanta, veçanërisht kur përpunimi i këtyre të dhënave kryhet për qëllime të caktuara në lidhje me shëndetin nga persona që i nënshtrohen një detyrimi ligjor të konfidencialitetit profesional. E drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar duhet të parashikojë masat specifike dhe të përshtatshme për të mbrojtur të drejtat themelore dhe të dhënat personale të personave fizikë. Shtetet Anëtare duhet të lejohen të mbajnë dhe prezantojnë kushte të tjera, duke përfshirë kufizimet, në lidhje me përpunimin e të dhënave gjenetike, të dhënave biometrike ose të dhënat në lidhje me shëndetin. Megjithatë, kjo nuk duhet të pengojë fluksin e lirë të të dhënave personale brenda Bashkimit nëse këto kushte zbatohen për përpunimin ndërkufitar të këtyre të dhënave.

(54) Përpunimi i kategorive të veçanta të të dhënave personale mund të jetë i nevojshëm për arsye të interesit publik në sferat e shëndetit publik pa pëlqimin e subjektit të të dhënave. Ky përpunim duhet ti nënshtrohet masave të përshtatshme dhe specifike për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e personave fizikë. Në këtë kontekst, 'shëndeti publik' duhet të interpretohet sipas përkufizimit në Rregulloren (EC) Nr 1338/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (1), që janë të gjithë elementët në lidhje me shëndetin, që është gjendja shëndetësore, duke përfshirë sëmundshmërinë dhe paaftësinë, faktorët përcaktuese me efekt mbi gjendjen shëndetësore, nevojat e kujdesit shëndetësor, burimet që i caktohen kujdesit shëndetësor, ofrimin dhe aksesin e përgjithshëm në kujdesin shëndetësor si dhe shpenzimet e kujdesit shëndetësor dhe financimin dhe shkaqet e vdekshmërisë. Një përpunim i tillë i të dhënave në lidhje me shëndetin për shkaqe të interesit publik nuk duhet të rezultojë në përpunimin e të dhënave personale për qëllime të tjera nga palë të treta si punëdhënësit ose shoqëritë e sigurimeve apo bankare.

(55) Për më tepër, përpunimi i të dhënave personale nga autoritetet zyrtare për qëllimet e arritjes së qëllimeve të shoqatave fetare të njohura zyrtarisht, të parashikuara nga e drejta kushtetuese ose e drejta ndërkombëtare publike, kryhet për shkaqe të interesit publik.

(56) Nëse në kuadrin e aktiviteteve zgjedhore, funksionimi i sistemit demokratik në një Shtet Anëtar kërkon që partitë politike të përpilojnë të dhëna personale mbi bindjet politike të njerëzve, përpunimi i këtyre të dhënave mund të lejohet për shkaqe të interesit publik, me kusht që të vendosen garanci të përshtatshme.

(57) Nëse të dhënat personale të përpunuara nga një kontrollues nuk lejojnë që kontrolluesi të

identifikojë një person fizik, kontrolluesi i të dhënave nuk duhet të jetë i detyruar të përftojë informacion shtesë me qëllim që të identifikojë subjektin e të dhënave thjesht vetëm me qëllim respektimin e ndonjë dispozite në këtë Rregullore. Megjithatë, kontrolluesi nuk duhet të refuzojë marrjen e informacionit shtesë të dhënë nga subjekti i të dhënave me qëllim që të mbështesë ushtrimin e të drejtave të tij. Identifikimi duhet të përfshijë identifikimin digjital të subjektit të të dhënave, për shembull nëpërmjet mekanizmit të legjitimitit, si të njëjtat kredenciale që përdoren nga subjekti i të dhënave për tu regjistruar në shërbimin *online* të ofruar nga kontrolluesi i të dhënave.

(58) Parimi i transparencës kërkon që çdo informacion që i drejtohet publikut ose subjektit të të dhënave të jetë konciz, i aksesueshëm lehtësisht dhe i lehtë për tu kuptuar dhe të përdoret gjuhë e lehtë dhe e qartë dhe, përveç kësaj, sipas rastit, edhe vizualizim. Një informacion i tillë mund të jepet në një format elektronik, për shembull, nëse i drejtohet publikut, nëpërmjet një faqe interneti. Kjo është e një rëndësie të veçantë në situatat kur shpërndarja e aktorëve dhe kompleksiteti teknologjik në praktikë e bëjnë të vështirë që subjekti i të dhënave të dije dhe kuptojë nëse, nga kush dhe për cilin qëllim po mblidhen të dhënat personale në lidhje me të, si në rastin e reklamave *online*. Duke ditur që fëmijët meritojnë më shumë mbrojtje, çdo informacion dhe komunikim ku përpunimi i drejtohet një fëmije, duhet të jetë në një gjuhë aq të thjeshtë dhe të qartë sa fëmija ta kuptojë lehtësisht.

(59) Duhet të parashikohen modalitetet për të lehtësuar ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave sipas kësaj Rregulloreje, duke përfshirë mekanizmat për të kërkuar dhe, sipas rastit, përftuar falas, veçanërisht, aksesin dhe korrigjimin apo fshirjen e të dhënave personale dhe ushtrimin e së drejtës së kundërshtimit. Kontrolluesi duhet të parashikojë gjithashtu mjetet që kërkesat të bëhen elektronikisht, veçanërisht nëse të dhënat personale përpunohen me mjete elektronike. Kontrolluesi duhet të jetë i detyruar tu përgjigjet kërkesave nga subjektet e të dhënave pa vonesë të panevojshme dhe jo më vonë se brenda një muaji dhe të japë arsytet se pse kontrolluesi nuk ka ndër mend të respektojë ndonjë nga këto kërkesa.

(60) Parimet e përpunimit të drejtë dhe transparent kërkojnë që subjekti i të dhënave të jetë i informuar për ekzistencën e operacionit të përpunimit dhe qëllimet e tij. Kontrolluesi duhet të japë subjektit të të dhënave çdo informacion tjetër shtesë të nevojshëm për të garantuar përpunimin e drejtë dhe transparent duke marrë parasysh rrethanat specifike dhe kontekstin në të cilin përpunohen të dhënat personale. Për më tepër, subjekti i të dhënave duhet të informohet në lidhje me ekzistencën e krijimit të profilit dhe pasohet e një profili të tillë. Nëse të dhënat personale i merren subjektit të të dhënave, subjekti i të dhënave duhet të informohet nëse ai ose ajo është i detyruar të japë të dhënat personale dhe në lidhje me pasojat, nëse ai ose ajo nuk i jep këto të dhëna. Ky informacion mund të jepet i kombinuar me ikonat e standardizuara me qëllim që të ofrohet një vështrim i përgjithshëm i përpunimit të synuar në një mënyrë të dukshme, të kuptueshme dhe lehtësisht të lexueshme. Nëse ikonat ofrohen elektronikisht, ato duhet të jenë të lexueshme në mënyrë automatike.

(61) Informacioni në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të një subjekti të dhënash duhet të jepet atij ose asaj në momentin e marrjes së të dhënave nga subjekti i të dhënave, ose, nëse të dhënat personale përftohen nga një burim tjetër, brenda një afati të arsyeshëm, në varësi të rrethanave të çështjes. Nëse të dhënat personale mund të deklarohen në mënyrë të ligjshme një marrësi tjetër, subjekti i të dhënave duhet të informohet në momentin kur të dhënat personale i jepen fillimisht marrësit. Nëse kontrolluesi synon të përpunojë të dhëna personale për një qëllim të ndryshëm nga ai për të cilin ato janë mbledhur, kontrolluesi, para këtij përpunimi të mëtejshëm, duhet të japë subjektit

të të dhënave informacion mbi qëllimin tjetër dhe informacionin tjetër të nevojshëm. Nëse origjina e të dhënave personale nuk mund ti tregohet subjektit të të dhënave për shkak se janë përdorur disa burime, duhet të jepet informacion i përgjithshëm.

(62) Megjithatë, nuk është e nevojshme të vendoset detyrimi për dhënien e informacionit nëse subjekti i të dhënave e ka tashmë informacionin, nëse regjistrimi apo deklarimi i të dhënave personale është i parashikuar shprehimisht me ligj ose nëse dhënia e informacionit subjektit të të dhënave do të ishte e pamundur ose do të përfshinte një përpjekje jo-proporcionale. Ky i fundit mund të ishte rasti nëse përpunimi është kryer për qëllime arkivimi në interes publik, për qëllime të kërkimit historik ose shkencor ose qëllime statistikore. Në këtë kontekst, duhet të merret parasysh numri i subjekteve të të dhënave, mosha e të dhënave dhe çdo garanci proporcionale e miratuar.

(63) Një subjekt të dhënash duhet të ketë të drejtën e aksesit tek të dhënat personale që janë mbledhur në lidhje me të dhe të ushtrojë këtë të drejtë me lehtësi dhe intervale të arsyeshme, me qëllim që të jetë në dijeni dhe të verifikojë ligjshmërinë e përpunimit. Kjo përfshin të drejtën e subjekteve të të dhënave të kenë akses tek të dhënat në lidhje me shëndetin e tyre, për shembull të dhënat në regjistrat e tyre mjekësorë, që kanë informacion si diagnoza, rezultatet e vizitave, vlerësimet nga mjekët kurues dhe çdo trajtim apo ndërhyrje të bërë. Çdo subjekt të dhënash duhet të ketë të drejtën të njohë dhe të përftojë komunikim veçanërisht në lidhje me qëllimet për të cilat janë përpunuar të dhënat personale, sipas rastit, afatin për të cilin janë përpunuar të dhënat personale, marrësit e të dhënave personale, logjikën e përfshirë në një përpunim automatik të të dhënave personale dhe, të paktën nëse bazohet në profilizim, pasojat e këtij procesi. Sipas rastit, kontrolluesi duhet të jetë në gjendje të ofrojë akses në distancë në një sistem të sigurt që do ti siguronte subjektit të të dhënave akses të drejtpërdrejtë tek të dhënat e tij ose të saj personale. Kjo e drejtë nuk duhet të ndikojë negativisht të drejtat dhe liritë e të tjerëve, duke përfshirë sekretet tregtare ose pronësinë intelektuale dhe veçanërisht të drejtën e autorit që mbron programin. Megjithatë, rezultati i këtyre konsideratave nuk duhet të jetë refuzimi në dhënien e të gjithë informacionit subjektit të të dhënave. Nëse kontrolluesi zotëron një sasi të madhe informacioni në lidhje me subjektin e të dhënave, kontrolluesi duhet të jetë në gjendje të kërkojë që, para se të jepet informacioni, subjekti i të dhënave të specifikojë informacionin ose aktivitetet përpunuese me të cilat ka të bëjë kërkesa.

(64) Kontrolluesi duhet të përdorë të gjitha masat e arsyeshme për të verifikuar identitetin e një subjekti të dhënash i cili kërkon akses, veçanërisht në kontekstin e shërbimeve *online* dhe identifikuesve *online*. Një kontrollues nuk duhet të mbajë të dhënat personale vetëm me qëllim që të jetë në gjendje të reagojë ndaj kërkesave të mundshme.

(65) Një subjekt të dhënash duhet të ketë të drejtën që të dhënat personale në lidhje me të korrigjohen dhe ‘të drejtën për tu harruar’ nëse ruajtja e këtyre të dhënave e shkel këtë Rregullore ose të drejtën e Bashkimit apo të Shtetit Anëtar së cilës i nënshtrohet kontrolluesi. Veçanërisht, një subjekt të dhënash duhet të ketë të drejtën që të dhënat e tij ose të saj personale të fshihen dhe të mos përpunohen më tej nëse të dhënat personale nuk vazhdojnë të jenë të nevojshme në lidhje me qëllimin për të cilin ato janë mbledhur ose përpunuar ndryshe, nëse një subjekt të dhënash ka tërhequr pëlqimin e tij ose të saj ose kundërshton përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të, ose nëse përpunimi i të dhënave të tij ose të saj personale nuk përputhen me këtë Rregullore. Kjo e drejtë qëndron veçanërisht në rastin kur subjekti i të dhënave ka dhënë

pëlqimin e tij ose të saj si fëmijë dhe nuk është tërësisht në dijeni në lidhje me rreziqet e përfshira nga

përpunimi dhe më vonë dëshiron të fshijë këto të dhëna personale, veçanërisht në internet. Subjekti i të dhënave duhet të jetë në gjendje të ushtrojë këtë të drejtë pavarësisht faktit që ai ose ajo nuk vazhdon të jetë fëmijë. Megjithatë, ruajtja e mëtejshme e të dhënave personale duhet të jetë e ligjshme nëse është e nevojshme për ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit, për respektimin e një detyrimi ligjor, për përmbushjen e një detyre që kryhet në interes publik ose në ushtrim të autoritetit zyrtar që i është veshur kontrolluesit, për shkaqe të interesit publik në sferën e shëndetit publik, për arritjen e qëllimeve në interes publik, për qëllime të kërkimeve shkencore dhe historike ose për qëllime statistikore ose për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore.

(66) Për të forcuar të drejtën për tu harruar në mjedisin *online*, e drejta e fshirjes duhet të shtrihet në mënyrë të tillë që një kontrollues i cili i ka bërë të dhënat e tij personale publike duhet të ketë i detyruar të informojë kontrolluesit që po përpunojnë këto të dhëna personale të fshijnë çdo lidhje ose kopje apo përsëritje të këtyre të dhënave personale. Gjatë kësaj, kontrolluesi duhet të marrë masat e arsyeshme, duke marrë parasysh teknologjinë e disponueshme dhe mjetet e disponueshme për kontrolluesin, duke përfshirë masat teknike, të informojë kontrolluesit që po përpunojnë të dhënat personale të kërkesës së subjektit të të dhënave.

(67) Metodatat nëpërmjet të cilave kufizohet përpunimi i të dhënave personale mund të përfshijnë, ndër të tjera, kalimi i përkohshëm i të dhënave të zgjedhura në një sistem tjetër përpunimi, bërja e të dhënave të zgjedhura personale të padisponueshme për përdoruesit ose heqja e përkohshme faqja e internetit e të dhënave të publikuara. Në sistemet automatike të skedimit, kufizimi i përpunimit në parim duhet të sigurohet me mjete teknike në një mënyrë të tillë që të dhënat personale të mos u nënshtrohen operacioneve të mëtejshme të përpunimit dhe të mund të mos ndryshohen. Fakti që përpunimi i të dhënave personale është i kufizuar duhet të tregohet qartësisht në sistem.

(68) Për të fuqizuar më tej kontrollin mbi të dhënat e tij ose të saj personale, nëse përpunimi i të dhënave personale kryhet me mjete të automatizuara, subjekti i të dhënave duhet të lejohet edhe të marrë të dhënat personale në lidhje me të që ai ose ajo i ka dhënë një kontrolluesi, në një format të strukturuar, të përdorur zakonisht, të lexueshëm automatikisht dhe të ndër-operueshëm, dhe t'ia transmetojë atë një kontrolluesi tjetër. Kontrolluesit e të dhënave duhet të inkurajohen të zhvillojnë formate të ndër-operueshëm që mundësojnë lëvizshmërinë e të dhënave. Kjo e drejtë duhet të zbatohet nëse subjekti i të dhënave ka dhënë të dhënat personale në bazë të pëlqimit të tij ose të saj ose përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një kontrate. Kjo nuk duhet të zbatohet nëse përpunimi bazohet në një bazë ligjore të ndryshme nga pëlqimi ose kontrata. Nga vetë natyra e saj, kjo e drejtë nuk duhet të ushtrohet ndaj kontrolluesve që përpunojnë të dhëna personale në ushtrim të detyrave të tyre publike. Kështu ajo nuk duhet të zbatohet nëse përpunimi i të dhënave personale është i nevojshëm për përmbushjen e një detyrimi ligjor të cilit i nënshtrohet kontrolluesi ose për përmbushjen e një detyre të caktuar të kryer në interes publik ose në ushtrim të një autoriteti zyrtar që i është veshur kontrolluesit. E drejta e subjektit të të dhënave për të transmetuar ose marrë të dhëna personale në lidhje me të nuk duhet të krijojë një detyrim që kontrolluesit të përshtatin ose mbajnë sisteme përpunimi që janë teknikisht të përputhshëm. Nëse në një kontekst të të dhënave personale është i përfshirë më shumë se një subjekt të dhënash, e drejta për të marrë të dhënat personale duhet të jetë pa dëmtuar të drejtat dhe liritë e subjekteve të tjerë të të dhënave në pajtim me këtë Rregullore. Për më tepër, kjo e drejtë nuk duhet të dëmtojë të drejtën e subjektit të të dhënave për fshirjen e të dhënave të tij personale dhe kufizimet e kësaj të drejte sipas parashikimit në këtë Rregullore dhe, veçanërisht, nuk duhet të nënkuptojë fshirjen e të dhënave personale në lidhje me subjektin e të

dhënave që nuk janë dhënë prej tij ose saj për përmbushjen e një kontrate në masën që dhe për sa kohë të dhënat personale janë të nevojshme për përmbushjen e asaj kontrate. Nëse është teknikisht e mundshme, subjekti i të dhënave duhet të ketë të drejtën që të dhënat e tij personale të transmetohen drejtpërdrejtë nga një kontrollues tek një tjetër.

(69) Nëse të dhënat personale mund të përpunohen në mënyrë të ligjshme pasi përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një detyre të kryer në interes publik ose në ushtrim të autoriteti zyrtar të veshur kontrolluesit ose për shkaqe të interesave legjitimë të një kontrolluesi apo të një pale të tretë, subjekti i të dhënave përsëri duhet të ketë të drejtën të kundërshtojë përpunimin e çdo të dhëne personale në lidhje me situatën e tij ose të saj të veçantë. I takon kontrolluesit të demonstrojë që interesi i tij legjitim detyruet mbizotëron mbi interesat ose të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave.

(70) Nëse të dhënat personale përpunohen për qëllimet e marketingut të drejtpërdrejtë, subjekti i të dhënave duhet të ketë të drejtën të kundërshtojë këtë përpunim, duke përfshirë profilizimin në masën që kjo lidhet drejtpërdrejtë me këtë marketing të drejtpërdrejtë, pavarësisht nëse është në lidhje me përpunimin fillestar apo të mëtejshëm, në çdo kohë dhe falas. Kjo e drejtë duhet sjellë shprehimisht në vëmendje të subjektit të të dhënave dhe të paraqitet qartë dhe veçmas nga çdo informacion tjetër.

(71) Subjekti i të dhënave duhet të ketë të drejtën të mos i nënshtrohet një vendimi, i cili mund të përfshijë një masë, që vlerëson aspektet personale në lidhje me të që bazohet vetëm në përpunimin automatik dhe që prodhon efekte ligjore në lidhje me të ose ndikon atë në mënyrë të ngjashme, si refuzimi automatik i një kërkesë për kredi *online* ose praktikata e rekrutimit elektronik pa ndërhyrje njerëzore. Një përpunim i tillë përfshin 'krijimin e profilit' që përbëhet në çdo formë të përpunimit automatik të të dhënave personale që vlerëson aspekte personale në lidhje me një person fizik, veçanërisht për të analizuar ose parashikuar aspekte në lidhje me të dhënat e rezultateve në punë të subjektit, gjendjen ekonomike, shëndetin, preferencat ose interesat personale, besueshmërinë ose sjelljen, vendndodhjen ose lëvizjet, nëse ai prodhon efekte ligjore në lidhje me të ose ndikon tek ai ose ajo në mënyrë të ngjashme. Megjithatë, vendimmarrja e bazuar në këtë përpunim, duke përfshirë krijimin e profilit, duhet të lejohet nëse autorizohet shprehimisht nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet kontrolluesi, duke përfshirë për qëllimet e monitorimit dhe parandalimit të mashtrimit dhe evazionit fiskal të kryer në pajtim me rregulloret, standardet dhe rekomandimet e institucioneve të Bashkimit ose organet kombëtare të mbikëqyrjes dhe për të garantuar sigurinë dhe besueshmërinë e një shërbimi të dhënë nga kontrolluesi ose të nevojshëm për lidhjen ose përmbushjen e një kontrate ndërmjet subjektit të të dhënave dhe një kontrolluesi ose kur subjekti i të dhënave ka dhënë shprehimisht pëlqimin e tij ose të saj. Në çdo rast, një përpunim i tillë duhet tu nënshtrohet garancive të përshtatshme, që duhet të përfshijnë informacionin specifik për subjektin e të dhënave dhe të drejtën për të kërkuar ndërhyrje njerëzore, për të shprehur mendimin e tij ose të saj, për të marrë një shpjegim mbi vendimin e marrë pas këtij vlerësimi dhe për të kundërshtuar vendimin. Një masë e tillë nuk duhet të prekë një fëmijë.

Me qëllim që të garantohet një përpunim i drejtë dhe transparent në lidhje me subjektin e të dhënave, duke marrë parasysh rrethanat specifike dhe kontekstin në të cilin përpunohen të dhënat personale, kontrolluesi duhet të përdorë procedura matematikore dhe statistikore për profilizimin, zbatojë masat teknike dhe organizative të përshtatshme për të siguruar veçanërisht që faktorët që shkaktojnë

pasaktësi në të dhënat personale të korrigjohen dhe rreziku i gabimeve të minimizohet, të sigurojë të dhënat personale në një mënyrë të tillë që merr parasysh rreziqet potenciale të përfshira për interesat dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe që parandalon, ndërmjet të tjerash, efektet diskriminuese për personat fizikë mbi bazën e origjinës racor ose etnike, bindjeve politike, fesë ose besimit, anëtarësisë në bashkime profesionale, gjendjes gjenetike ose shëndetësore ose orientimit seksual, ose që rezulton në një efekt të tillë të masave. Vendim-marrja dhe profilizimi i automatizuar i bazuar në kategoritë e veçanta të të dhënave personale duhet të lejohet vetëm në kushte specifike.

(72) Profilizimi i nënshtrohet rregullave të kësaj Rregulloreje që rregullojnë përpunimin e të dhënave personale, si shkaqet ligjore për përpunimin ose parimet e mbrojtjes së të dhënave. Bordi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave i krijuar nga kjo Rregullore ('Bordi') duhet të jetë në gjendje të shërbejë si orientues në këtë kontekst.

(73) Kufizimet në lidhje me parimet specifike dhe të drejtat e informacionit, aksesit dhe korrigjimit ose fshirjes së të dhënave personale, të drejtën për transferimin e të dhënave, të drejtën për të kundërshtuar vendimet bazuar në profilizim dhe komunikimin e një shkeljeje të të dhënave personale tek një subjekt i të dhënave dhe detyrimet e tjera të caktuara për kontrolluesit mund të vendosen nga e drejta e Bashkimit ose Shtetit Anëtar, në masën që është e nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike për të garantuar sigurinë publike, duke përfshirë mbrojtjen e jetës njerëzore veçanërisht në përgjigje ndaj katastrofave natyrore ose të shkaktuara nga njeriu, parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë garantimin ndaj dhe parandalimin e rreziqeve për sigurinë publike ose shkeljet e etikës për profesionet e rregulluara, objektiva të tjera të rëndësishëm me interes të gjerë publik të Bashkimit ose të një Shteti Anëtar, veçanërisht një interes i rëndësishëm ekonomik ose financiar i Bashkimit ose i një Shteti Anëtar, mbajtjen e regjistrave publikë që mbahen për shkaqe të interesit të përgjithshëm publik, përpunimi i mëtejshëm i të dhënave personale të arkivuara për të dhënë informacion specifik në lidhje me sjelljen politike nën regjimet e mëparshme të shteteve totalitare ose mbrojtjen e subjekteve të të dhënave ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve, duke përfshirë për qëllimet e mbrojtjes sociale, shëndetit publik dhe humanitare. Këto kufizime duhet të jenë në pajtim me kërkesat e parashikuara në Kartë dhe në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

(74) Duhet të vendoset përgjegjësia dhe detyrimi i kontrolluesit për çdo përpunim të të dhënave personale të kryer nga kontrolluesi ose në emër të kontrolluesit. Veçanërisht, kontrolluesi duhet të jetë i detyruar të zbatojë masa të përshtatshme dhe efektive dhe të jetë në gjendje të demonstrojë përputhshmërinë e aktiviteteve përpunuese me këtë Rregullore, duke përfshirë efektivitetin e masave. Këto masa duhet të marrin parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit dhe rreziqet për të drejtat dhe liritë e personave fizikë.

(75) Rreziku për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, i një mundësie dhe ashpërsie të ndryshme, mund të rezultojë nga përpunimi i të dhënave personale që mund të çojë në dëmtim fizik, material dhe jo-material, veçanërisht: Nëse përpunimi mund të bëhet shkak për diskriminim, vjedhje identiteti ose mashtrim, humbje financiare, dëm të reputacionit, humbje besueshmërie për të dhënat personale që ruhen nga konfidencialiteti profesional, anulimi i paautorizuar i anonimizimit, ose çdo dëm tjetër ekonomik ose social, nëse subjekteve të të dhënave mund tu hiqen të drejtat dhe liritë ose të pengohen në ushtrimin e kontrollit mbi të dhënat e tyre personale; nëse përpunohen të dhëna

personale të cilat tregojnë origjinën racore ose etnike, bindjet politike, fenë dhe besimet filozofike, anëtarësinë në bashkimet profesionale, dhe përpunimi i të dhënave gjenetike, të dhënat në lidhje me shëndetin ose të dhënat në lidhje me jetën seksuale ose dënimet dhe veprat penale ose masat përkatëse të sigurisë.; nëse vlerësohen aspekte personale, veçanërisht analiza dhe parashikimi i aspekteve në lidhje me rezultatet në punë, gjendjen ekonomike, shëndetin, preferencat ose interesat personale, besueshmërinë ose sjelljen, vendndodhjen ose lëvizjet, me qëllim që të krijohen ose përdoren profile personale; nëse përpunohen të dhënat personale të personave fizikë të pambrojtur, veçanërisht për fëmijët; apo nëse përpunimi përfshin një masë të madhe të të dhënave personale dhe ka të bëjë me një numër të madh të subjekteve të të dhënave.

(76) Mundësia dhe ashpërsia e rrezikut për të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave duhet të përcaktohet nëpërmjet referencës tek natyra, objekti, konteksti dhe qëllimet e përpunimit. Rreziku duhet të vlerësohet mbi bazën e një vlerësimi objektiv, nëpërmjet të cilit vendoset nëse operacionet për përpunimin e të dhënave kanë të bëjnë me një rrezik apo rrezik të madh.

(77) Orientimi në lidhje me zbatimin e masave të përshtatshme dhe në lidhje me demonstrimin e përputhshmërisë nga kontrolluesi ose përpunuesi, veçanërisht në lidhje me identifikimin e rrezikut në lidhje me përpunimin, vlerësimi i tyre në kuptimin e origjinës, natyrës, mundësisë dhe ashpërsisë, dhe identifikimi i praktikave më të mira për të ulur rrezikun, mund të jepet veçanërisht nëpërmjet kodeve të aprovuara të sjelljes, certifikimeve të aprovuara, udhëzimeve të dhëna nga Bordi ose treguesit e dhëna nga një nëpunës i mbrojtjes së të dhënave. Bordi mund të nxjerrë gjithashtu udhëzime mbi operacionet e përpunimit që konsiderohen të mos rezultojnë në një rrezik të madh për të drejtat dhe liritë e personave fizikë dhe të tregojë cilat masa mund të jenë të mjaftueshme në këto raste për të trajtuar një rrezik të tillë.

(78) Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale kërkon që të merren masat e përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar që të përmbushen kërkesat e kësaj Rregulloreje. Me qëllim për të qenë në gjendje për të demonstruar përputhshmërinë me këtë Rregullore, kontrolluesi duhet të miratojë politikën e brendshme dhe të zbatojë masat që përmbushin veçanërisht parimet e mbrojtjes së të dhënave në mënyrë konkrete dhe mbrojtjes së të dhënave në mënyrë incidentale. Këto masa mund të konsistojnë, ndërmjet të tjerash, në minimizimin e mbrojtjes së të dhënave personale, anonimizimin e të dhënave personale sa më shpejt të jetë e mundur, transparencë në lidhje me funksionet dhe përpunimin e të dhënave personale, mundësimin për subjektin e të dhënave të monitorojë përpunimin e të dhënave, mundësimin për kontrolluesin për të krijuar dhe përmirësuar cilësitë e sigurisë. Gjatë zhvillimit, projektimit, përzgjedhjes dhe gjatë përdorimit të aplikimeve, shërbimeve dhe produkteve që bazohen në përpunimin e të dhënave personale ose ku përpunojnë të dhëna personale në përmbushje të detyrës së tyre, prodhuesit e produkteve, shërbimeve dhe aplikimeve duhet të inkurajohen të marrin parasysh të drejtën për mbrojtjen e të dhënave gjatë zhvillimit dhe projektimit të këtyre produkteve, shërbimeve dhe aplikimeve duke i kushtuar vëmendjen e duhur gjendjes së teknikës, të sigurojnë që kontrolluesit dhe përpunuesit janë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre për mbrojtjen e të dhënave. Parimet e mbrojtjes së të dhënave në mënyrë konkrete dhe incidentale duhet të merren parasysh edhe në kontekstin e tenderëve publikë.

(79) Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave si dhe përgjegjësia dhe detyrimi

i kontrolluesve dhe përpunuesve, edhe në lidhje me monitorimin dhe masat e autoriteteve mbikëqyrëse, kërkon një caktim të qartë të përgjegjësive sipas kësaj Rregulloreje, duke përfshirë nëse një kontrollues përcakton qëllimet dhe mjetet e përpunimit së bashku me kontrollues të tjerë apo nëse një operacion përpunimi kryhet në emër të kontrolluesit.

(80) Nëse një kontrollues ose përpunues që nuk është vendosur në Bashkim përpunon të dhëna personale për subjektet e të dhënave që nuk janë në Bashkim aktivitetet përpunuese të të cilëve kanë të bëjnë me ofrimin mallrave ose shërbimeve këtyre subjekteve të të dhënave në Bashkim, pavarësisht nëse kërkohet një pagesë nga subjekti i të dhënave, ose me monitorimin e sjelljes së tyre në masën që sjellja e tyre zhvillohet në Bashkim, kontrolluesi ose përpunuesi duhet të caktojë një përfaqësues, përveç kur përpunimi është rastësor, nuk përfshin përpunimin në masë të madhe të kategorive të veçanta të të dhënave personale ose përpunimi i të dhënave personale në lidhje me dënimet ose veprat penale dhe nuk është i mundur të rezultojë në një rrezikim të të drejtave dhe lirive të personave fizikë duke marrë parasysh natyrën, kontekstin, objektin dhe qëllimet e përpunimit ose nëse kontrolluesi është një autoritet ose organ publik. Përfaqësuesi duhet të veprojë në emër të kontrolluesit ose përpunuesit dhe mund të investohet nga autoriteti mbikëqyrës. Përfaqësuesi duhet të caktohet shprehimisht me mandat me shkrim të kontrolluesit ose përpunuesit për vepruar në emër të tij në lidhje me detyrimet sipas kësaj Rregulloreje. Caktimi i një përfaqësuesi të tillë nuk ndikon përgjegjësinë ose detyrimin e kontrolluesit ose përpunuesit sipas kësaj Rregulloreje. Një përfaqësues i tillë duhet të përmbushë detyrat e tij në pajtim me mandatin e marrë nga kontrolluesi ose përpunuesi, duke përfshirë bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse kompetente në lidhje me çdo veprim të ndërmarrë për të garantuar përputhshmërinë me këtë Rregullore. Përfaqësuesi i caktuar duhet tu nënshtrohet procedurave përmbartimore në rast të mosbindjes ndaj kontrolluesit ose përpunuesit.

(81) Për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat e kësaj Rregulloreje në lidhje me përpunimin që duhet të kryhet nga përpunuesi në emër të kontrolluesit, në rastin e ngarkimit të një përpunuesi me aktivitetet përpunuese, kontrolluesi duhet të përdorë vetëm përpunuesit që ofrojnë garanci të mjaftueshme, veçanërisht në kuptimin e njohurive të ekspertizës, besueshmërisë dhe burimeve, për zbatimin e masave teknike dhe organizative që përmbushin kërkesat e kësaj Rregulloreje, duke përfshirë sigurinë e përpunimit. Respektimi nga përpunuesi i një kodi të aprovuar të sjelljes ose një mekanizmi të aprovuar certifikimi mund të përdoret si element për të demonstruar përputhshmëri me detyrimet e kontrolluesit. Kryerja e përpunimit nga një përpunues duhet të rregullohet nga një kontratë ose një akt tjetër juridik sipas së drejtës së Bashkimit ose Shtetit Anëtar, që detyron përpunuesin kundrejt kontrolluesit, duke caktuar objektin dhe kohëzgjatjen e përpunimit, natyrën dhe qëllimet e përpunimit, tipin e të dhënave personale dhe kategoritë e subjekteve të të dhënave, duke marrë parasysh detyrat specifike dhe përgjegjësitë e përpunuesit në kontekstin e përpunimit që duhet të kryhet dhe rreziqet për të drejta dhe liritë e subjektit të të dhënave. Kontrolluesi dhe përpunuesi mund të zgjedhë të përdorë një kontratë individuale ose klauzola kontraktuale standarde që janë miratuar drejtpërdrejtë nga Komisioni ose një autoritet mbikëqyrës në pajtim me mekanizmat e përputhshmërisë dhe pastaj të miratuara nga Komisioni. Pas përfundimit të përpunimit në emër të kontrolluesit, përpunuesi, në zgjedhjen e kontrolluesit, duhet të kthejë ose fshijë të dhënat personale, përveç kur ka një kërkesë për ruajtjen e të dhënave personale sipas së drejtës së Bashkimit ose Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet përpunuesi.

(82) Me qëllim që të demonstron përputhshmëri me këtë Rregullore, kontrolluesi ose

përpunuesi duhet të mbajë regjistra për aktivitetet përpunuese nën përgjegjësinë e tij. Çdo kontrollues dhe përpunues duhet të jetë i detyruar të bashkëpunojë me autoritetin mbikëqyrës dhe ti vërë në dispozicion me kërkesë këto të dhëna, në mënyrë që kjo ti shërbejë monitorimit të operacioneve të përpunimit.

(83) Me qëllim që të ruhet siguria dhe të shmanget përpunimi në shkelje të kësaj Rregullore, kontrolluesi ose përpunuesi duhet të vlerësojë rreziqet që lidhen me përpunimin dhe zbatojë masat për të lehtësuar këto rreziqe, si nëpërmjet enkriptimit. Këto masa duhet të garantojnë një nivel të përshtatshëm të sigurisë, duke përfshirë konfidencialitetin, duke marrë parasysh gjendjen e teknikës dhe shpenzimet e zbatimit në lidhje me rreziqet dhe natyrën e të dhënave personale që duhet të mbrohen. Në vlerësimin e rrezikut të sigurisë së të dhënave, duhet tu kushtohet vëmendje rreziqeve që paraqiten nga përpunimi i të dhënave personale, si asgjësimi aksidental ose i paligjshëm, humbja, ndryshimi, deklarimi i paautorizuar ose aksesit tek të dhënat personale të transmetuara, ruajtura ose përpunuara që veçanërisht mund të çojnë në dëm fizik, material ose jo-material.

(84) Me qëllim që të fuqizohet përputhshmëria me këtë Rregullore kur operacionet e përpunimit mund të rezultojnë në një rrezik të madh të të drejtave dhe lirive të personave fizikë, kontrolluesi duhet të jetë përgjegjës për kryerjen e vlerësimit të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave, për të vlerësuar, veçanërisht, origjinën, natyrën, veçantinë dhe ashpërsinë e rrezikut. Rezultati i vlerësimit duhet të merret parasysh në përcaktimin e masave të përshtatshme që duhet të merren për të demonstruar që përpunimi i të dhënave personale të përputhet me këtë Rregullore. Nëse një vlerësim i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave tregon që operacionet përpunuese kanë të bëjnë me një rrezik të madh që kontrolluesi nuk mund ta zbutë me masat e përshtatshme në kuptimin e teknologjisë së disponueshme dhe shpenzimeve të zbatimit, duhet të bëhet një konsultim me organin mbikëqyrës para përpunimit.

(85) Një shkelje e të dhënave personale, nëse nuk trajtohet në një mënyrë të përshtatshme dhe në kohë, mund të rezultojë në dëm fizik, material dhe jo-material për personat fizikë, si humbja e kontrollit mbi të dhënat e tyre personale ose kufizimi i të drejtave të tyre, diskriminimi, vjedhje identiteti ose mashtrimi, humbje financiare, anulim i paautorizuar i anonimizimit, dëmi për reputacionin, humbja e konfidencialitetit të të dhënave personale të mbrojtura nga sekreti profesional ose një disavantazh tjetër i rëndësishëm ekonomik ose social për personin fizik përkatës. Kështu, menjëherë sapo kontrolluesi vjen në dijeni që ka ndodhur një shkelje e të dhënave personale, kontrolluesi duhet të njoftojë për shkeljen e të dhënave personale autoritetin mbikëqyrës pa vonesë të panevojshme dhe, sipas rastit, jo më vonë se 72 orë pas ardhjes në dijeni të kësaj, përveç kur kontrolluesi është në gjendje të demonstrojë, në pajtim me parimin e përgjegjshmërisë, që shkelja e të dhënave personale nuk mund të rezultojë në një rrezik për të drejtat dhe liritë e personave fizikë. Nëse një njoftim i tillë nuk mund të arrihet brenda 72 orëve, shkaqet e vonesës duhet të shoqërojnë njoftimin dhe informacioni mund të jepet në pjesë pa vonesë të panevojshme të mëtejshme.

(86) Kontrolluesi duhet ti komunikojë subjektit të të dhënave shkeljen e të dhënave personale, pa vonesë të panevojshme, nëse shkelja e të dhënave personale mund të rezultojë në një rrezik të madh për të drejtat dhe liritë e personit fizik me qëllim që ti mundësojë atij ose asaj të marrë masat e nevojshme parandaluese. Komunikimi duhet të përshkruajë natyrën e shkeljes së të dhënave personale si dhe rekomandimet për personin fizik përkatës për të zbutur efektet negative të

mundshme. Një komunikim i tillë me subjektet e të dhënave duhet të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur dhe në bashkëpunim të ngushtë me autoritetin mbikëqyrës, duke respektuar udhëzimet e tij ose të autoriteteve të tjerë përkatës si autoritetet e zbatimit të ligjit. Për shembull, nevoja për zbutur një rrezik të menjëhershëm dëmtimi do të kërkonte komunikimin e menjëhershëm me subjektin e të dhënave ndërsa nevoja për të zbatuar masat e përshtatshme ndaj vazhdimit apo shkeljes së ngjashme të të dhënave personale mund të justifikojë një afat më të gjatë komunikimi.

(87) Duhet të konstatohet nëse janë zbatuar të gjitha masat e përshtatshme teknologjike të mbrojtjes dhe organizative për të përcaktuar menjëherë nëse është kryer një shkelje e të dhënave personale dhe duhet të vihet në dijeni menjëherë autoriteti mbikëqyrës dhe subjekti i të dhënave. Fakti që njoftimi është bërë pa vonesë të panevojshme duhet të konstatohet duke pasur parasysh veçanërisht natyrën dhe ashpërsinë e shkeljes së të dhënave personale dhe pasojat e saj dhe efektet negative mbi subjektin e të dhënave. Një njoftim i tillë mund të rezultojë në një ndërhyrje të autoritetit mbikëqyrës në pajtim me detyrat dhe kompetencat e tij të parashikuara në këtë Rregullore.

(88) Në caktimin e rregullave të hollësishme në lidhje me formatin dhe procedurat e zbatueshme për njoftimin e shkeljeve të të dhënave personale, duhet ti kushtohet vëmendja e duhur rrethanave të asaj shkeljeje, duke përfshirë nëse të dhënat personale janë mbrojtur nga masat e përshtatshme teknike të mbrojtjes, duke kufizuar në mënyrë efektive mundësinë e mashtrimit me identitetin dhe forma të tjera të abuzimit. Për më tepër, këto rregulla dhe procedura duhet të marrin parasysh interesat legjitime të autoriteteve të zbatimit të ligjit, ku deklarimi i parakohshëm mund të pengonte në mënyrë të panevojshme hetimin e rrethanave të një shkeljeje të të dhënave personale.

(89) Direktiva 95/46/EC ka parashikuar një detyrim të përgjithshëm për të njoftuar përpunimin e të dhënave personale autoriteteve mbikëqyrëse. Ndërsa ky detyrim prodhon barrë administrative dhe financiare, kjo nuk kontribuon gjithmonë në përmirësimin e mbrojtjes së të dhënave personale. Këto detyrime për njoftime të përgjithshme pa dallime duhet të hiqen dhe të zëvendësohen me procedura dhe mekanizma të efektshme që në vend të kësaj përqendrohen në ato lloje të operacioneve përpunuese që mund të rezultojnë në një rrezik të lartë të të drejtave dhe lirive të personave fizikë në saj të natyrës, objektit, kontekstit dhe qëllimeve. Këto lloje të operacioneve të përpunimit mund të jenë ato që, veçanërisht, përfshijnë përdorimin e teknologjisë së re ose janë të një lloji të ri dhe nuk është kryer ndonjë vlerësim për ndikimin mbi mbrojtjen e të dhënave më para nga kontrolluesi, ose nëse ato bëhen të nevojshme duke pasur parasysh kohën që ka kaluar nga përpunimi i parë.

(90) Në këto raste, një vlerësim i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave duhet të kryhet nga kontrolluesi para përpunimit me qëllim që të vlerësohet mundësia dhe ashpërsia e veçantë e rrezikut të lartë, duke pasur parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit dhe burimet e rrezikut. Ky vlerësim ndikimi duhet të përfshijë, veçanërisht, masat, garancitë dhe mekanizmat e parashikuara për zbutjen e rrezikut, garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe demonstruar përputhshmërinë me këtë Rregullore.

(91) Kjo duhet të zbatohet veçanërisht në operacionet e përpunimit në masë të gjerë që synon të përpunojë një masë të konsiderueshme të të dhënave personale në nivelin rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar dhe që mund të ndikojë mbi një numër të madh subjektësh dhe që mund të rezultojnë në një rrezik të lartë, për shembull, për shkak të ndjeshmërisë së tyre, ku në pajtim me gjendjen e

arritur të njohurive teknologjike përdoret një teknologji e re në një gamë të gjerë si dhe për operacionet e tjera përpunuese që rezultojnë në një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave, veçanërisht nëse këto operacione e bëjnë më të vështirë për subjektet e të dhënave të ushtrojnë të drejtat e tyre. Një vlerësim i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave duhet të bëhet nëse përpunohen të dhëna për marrjen e vendimeve në lidhje me persona të caktuar fizikë pas një vlerësimi sistematik dhe të gjerë të aspekteve personale në lidhje me personat fizikë bazuar në profilin e atyre të dhënave ose pas përpunimit të kategorive të veçanta të të dhënave personale, të dhënave biometrike ose të dhëna për dënimet dhe veprat penale apo masat përkatëse të sigurisë. Një vlerësim i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave kërkohet po ashtu për monitorimin e sferave me akses publik në një shkallë të gjerë, veçanërisht nëse përdoren mjete elektronike optike ose për çdo operacion tjetër ku autoriteti mbikëqyrës kompetent konsideron që përpunimi mund të rezultojë në një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave, veçanërisht për shkak se ato pengojnë subjektet e të dhënave në ushtrimin e të drejtës ose përdorimin e një shërbimi ose kontrate, ose për shkak se ato kryhen sistematikisht në një gamë të gjerë. Përpunimi i të dhënave personale nuk duhet të konsiderohet të jetë në një shkallë të gjerë nëse përpunimi ka të bëjë vetëm me të dhënat personale nga pacientët ose klientët nga një mjek individual ose profesionist i kujdesit shëndetësor apo avokat. Në këto raste, një vlerësim i ndikimit të mbrojtjes së të dhënave nuk duhet të jetë detyrues.

(92) Ekzistojnë rrethana në të cilat mund të jetë e arsyeshme dhe ekonomike për subjektin e një vlerësimi të ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave të jetë më i gjerë se një projekt i vetëm, për shembull, nëse autoritetet ose organet publike synojnë të vendosin një platformë të përgjithshme aplikimi ose përpunimi ose nëse disa kontrollues planifikojnë të prezantojnë një mjedis aplikimi ose përpunimi të përbashkët në një sektor ose segment industrial ose për një aktivitet horizontal të përdorur gjerësisht.

(93) Në kontekstin e miratimit të ligjit të Shtetit Anëtar në të cilin mbështetet kryerja e detyrave të autoritetit publik ose organit publik dhe që rregullon operacionin specifik të përpunimit ose kompletin e operacioneve në fjalë, Shtetet Anëtare mund ta konsiderojnë të rëndësishme të kryejnë këto vlerësime para aktiviteteve përpunuese.

(94) Nëse një vlerësim i ndikimit mbi të dhënat personale tregon që përpunimi, në mungesë garancie, masave dhe mekanizmave të sigurisë për zbutjen e rrezikut, do të rezultonte në një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë dhe kontrolluesi është i mendimit që rreziku nuk mund të zbutet me mjetet e arsyeshme në kuptimin e teknologjisë së disponueshme dhe koston e zbatimit, autoriteti mbikëqyrës duhet të konsultohet para fillimit të aktiviteteve përpunuese. Një rrezik i tillë i lartë mund të rezultojë nga lloje të caktuara të përpunimit dhe masa dhe shpeshësia e përpunimit, që mund të rezultojë edhe në një realizim të dëmit ose ndërhyrjes tek të drejtat dhe liritë e një personi fizik. Autoriteti mbikëqyrës duhet të reagojë ndaj kërkesës për konsultim brenda një periudhe të specifikuar. Megjithatë, mungesa e një reagimi nga autoriteti mbikëqyrës brenda këtij afati nuk duhet të cenojë ndërhyrjen e autoritetit mbikëqyrës në pajtim me detyrat dhe kompetencat e parashikuara në këtë Rregullore, duke përfshirë kompetencën e ndalimit të operacioneve të përpunimit. Si pjesë e procesit të konsultimit, rezultati i vlerësimit të ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave të kryer në lidhje me përpunimin në fjalë mund ti paraqitet autoritetit mbikëqyrës, veçanërisht masat e parashikuara për të zbutur rrezikun për të drejtat dhe liritë e personave fizikë.

(95) Përpunuesi duhet të asistojë kontrolluesin, sipas rastit dhe me kërkesë, në garantimin e përputhshmërisë me detyrimet që rrjedhin nga kryerja e vlerësimit të ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave dhe nga konsultimi paraprak i autoritetit mbikëqyrës.

(96) Një konsultim i autoritetit mbikëqyrës duhet të kryhet edhe në kuadrin e përgatitjes së një mase legjislative ose rregullatorë që parashikon përpunimin e të dhënave personale, me qëllim që të garantohet përputhshmëria me përpunimin e synuar me këtë Rregullore dhe veçanërisht për të zbutur rrezikun e përfshirë për subjektin e të dhënave.

(97) Nëse përpunimi kryhet nga një organ publik, përveç gjykatave ose autoriteteve të pavarura gjyqësore nëse veprojnë në kapacitetin e tyre gjyqësor, nëse, në sektorin privat, përpunimi kryhet nga një kontrollues, aktivitetet kryesore të cilit konsistojnë në operacionet përpunuese që kërkojnë monitorim të rregullt dhe sistematik të subjekteve të të dhënave në një masë të gjerë, ose nëse aktivitetet kryesore të kontrolluesit ose të përpunuesit konsistojnë në përpunimin në masë të gjerë të kategorive të veçanta të të dhënave personale dhe të dhënat në lidhje me dënimet dhe veprat penale, personi që ka ekspertizë për ligjin dhe praktikën e mbrojtjes së të dhënave duhet të asistojë kontrolluesin ose përpunuesin për të monitoruar përputhshmërinë me këtë Rregullore. Në sektorin privat, aktivitetet kryesore të një kontrolluesi kanë të bëjnë me aktivitetet e tij primare dhe nuk kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale në aktivitetet dytësore. Niveli i nevojshëm i ekspertizës duhet të përcaktohet veçanërisht në pajtim me operacionet e përpunimit të të dhënave të kryera dhe mbrojtjen e kërkuar për të dhënat personale të përpunuara nga kontrolluesi ose përpunuesi. Këta punonjës të mbrojtjes së të dhënave, pavarësisht nëse ata janë të punësuar të kontrolluesit, duhet të jenë në gjendje të përmbushin detyrat e tyre në një mënyrë të pavarur.

(98) Shoqatat ose organet e tjera që përfaqësojnë kategoritë e kontrolluesve ose përpunuesve duhet të inkurajohen të përpilojnë kode sjelljeje, brenda kufijve të kësaj Rregulloreje, për të lehtësuar zbatimin e efektshëm të kësaj Rregulloreje, duke marrë parasysh karakteristikat specifike të përpunimit të kryer në sektorë të caktuar në nevojat e veçanta të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Veçanërisht, këto kode sjelljeje mund të kalibrojnë detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve, duke marrë parasysh rrezikun që mund të rezultojë nga përpunimi për të drejtat dhe liritë e personave fizikë.

(99) Gjatë përpilimit të një kodi sjelljeje, ose gjatë ndryshimit apo zgjerimit të një kodi të tillë, shoqatat dhe organet e tjera që përfaqësojnë kategoritë e kontrolluesve ose përpunuesve duhet të konsultohen me aktorët përkatës, duke përfshirë subjektet e të dhënave sipas rastit dhe të marrin parasysh parashtrimet e marra dhe mendimet e shprehura në përgjigje të këtyre konsultimeve.

(100) Me qëllim që të fuqizohet transparencja dhe përputhshmëria me këtë Rregullore, vendosja e mekanizmave të certifikimit dhe vulave dhe shenjave të mbrojtjes së të dhënave duhet të inkurajohet, duke u mundësuar subjekteve të të dhënave të vlerësojnë menjëherë nivelin e mbrojtjes së të dhënave për produkte dhe shërbime të caktuara.

(101) Rrjedha e informacionit personal për tek dhe nga vendet jashtë Bashkimit dhe organizatave ndërkombëtare është e nevojshme për zgjerimin e tregtisë ndërkombëtare dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Ky shtim i kësaj rrjedhe ka sjell sfida dhe shqetësime të reja në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Megjithatë, kur të dhënat personale transferohen nga Bashkimi tek kontrolluesit

ose përpunuesit ose marrës të tjerë në vendet e treta ose tek organizatat ndërkombëtare, niveli i mbrojtjes së personave fizikë i siguruar në Bashkim nga kjo Rregullore nuk duhet të prishet, duke përfshirë në rastet e transferimeve transit të të dhënave personale nga vendi i tretë ose organizata ndërkombëtare tek kontrolluesit, përpunuesit në të njëjtin ose në një vend të tretë apo organizatë ndërkombëtare. Në çdo rast, transferimet në vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare mund të kryhen vetëm në pajtim të plotë me këtë Rregullore. Një transferim mund të kryhet vetëm nëse, në pajtim me dispozitat e tjera të kësaj Rregulloreje, kushtet e parashikuara në dispozitat e kësaj Rregulloreje në lidhje me transferimin e të dhënave personale tek vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare respektohen nga kontrolluesi ose përpunuesi.

(102) Kjo Rregullore nuk cenon marrëveshjet e tjera ndërkombëtare të lidhura ndërmjet Bashkimit dhe vendeve të treta që rregullojnë transferimin e të dhënave personale duke përfshirë garancitë e përshtatshme për subjektet e të dhënave. Shtetet Anëtare mund të lidhin marrëveshje ndërkombëtare që përshijnë transferimin e të dhënave personale në vendet e treta ose tek organizatat ndërkombëtare, në masën që këto marrëveshje nuk cenojnë këtë Rregullore ose një dispozitë tjetër të së drejtës së Bashkimit dhe përshijnë një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje të të drejtave themelore të subjekteve të të dhënave.

(103) Komisioni mund të vendosë me fuqi për të gjithë Bashkimin që një vend i tretë, një territor ose një sektor i specifikuar brenda një vendi të tretë, ose një organizatë ndërkombëtare, ofron një nivel të përshtatshëm për mbrojtjen e të dhënave, duke parashikuar kështu siguri dhe njëtrajshmëri juridike në të gjithë Bashkimin, në lidhje me vendin e tretë ose organizatën ndërkombëtare që konsiderohet të ofrojë një nivel të tillë mbrojtjeje. Në këto raste, transferimet e të dhënave personale në atë vend të tretë ose organizatë ndërkombëtare mund të ndodhin pa nevojën e marrjes së autorizimeve të mëtejshme. Komisioni mund të vendosë gjithashtu, pasi të ketë bërë njoftim dhe një deklaratë të plotë që tregon arsyet për vendin e tretë ose organizatën ndërkombëtare, të revokojë një vendim të tillë.

(104) Në pajtim me vlerat themelore në të cilat mbështetet Bashkimi, veçanërisht mbrojtja e të drejtave të njeriut, Komisioni, në vlerësimin e tij për një vend të tretë ose për një territor apo sektor të specifikuar brenda një vendi të tretë, duhet të marrë parasysh veçanërisht se si vendi i tretë respekton shtetin ligjor, aksesin në drejtësi, si dhe në normat dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ligjin e tij të përgjithshëm dhe sektorial, duke përfshirë legjislacionin në lidhje me sigurinë publike, mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, si dhe sektorin publik dhe të drejtën penale. Miratimi i një vendimi përshtatshmërie në lidhje me një territor ose sektor të specifikuar në një vend të tretë duhet të marrë parasysh kritere të qarta dhe objektive, si aktivitetet specifike të përpunimit dhe objektin e standardeve ligjore të zbatueshme dhe legjislacionin në fuqi në vendin e tretë. Vendi i tretë duhet të ofrojë garanci që sigurojnë një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes thelbësisht të barasvlershëm me ata që është i siguruar brenda Bashkimit, veçanërisht kur të dhënat personale përpunohen në një ose disa sektorë specifikë. Veçanërisht, vendi i tretë duhet të garantojë mbikëqyrje të efektshme dhe të pavarur të mbrojtjes së të dhënave dhe duhet të parashikojë mekanizmat e bashkëpunimit me autoritetet e mbrojtjes së të dhënave të Shteteve Anëtare dhe subjektet e të dhënave duhet të pajisen me të drejta efektive dhe të zbatueshme dhe të drejtë ankimi të efektshëm administrativ dhe gjyqësor.

(105) Përveç angazhimeve ndërkombëtare që ka marrë përsipër vendi i tretë ose organizata

ndërkombëtare, Komisioni duhet të marrë parasysh detyrimet që rrjedhin nga pjesëmarrja e vendit të tretë ose e organizatës ndërkombëtare në sisteme multilaterale ose rajonale veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe zbatimin e këtyre detyrimeve. Veçanërisht, duhet të merret parasysh aderimi i vendit të tretë në Konventën e Këshillit të Evropës të datës 28 janar 1981 për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale dhe Protokollin e saj Shtesë. Komisioni duhet të konsultohet me Bordin gjatë vlerësimit të nivelit të mbrojtjes në vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare.

(106) Komisioni duhet të monitorojë funksionimin e vendimeve mbi nivelin e mbrojtjes në një vend të tretë, territor, sektor specifik brenda një vendi të tretë ose organizatë ndërkombëtare dhe të monitorojë funksionimin e vendimeve të miratuara në bazë të Nenit 25(6) ose nenit 26(4) të Direktivës 95/46/EC. Në vendimet e tij për përshtatshmërinë, Komisioni duhet të parashikojë një mekanizëm të rishikimit periodik për funksionimin e tyre. Ky rishikim periodik duhet të kryhet në konsultim me vendin e tretë ose të organizatës ndërkombëtare në fjalë dhe të marrë parasysh të gjitha zhvillimet në vendin e tretë ose organizatën ndërkombëtare. Për qëllimet e monitorimit dhe kryerjes së rishikimeve periodike, Komisioni duhet të marrë parasysh mendimet dhe konstatimet e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, si dhe të organeve dhe burimeve të tjera përkatëse. Komisioni duhet të vlerësojë, brenda një afati të caktuar, funksionimin e vendimeve të këtyre të fundit dhe të raportojë çdo konstatim përkatës në Komitet brenda kuptimit të Rregullores (EU) Nr 182/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (1) të ngritur sipas kësaj Rregulloreje dhe në Parlamentin Evropian dhe në Këshill.

(107) Komisioni mund të njohë që një vend i tretë, një territor ose sektor i specifikuar brenda një vendi të tretë ose një organizatë ndërkombëtare nuk vazhdon të garantojë nivelin e përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave. Për pasojë, transferimi i të dhënave personale në atë vend të tretë ose organizatë ndërkombëtare duhet të ndalohet, përveç kur plotësohen kërkesat në këtë rregullore në lidhje me transferimet që u nënshtrohen garancive të përshtatshëm, duke përfshirë rregullat detyruese të brendshme dhe shmangiet në situata të caktuara. Në këtë rast, duhet të parashikohen konsultime ndërmjet Komisioni dhe këtyre vendeve të tretë ose organizatave ndërkombëtare. Komisioni, në kohën e duhur, duhet të informojë vendin e tretë ose organizatën ndërkombëtare për shkaqet dhe të futet në bisedime me qëllim korrigjimin e situatës.

(108) Në mungesë të një vendimi mbi përshtatshmërinë, kontrolluesi ose përpunuesi duhet të marrë masat për të kompensuar mungesën e mbrojtjes së të dhënave në një vend të tretë nëpërmjet garancive të përshtatshme për subjektin e të dhënave. Këto garanci të përshtatshme mund të konsistojnë në përdorimin e rregullave të brendshme detyruese, klauzolat standarde për mbrojtjen e të dhënave nga Komisioni, klauzolat standarde për mbrojtjen e të dhënave nga një autoritet mbikëqyrës ose klauzolë kontraktuale të autorizuar nga një autoritet mbikëqyrës. Këto garanci duhet të garantojnë përputhshmëri me kërkesat e mbrojtjes së të dhënave dhe të drejtat e subjektet e të dhënave të përshtatshme për tu përpunuar brenda Bashkimit, duke përfshirë disponibilitetin e të drejtave të ekzekutueshme të subjekteve të të dhënave dhe të mjeteve ligjore mbrojtëse, duke përfshirë bërjen e ankimit administrativ ose gjyqësor dhe pretendimin e kompensimit në bashkim ose në një vend të tretë. Ato duhet të lidhen veçanërisht me përputhshmërinë me parimet e përgjithshme në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, parimet e mbrojtjes së të dhënave në mënyrë konkrete ose rastësore. Transferimet mund të kryhen gjithashtu nga autoritetet publike ose organet tek autoritetet publike ose organet në vende të treta ose organizatat ndërkombëtare me detyrat ose funksionet përkatëse, duke përfshirë në bazë të dispozitave që duhet të përfshihen në masat administrative, si një

memorandum mirëkuptimi, duke parashikuar të drejta të ekzekutueshme dhe efektive për subjektet e të dhënave. Autorizimi nga autoriteti kompetent mbikëqyrës duhet të merret nëse garancitë parashikohen në masat administrative që nuk janë ligjërish të detyrueshme.

(109) Mundësia që kontrolluesi ose përpunuesi të përdorë klauzolat standarde për mbrojtjen e të dhënave të miratuara nga Komisioni ose nga një autoritet mbikëqyrës nuk duhet të pengojë kontrolluesit ose përpunuesit nga përfshirja e klauzolave standarde të mbrojtjes së të dhënave në një kontratë më të gjerë, si një kontratë ndërmjet përpunuesit dhe një përpunuesi tjetër, dhe as të shtojnë klauzola të tjera ose garanci shtesë, me kusht që ato të mos jenë në kundërshtim, drejtpërdrejtë ose jo, klauzolat standarde kontraktuale të miratuara nga Komisioni ose një autoritet tjetër mbikëqyrës, apo dëmtues ndaj të drejtave ose lirive themelore të subjekteve të të dhënave. Kontrolluesit dhe përpunuesit duhet të inkurajohen të japin garanci shtesë nëpërmjet angazhimeve kontraktuale që plotësojnë klauzolat standarde të mbrojtjes.

(110) Një grup sipërmarrjesh ose një grup ndërmarrjesh të angazhuara në një aktivitet të përbashkët ekonomik duhet të jenë në gjendje të përdorë rregullat e aprovuara detyruese të brendshme për transferimet e tij ndërkombëtare nga Bashkimi tek organizatat brenda të njëjtit grup sipërmarrjesh ose ndërmarrjesh të angazhuara në një aktivitet të përbashkët ekonomik, me kusht që këto rregulla të brendshme të përfshijnë të gjitha parimet thelbësore dhe të drejtat e ekzekutueshme për të dhënë garanci të përshtatshme për transferimin ose kategoritë e transferimeve të të dhënave personale.

(111) Duhet të hartohen dispozita për mundësinë e transferimeve në rrethana të caktuara kur subjekti i të dhënave ka dhënë shprehimisht pëlqimin e tij ose të saj, kur transferimi është rastësor dhe i nevojshëm në lidhje me një kontratë ose pretendim juridik, pavarësisht nëse është procedurë gjyqësore apo një procedurë tjetër administrative ose jashtë gjyqësore, duke përfshirë procedurat para organeve rregullatore. Duhet të hartohen dispozita edhe për mundësinë për transferime kur ka shkaqe të rëndësishme të interesit publik të parashikuar në të drejtën e Bashkimit ose të Shtetit Anëtar që e kërkojnë këtë ose nëse transferimi bëhet nga një regjistër i ngritur me ligj dhe është i destinuar për tu këqyruar nga publiku ose persona që kanë një interes të ligjshëm. Në rastin e fundit, një transferim i tillë nuk duhet të përfshijë tërësinë e të dhënave personale ose të gjitha kategoritë e të dhënave që gjenden në regjistër dhe nëse regjistri është i destinuar për tu këqyruar nga persona që kanë një interes të ligjshëm, transferimi duhet të bëhet vetëm me kërkesë të atyre personave ose, nëse ata duhet të jenë marrësit, duke marrë parasysh tërësisht interesat dhe të drejtat themelore të subjektit të të dhënave.

(112) Këto shmangie duhet të zbatohen veçanërisht për transferimet e të dhënave që kërkohen dhe janë të nevojshme për shkaqe të rëndësishme të interesit publik, për shembull në rastin e shkëmbimit ndërkombëtar të të dhënave ndërmjet autoriteteve të konkurrencës, administrative tatimore ose doganore, ndërmjet autoriteteve financiare mbikëqyrëse, ndërmjet shërbimeve kompetente për çështjet e sigurisë sociale ose për shëndetin publik për shembull në rastin e gjurmimit të kontaktit për sëmundjet ngjitëse ose me qëllim që të reduktohet dhe/ose eliminohet dopingi në sport. Një transferim i të dhënave personale duhet të konsiderohet gjithashtu i ligjshëm nëse është i nevojshëm për të mbrojtur një interes që është thelbësor për interesat e subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër, duke përfshirë integritetin fizik ose jetën, nëse subjekti i të dhënave nuk është në gjendje për të dhënë pëlqimin. Në mungesë të një vendimi përshtatshmërie, e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar, për shkaqe të rëndësishme të interesit publik, mund të caktojë shprehimisht kufij për transferimin e kategorive specifike të të dhënave në një vend i tretë ose organizatë ndërkombëtare.

Shtetet Anëtare duhet t'ia njoftojnë këto dispozita Komisionit. Çdo transferim tek një organizatë ndërkombëtare humanitare i të dhënave personale të një subjekti të dhënash që është fizikisht ose ligjërish jo në gjendje të japë pëlqimin, me synim kryerjen e një detyre që i takon në pajtim me Konventat e Gjenevës ose për të respektuar të drejtën ndërkombëtare humanitare të zbatueshme për konfliktet e armatosura, mund të konsiderohet të jetë i nevojshëm për një shkak të rëndësishëm të interesit publik ose për shkak se është në interesin jetik të subjektit të të dhënave.

(113) Transferimet që mund të kualifikohen si jo përsëritëse dhe që kanë të bëjnë vetëm me një numër të kufizuar të subjekteve të të dhënave mund të ishin të mundshme për qëllimet e interesave detyruese legjitime të ndjekura nga kontrolluesi, nëse këto interesa nuk tejkalohen nga interesat ose liritë dhe të drejtat e subjektit të të dhënave dhe nëse kontrolluesi ka vlerësuar të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me transferimin e të dhënave. Kontrolluesi duhet të marrë në konsideratë të veçantë natyrën e të dhënave personale, qëllimin dhe kohëzgjatjen e operacionit ose operacioneve të propozuara përpunuese, si dhe situatën në vendin e origjinës, vendin e tretë dhe vendin e destinacionit të fundit, dhe duhet të parashikojë garanci të përshtatshme për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore për personat fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale. Këto transferime duhet të jenë të mundshme vetëm në rastet e mbetura dhe nëse nuk zbatohet asnjë nga shkaqet e tjerë për transferimin. Për qëllimet e kërkimit shkencor dhe historik ose për qëllime statistikore, pritshmëria e ligjshme e shoqërisë për rritjen e njohurive duhet të merret parasysh. Kontrolluesi duhet të njoftojë autoritetin mbikëqyrës dhe subjektin e të dhënave në lidhje me transferimin.

(114) Në çdo rast, nëse Komisioni nuk ka marrë vendim për nivelin e përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave në një vend të tretë, kontrolluesi ose përpunuesi duhet të përdorë zgjidhjet që u japin subjekteve të të dhënave të drejta efektive në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre në Bashkim, menjëherë pasi ato të dhëna të jenë transferuar në mënyrë që ato të vazhdojnë të përfitojnë nga të drejtat themelore dhe garancitë.

(115) Disa vende të tretë miratojnë ligje, rregullore ose akte të tjera ligjore që synojnë të rregullojnë drejtpërdrejtë aktivitetet e përpunimit të personave fizikë dhe juridikë nën juridiksionin e Shteteve Anëtare. Kjo mund të përfshijë vendime të gjykatave ose tribunaleve ose vendime të autoriteteve administrative në vendet e treta që i kërkojnë një kontrolluesi ose përpunuesi të transferojë ose deklarojë të dhënat personale, dhe që nuk bazohen në një marrëveshje ndërkombëtare, si një traktat i ndihmës juridike të ndërsjellë, në fuqi ndërmjet vendit të tretë kërkues dhe Bashkimit ose një Shteti Anëtar. Zbatimi ekstra-territorial i këtyre ligjeve, rregulloreve dhe akteve të tjera ligjore mund të jetë në shkelje të së drejtës ndërkombëtare dhe mund të pengojë arritjen e mbrojtjes së personave fizikë që është garantuar në Bashkim nga kjo Rregullore. Transferimet duhet të lejohen vetëm atëherë nëse përmbushen kushtet e kësaj Rregulloreje për një transferim në një vend të tretë. Ky, ndërmjet të tjerash, mund të jetë rasti kur deklarimi është i nevojshëm për një shkak të rëndësishëm të interesit publik të njohur në të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet kontrolluesi.

(116) Nëse të dhënat personale dalin jashtë kufijve të Bashkimit, kjo mund të shkaktojë një risk të shtuar në lidhje me aftësinë e personave fizikë të ushtrojnë të drejtat për mbrojtjen e të dhënave veçanërisht për tu mbrojtur ndaj përdorimit ose deklarimit të paligjshëm të atij informacioni. Në njëjtën kohë, autoritetet mbikëqyrëse mund të konstatojnë që ato nuk janë në gjendje të ndjekin

ankimet ose zhvillojnë hetime në lidhje me aktivitetet jashtë kufijve të tyre. Përpjekjet e tyre për të punuar së bashku në kontekstin ndërkufitar mund të pengohet gjithashtu nga kompetenca të pamjaftueshme parandaluese ose kompensuese, regjimet juridike të papërputhshme dhe pengesa praktike si kufizimet në burimet. Kështu, është e nevojshme të nxitet bashkëpunim më i ngushtë ndërmjet autoriteteve mbikëqyrës të mbrojtjes së të dhënave për të ndihmuar shkëmbimin e informacionit dhe për të kryer hetime me homologët e tyre ndërkombëtarë. Për qëllimet e zhvillimit të mekanizmave të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe për të dhënë ndihmë të ndërsjellë ndërkombëtare për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, Komisioni dhe autoritetet mbikëqyrës duhet të shkëmbejnë informacion dhe bashkëpunojnë në aktivitetet për ushtrimin e kompetencave të tyre me autoritetet kompetente në vendet e treta, bazuar në reciprocitet dhe në pajtim me këtë Rregullore.

(117) Themelimi i autoriteteve mbikëqyrës në Shtetet Anëtare, të autorizuara për të përmbushur detyrat e tyre dhe ushtruar kompetencat e tyre me pavarësi të plotë, është një komponent thelbësor i mbrojtjes së personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale. Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të ngrenë më shumë se një autoritet mbikëqyrës, për të reflektuar strukturën e tyre kushtetuese, organizative dhe administrative.

(118) Pavarësia e autoriteteve mbikëqyrëse nuk duhet të nënkuptojë që autoritetet mbikëqyrëse nuk mund tu nënshtrohen mekanizmave të kontrollit ose monitorimit në lidhje me shpenzimet e tyre financiare ose rishikimit gjyqësor.

(119) Nëse një Shtet Anëtar ngre disa autoritete mbikëqyrëse, ai duhet të përcaktojë me ligj mekanizmat për të garantuar pjesëmarrjen e efektshme të atyre autoriteteve mbikëqyrës në mekanizmin e përputhshmërisë. Ky Shtet Anëtar duhet që veçanërisht të caktojë autoritetin mbikëqyrës që funksionon si pikë kontakti e vetme për pjesëmarrjen efektive të atyre autoriteteve në mekanizëm, për të garantuar bashkëpunimin e rrjedhshëm dhe të shpejtë me autoritetet e tjerë mbikëqyrës, Bordin dhe Komisionin.

(120) Çdo autoritet mbikëqyrës duhet të pajiset me burimet financiare dhe njerëzore, mjediset dhe infrastrukturën e nevojshme për përmbushjen e efektshme të detyrave të tij, duke përfshirë ato në lidhje me ndihmën e ndërsjellë dhe bashkëpunimin me autoritetet e tjerë mbikëqyrës në të gjithë Bashkimin. Secili autoritet mbikëqyrës duhet të ketë një buxhet të veçantë, publike dhe vjetor, që mund të jetë pjesë e buxhetit të përgjithshëm të shtetit ose kombëtar.

(121) Kushtet e përgjithshme për anëtarin ose anëtarët e autoritetit mbikëqyrës duhet të parashikohen me ligj në çdo shtet anëtar dhe duhet veçanërisht të parashikojë që ata anëtar të njihen, nëpërmjet një procedure transparente, nga parlamenti, qeveria ose kreu i Shtetit të Shtetit Anëtar mbi bazën e një propozimi nga qeveria, një anëtar i qeverisë, parlamenti ose një dhomë e parlamentit ose nga një organ i pavarur i ngarkuar sipas ligjit të Shtetit Anëtar. Me qëllim që të garantohet pavarësia e autoritetit mbikëqyrës, anëtari ose anëtarët duhet të veprojnë me integritet, të kufizohen ndaj çdo veprimi që nuk është në pajtim me detyrat e tyre dhe, gjatë mandatit të detyrës, nuk duhet të angazhohen në aktivitete të papërshtatshme, fitimprurëse apo jo. Autoriteti mbikëqyrës duhet të ketë personelin e tij të zgjedhur nga autoriteti mbikëqyrës ose një organ i pavarur i ngritur sipas ligjit të Shtetit Anëtar, që duhet të jetë nën drejtimin ekskluziv të anëtarit ose anëtarëve të autoritetit

mbikëqyrës.

(122) Çdo autoritet mbikëqyrës duhet të jetë kompetent në territorin e Shtetit të tij Anëtar për të ushtruar kompetencat dhe për të përmbushur detyrat që i janë ngarkuar në pajtim me këtë Rregullore. Kjo duhet të mbulojë veçanërisht përpunimin në kontekstin e aktiviteteve të një strukture të kontrolluesit ose përpunuesit në territorin e Shtetit të vet Anëtar, përpunimin e të dhënave personale të kryera nga autoritetet publike ose organet private që veprojnë në interesin publik, përpunimin që prek subjektet e të dhënave në territorin e tij ose përpunimin e kryer nga një kontrollues ose përpunues që nuk është i vendosur në Bashkim nëse synon subjekte të dhënash që banojnë në territorin e tij. Kjo duhet të përfshijë trajtimin e ankimeve të paraqitur nga subjektet e të dhënave, zhvillimin e hetimeve për zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe nxitjen e ndërgjegjësimit publik për risqet, rregullat, garancitë dhe të drejtat në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

(123) Autoritetet mbikëqyrëse duhet të monitorojnë zbatimin e dispozitave në pajtim me këtë Rregullore dhe të kontribuojnë në zbatimin e tij të njëtrajtshëm në të gjithë Bashkimin, me qëllim që të mbrohen personat fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe për të lehtësuar fluksin e lirë të të dhënave personale brenda tregut të brendshëm. Për këtë qëllim, autoritetet mbikëqyrës duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me Komisionin, pa qenë e nevojshme ndonjë marrëveshje ndërmjet Shteteve Anëtare për dhënien e ndihmës së ndërsjellë ose për një bashkëpunim të tillë.

(124) Nëse përpunimi i të dhënave personale kryhet në kontekstin e aktiviteteve të një strukture të një kontrolluesi ose përpunuesi në Bashkim dhe kontrolluesi ose përpunuesi është vendosur në më shumë se një shtet Anëtar, ose nëse përpunimi që kryhet në kontekstin e aktiviteteve të një strukture të vetme të kontrolluesit ose përpunuesit në Bashkim ndikon thelbësisht ose mund të ndikojë thelbësisht subjektet e të dhënave në më shumë se një Shtet Anëtar, autoriteti mbikëqyrës për strukturën kryesore të kontrolluesit ose përpunuesit ose për strukturën e vetme të kontrolluesit ose përpunuesit duhet të veprojë si autoritet epror. Ai duhet të bashkëpunojë me autoritetet e tjera të interesuar, pasi kontrolluesi ose përpunuesi ka një strukturë në territorin e Shtetit Anëtar të tyre, pasi subjektet e të dhënave që banojnë në territorin e tyre ndikohen në mënyrë thelbësore ose pasi ankesa është paraqitur tek ata. Edhe nëse subjekti i të dhënave që nuk është me banim në atë Shtet Anëtar ka paraqitur ankim, autoriteti mbikëqyrës tek i cili është paraqitur ankimi duhet të jetë një autoritet mbikëqyrës i interesuar. Brenda detyrave të tij për lëshimin e udhëzimeve për çdo çështje që mbulojnë aplikimin e kësaj Rregulloreje, Bordi duhet të jetë në gjendje të nxjerrë udhëzime veçanërisht në lidhje me kriteret që duhet të merren parasysh me qëllim që të konstatohet nëse përpunimi në fjalë ndikon thelbësisht subjektet e të dhënave në më shumë se një Shtet Anëtar dhe për atë që përbën shkak për një kundërshtim të përshtatshëm dhe të arsyetuar.

(125) Autoriteti epror duhet të jetë kompetent për të miratuar vendime detyruese në lidhje me masat që zbatohen kompetencat e dhëna në pajtim me këtë Rregullore. Në cilësinë e tij si autoritet epror, autoriteti mbikëqyrës duhet të angazhohet ngushtësisht dhe të koordinojë autoritetet mbikëqyrës përkatës në procesin e vendimmarrjes. Nëse vendimi duhet të rrëzojë ankesën e subjektit të të dhënave pjesërisht ose plotësisht, ky vendim duhet të miratohet nga autoriteti mbikëqyrës ku ankimi është bërë.

(126) Për vendimin duhet të bihet dakord bashkërisht nga autoriteti mbikëqyrës epror dhe

autoritetet mbikëqyrës të interesuar dhe duhet të drejtohen drejt strukturës kryesore ose të vetme të kontrolluesit ose përpunuesit dhe të jetë detyrues për kontrolluesin ose përpunuesin. Kontrolluesi ose përpunuesi duhet të marrë masat e nevojshme për të garantuar përputhshmërinë me këtë Rregullore dhe zbatimin e vendimit të njoftuar nga autoriteti mbikëqyrës epror për strukturën kryesore të kontrolluesit ose përpunuesit në lidhje me aktivitetet përpunuese në Bashkim.

(127) Çdo autoritet mbikëqyrës që nuk vepron si autoritet mbikëqyrës epror duhet të jetë kompetent për të trajtuar çështjet lokale ku është vendosur kontrolluesi ose përpunuesi në më shumë se një Shtet Anëtar, por përmbajtja e përpunimit specifik ka të bëjë vetëm me përpunimin e kryer në një Shtet Anëtar të vetëm dhe ka të bëjë vetëm me subjekte të dhënash në atë Shtet të vetëm Anëtar, për shembull, nëse përmbajtja ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale të punëmarrësit në kontestin specifik të punësimit të një Shteti Anëtar. Në këto raste, autoriteti mbikëqyrës duhet të njoftojë autoritetin mbikëqyrës epror pa vonesë në lidhje me çështjen. Pas informimit, autoriteti mbikëqyrës epror duhet të vendosë nëse ai do ta trajtojë çështjen në pajtim me dispozitën për bashkëpunimin ndërmjet autoritetit mbikëqyrës epror dhe autoriteteve të tjera mbikëqyrës të interesuar ('mekanizmi me një ndalesë'), ose nëse autoriteti mbikëqyrës që e ka informuar duhet ta trajtojë çështjen në nivel lokal. Për vendimmarrjen nëse do ta trajtojë vetë çështjen, autoriteti mbikëqyrës epror duhet të marrë parasysh nëse ekziston ndonjë strukturë e kontrolluesit ose përpunuesit në Shtetin Anëtar të autoritetit mbikëqyrës që e ka informuar me qëllim që të garantohet një ekzekutim i efektshëm i vendimit kundrejt kontrolluesit ose përpunuesit. Nëse autoriteti mbikëqyrës epror vendos ta trajtojë çështjen vetë, autoriteti mbikëqyrës që e ka informuar atë duhet të ketë mundësinë të paraqesë një projekt për vendimin, për të cilin autoriteti mbikëqyrës duhet të marrë veçanërisht parasysh në përgatitjen e projekt-vendimit sipas mekanizmit me një ndalesë.

(128) Rregullat për autoritetin mbikëqyrës epror dhe mekanizmin me një ndalesë nuk duhet të zbatohen kur përpunimi kryhet nga autoritetet publike ose organet private në interesin publik. Në këto raste, i vetmi autoriteti mbikëqyrës kompetent për të ushtruar kompetencat e dhëna atij në pajtim me këtë Rregullore duhet të jetë autoriteti mbikëqyrës i Shtetit Anëtar ku është vendosur autoriteti publik ose organi privat.

(129) Me qëllim që të garantohet monitorimi dhe ekzekutimi i njëtrajtshëm i kësaj Rregulloreje në të gjithë Bashkimin, autoritetet mbikëqyrëse duhet të kenë në çdo Shtet Anëtar të njëjtat detyra dhe kompetenca efektive, duke përfshirë kompetencat e hetimit, kompetencat korrigjuese dhe sanksionet, dhe kompetenca autorizuese dhe këshillimore, veçanërisht në rastet e ankimeve nga personat fizikë, dhe pa cenuar kompetencat e autoriteteve të prokurorisë sipas ligjit të Shtetit Anëtar, për të sjellë shkeljet e kësaj Rregulloreje në vëmendje të autoriteteve gjyqësore dhe të përfshihen në procedime gjyqësore. Këto kompetenca duhet të përfshijnë gjithashtu kompetencën për të vendosur një kufizim të përkohshëm ose të përhershëm, duke përfshirë një ndalim, për përpunimin. Shtetet Anëtare mund të specifikojnë detyra të tjera në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale sipas kësaj Rregulloreje. Kompetencat e autoriteteve mbikëqyrëse duhet të ushtrohen në pajtim me garancitë e përshtatshme procedurale të përcaktuara në të drejtën e Bashkimit dhe Shtetit Anëtar, në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm. Veçanërisht secila masë duhet të jetë e përshtatshme, e nevojshme dhe proporcionale, duke pasur parasysh përputhshmërinë me këtë Rregullore, duke marrë parasysh rrethanat në çdo rast konkret, respektimin e së drejtës së çdo personi për tu dëgjuar para marrjes së çdo mase individuale që mund të prekë atë negativisht, dhe të mënjanojë shpenzimet e tepërta dhe papërshtatshmëritë e tepërta për personat e interesuar. Kompetencat hetimore në lidhje me

aksesin në mjedise duhet të ushtrohen në pajtim me kërkesat specifike në të drejtën procedurale të Shtetit Anëtar, si kërkesa për të marrë paraprakisht autorizim gjyqësor. Çdo masë ligjërishit detyruese e autoriteti mbikëqyrës duhet të jetë më shkrim, e qartë dhe prerë, të tregojë autoritetin mbikëqyrës që e ka nxjerrë masën, datën e lëshimit të masës, të ketë nënshkrimin e kreut ose anëtarit të autoritetit mbikëqyrës të autorizuar prej tij ose saj, të japë shkaqet për masën dhe ti referohet së drejtën për një mjet mbrojtës të efektshëm. Kjo nuk duhet të përjashtojë kërkesat shtesë në pajtim me të drejtën procedurale të Shtetit Anëtar. Miratimi i një vendimi ligjërishit detyrues nënkupton që ai mund të bëhet shkak për rishikim gjyqësor në Shtetin Anëtar të autoritetit mbikëqyrës që ka miratuar vendimin.

(130) Nëse autoriteti mbikëqyrës ku është paraqitur ankimi nuk është autoriteti mbikëqyrës epror, autoriteti mbikëqyrës epror duhet të bashkëpunojë ngushtë me autoritetin mbikëqyrës ku është paraqitur ankimi në pajtim me dispozitat mbi bashkëpunimin dhe përputhshmërinë të parashikuar në këtë Rregullore. Në këto raste, autoriteti mbikëqyrës epror, gjatë marrjes së masave që synojnë të prodhojnë efekte ligjore, duke përfshirë caktimin e gjobave administrative, duhet të marrë parasysh mendimin e autoritetit mbikëqyrës ku është paraqitur ankimi dhe që duhet të mbetet kompetent për të kryer çdo hetim në territorin e Shtetit Anëtar të vet në bashkëpunim me autoritetin mbikëqyrës kompetent.

(131) Nëse si autoritet mbikëqyrës epror duhet të veprojnë një autoritet tjetër mbikëqyrës për aktivitetet përpunuese të kontrolluesit ose përpunuesit por objekti konkret i ankimit ose shkelja e mundshme ka të bëjë vetëm me aktivitetet përpunuese të kontrolluesit ose përpunuesit në Shtetin Anëtar ku është paraqitur ankimi ose është zbuluar shkelja e mundshme dhe çështja nuk ndikon thelbësisht ose nuk mund të ndikojë thelbësisht subjektet e të dhënave në Shtetet e tjerë Anëtarë, autoriteti mbikëqyrës që merr ankimin ose zbulon apo informohet ndryshe për situata që kanë të bëjnë me shkelje të mundshme të kësaj Rregulloreje duhet të kërkojnë një zgjidhje me pajtim tek kontrolluesi dhe, nëse kjo nuk ka sukses, ushtron të gjithë gamën e vet të kompetencave. Kjo duhet të përfshijë: përpunimin specifik të kryer në territorin e Shtetit Anëtar të autoritetit mbikëqyrës ose në lidhje me subjektet e të dhënave në territorin e atij Shteti Anëtar; përpunimin që kryhet në kontekstin e një oferte mallrash ose shërbimesh që synojnë specifikisht subjektet e të dhënave në territorin e Shtetit Anëtar të autoritetit mbikëqyrës; ose përpunimin që duhet të vlerësohet duke marrë parasysh detyrimet përkatëse ligjore sipas së drejtës së Shtetit Anëtar.

(132) Aktivitetet për ngritjen e ndërgjegjësimit nga autoritetet mbikëqyrëse që i drejtohen publikut duhet të përfshijnë masat specifike që drejtohen ndaj kontrolluesve dhe përpunuesve, duke përfshirë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe personat fizikë veçanërisht në kontestin edukativ.

(133) Autoritetet mbikëqyrëse duhet të asistojnë njëri-tjetrin në përmbushjen e detyrave të tyre dhe të japin asistencë, në lidhje me sigurimin e zbatimit dhe aplikimit të njëtrajtshtëm të kësaj Rregulloreje në tregun e brendshëm. Një autoritet mbikëqyrës që kërkon ndihmë të ndërsjellë mund të miratojë masa provizore nëse ai nuk merr përgjigje ndaj një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë brenda një muaji nga marrja e asaj kërkesë nga autoriteti mbikëqyrës.

(134) Çdo autoritet mbikëqyrës, sipas rastit, duhet të marrë pjesë në operationet e përbashkëta me autoritetet e tjerë mbikëqyrës. Autoriteti mbikëqyrës i kërkuar duhet të jetë i detyruar ti përgjigjet një kërkesë brenda një periudhe të caktuar kohe.

(135) Për të siguruar zbatimin e njëtrajtshëm të kësaj Rregulloreje në të gjithë Bashkimin, duhet të ngrihet një mekanizëm përputhshmërie për bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse. Ky mekanizëm duhet të zbatohet veçanërisht nëse autoriteti mbikëqyrës synon të miratojë një masë që është e destinuar të prodhojë efekte ligjore në lidhje me operacionet e përpunimit që thelbësisht ndikojnë një numër të konsiderueshëm subjektësh të të dhënave në disa Shtete Anëtare. Ai duhet të zbatohet gjithashtu nëse një autoritet mbikëqyrës i interesuar ose Komisioni kërkon që kjo çështje duhet të trajtohet në mekanizmin e përputhshmërisë. Ky mekanizëm duhet të mos cenojë masat që Komisioni mund të marrë në ushtrim të kompetencave të tij sipas Traktateve.

(136) Në zbatimin e mekanizmit të përputhshmërisë, Bordi, brenda një periudhe të caktuar kohe, duhet të nxjerrë një opinion, nëse shumica e anëtarëve të tij vendos kështu ose nëse kjo i kërkohet nga një autoritet mbikëqyrës i interesuar ose Komisioni. Bordi duhet të autorizohet gjithashtu të miratojë vendime ligjorisht detyruese nëse ka mosmarrëveshje ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse. Për këtë synim, duhet të nxjerrë, në parim me një shumicë prej dy të tretat e anëtarëve të tij, vendime ligjorisht detyruese në çështjet qartësisht të specifikuar nëse ka mendime kontradiktore ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse, veçanërisht në mekanizmat e bashkëpunimit ndërmjet autoritetit mbikëqyrës epror dhe autoriteteve mbikëqyrëse mbi themelin e çështjes, veçanërisht nëse ka shkelje të kësaj Rregulloreje.

(137) Mund të jetë e nevojshme urgjentisht për të vepruar për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave, veçanërisht nëse ekziston rrezik që realizimi i një të drejte të një subjekti të dhënash mund të pengohet në masë të konsiderueshme. Një autoritet mbikëqyrës duhet të jetë në gjendje të miratojë rregullisht masat provizore të justifikuar në territorin e vet brenda një periudhe kohe të specifikuar vlefshmërie që nuk duhet të kalojë tre muaj.

(138) Aplikimi i nj mekanizmi të tillë duhet të jetë kusht për ligjshmërinë e një mase që synon të prodhojë efektet ligjore nga një autoritet mbikëqyrës në ato raste kur aplikimi është i detyrueshëm. Në rastet e tjera të një rëndësie ndërkufitare, duhet të zbatohet mekanizmi i bashkëpunimit ndërmjet autoritetit mbikëqyrës epror dhe autoriteteve mbikëqyrës përkatës dhe ndihma e ndërsjellë dhe operacionet e përbashkëta mund të kryhet ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse përkatëse në një bazë dypalëshe ose shumëpalëshe pa vënë në lëvizje mekanizmin e përputhshmërisë.

(139) Me qëllim që të nxitet aplikimi i njëtrajtshëm i kësaj Rregulloreje, Bordi duhet të ngrejë një organ të pavarur të Bashkimit. Për të përmbushur objektivat e veta, Bordi duhet të ketë personalitet juridik. Bordi duhet të përfaqësohet nga Kryetari. Ai duhet të zëvendësojë Palën e Punës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale të ngritur nga direktiva 95/46/KE. Ai duhet të përbëhet nga kreu i organit mbikëqyrës i çdo Shteti Anëtar dhe Mbikëqyrëse Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave ose përfaqësuesit e tyre përkatës. Komisioni duhet të marrë pjesë në aktivitetet e Bordit pa të drejtë votimi dhe Mbikëqyrësi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave duhet të ketë të drejta specifike votimi. Bordi duhet të kontribuojë në aplikimin e njëtrajtshëm të kësaj Rregulloreje në të gjithë Bashkimin, duke përfshirë nëpërmjet këshillimit të Komisionit, veçanërisht në nivelin e mbrojtjes në vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare dhe duke nxitur bashkëpunimin e autoriteteve mbikëqyrëse në të gjithë Bashkimin. Bordi duhet të veprojë në mënyrë të pavarur në përmbushje të detyrave të tij.

(140) Bordi duhet të asistohet nga një sekretariat i ofruar nga Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave. Personeli i Mbikëqyrësit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave të përfshirë në

përmbushjen e detyrave të caktuara Bordit nga kjo Rregullore duhet të kryejë detyrat e tij ekskluzivisht sipas udhëzimeve dhe duke i raportuar Kryetarit të Bordit.

(141) Çdo subjekt të dhënash duhet të ketë të drejtën të paraqesë një ankesë tek një autoritet caktuar mbikëqyrës, veçanërisht në Shtetin Anëtar të vendbanimit të tij ose të saj të zakonshëm dhe të drejtën të ketë një mjet mbrojtjeje të efektshëm gjyqësor sipas nenit 47 të kartës nëse subjekti i të dhënave është i mendimit që të drejtat e tij ose të saj sipas Rregulloreje janë shkelur ose nëse autoriteti mbikëqyrës nuk vepron në bazë të një ankimi, pjesërisht ose tërësisht refuzon ose e pushon një ankim ose nuk vepron nëse një veprim i tillë është i nevojshëm për të mbrojtur të drejtat e subjekteve të të dhënave. Hetimi që pason një ankim duhet të kryhet, duke iu nënshtruar rishikimit gjyqësor, në masën që është i përshtatshëm në një çështje specifike. Autoriteti mbikëqyrës duhet të njoftojë subjektin e të dhënave në lidhje me përparimin dhe rezultatin e ankimit brenda një afati të arsyeshëm. Nëse çështja kërkon hetime të mëtejshme ose bashkërendim me një autoritet tjetër mbikëqyrës, subjektit të të dhënave duhet ti jepet informacion i ndërmjetëm. Me qëllim që të lehtësojë paraqitjen e ankimeve, çdo autoritet mbikëqyrës duhet të marrë masa të tilla si parashikimi i një formulari për paraqitjen e kërkesës që mund të mbushet edhe elektronikisht, pa përjashtuar masa të tjera të komunikimit.

(142) Nëse një subjekt të dhënash është i mendimit që të drejtat e tij ose të saj sipas kësaj Rregulloreje janë shkelur, ai ose ajo duhet të ketë të drejtën të autorizojë një organ, organizatë ose shoqatë jo-fitimprurëse që është ngritur në pajtim me ligjin e një Shteti Anëtar, ka objektiva statutores që janë në interesin publik dhe është aktive në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale për të paraqitur një ankim në emër të tij ose të saj tek një autoritet mbikëqyrës, të ushtrojë të drejtën nëpërmjet një mjeti gjyqësor mbrojtës në emër të subjekteve të të dhënave ose, nëse parashikohet nga e drejta e Shtetit Anëtar, të ushtrojë të drejtën për të marrë kompensim në emër të subjekteve të të dhënave. Një Shtet Anëtar mund të parashikojë një organ, organizatë ose shoqatë të tillë për të pasur të drejtën të paraqesë ankime në atë Shtet Anëtar, pavarësisht nga mandati i subjektit të të dhënave, dhe të drejtën për një mjet gjyqësor mbrojtës nëse ka shkak për të menduar që të drejtat e një subjekti të dhënash janë shkelur si rezultat i përpunimit të të dhënave personale që shkel këtë Rregullore. Ky organ, organizatë ose shoqatë mund të mos lejohet të pretendojë kompensim në emër të subjektit të të dhënave në mënyrë të pavarur nga mandati i subjektit të të dhënave.

(143) Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën të ngrejë padi për anulimin e vendimeve të Bordit në Gjykatën e Drejtësisë sipas kushteve të parashikuara në Nenin 263 të TFEU-së. Si të adresuar të këtyre vendimeve, autoritetet mbikëqyrëse të interesuar që dëshirojnë ti kundërshtojnë ata duhet të ngrijnë padi brenda dy muajve nga njoftimi për ta, në pajtim me Nenin 263 i TFEU-së. Nëse vendimet e Bordit janë me interes të drejtpërdrejtë dhe individual për një kontrollues, përpunues ose ankimues, ky i fundit mund të ngrejë një padi për anulimin e këtyre vendimeve brenda dy muajve nga publikimi i tyre në faqen e internetit të Bordit, në pajtim me nenin 263 të TFEU-së. Pa cenuar këtë të drejtë sipas Nenit 263 të TFEU-së, çdo person fizik ose juridik duhet të ketë një mjet të efektshëm gjyqësor mbrojtës para gjykatës së brendshëm kompetente ndaj një vendimi të një autoriteti mbikëqyrësi që prodhon efekte ligjore për atë person. Një vendim i tillë ka të bëjë veçanërisht me ushtrimin e kompetencave hetimore, korrigjuese dhe autorizuese nga autoriteti mbikëqyrës ose refuzimin ose pushimin e ankimit. Megjithatë, e drejta për një mjet të efektshëm gjyqësor mbrojtës nuk përfshin masat e marra nga autoritetet mbikëqyrëse që nuk janë ligjërisht detyruese, si mendimet e nxjerra ose këshillimi i dhënë nga autoriteti mbikëqyrës. Gjykimet ndaj një autoriteti mbikëqyrës

duhet të fillojnë para gjykatave të Shtetit Anëtar ku është ngritur autoriteti mbikëqyrës dhe duhet të zhvillohen në pajtim me ligjin procedural të Shteti Anëtar. Këto gjykata duhet të ushtrojnë juridiksion të plotë që duhet të përfshijë juridiksionin për të shqyrtuar të gjitha çështjet e faktit dhe ligjit që kanë të bëjnë me mosmarrëveshjen para tyre.

Nëse një ankim është refuzuar ose pushuar nga një autoritet mbikëqyrës, ankimesi mund të nisë gjykimin në gjykatat e të njëjtit Shtet Anëtar. Në kontekstin e mjeteve mbrojtëse gjyqësore në lidhje me zbatimin e kësaj Rregulloreje, gjykatat e brendshme që e konsiderojnë një vendim në lidhje me një çështje të nevojshëm për tu mundësuar atyre të dalin me një vendim mund të kërkojnë, ndërsa në rastin e parashikuar në Nenin 267 të TFEU-së, duhet ti kërkojnë Gjykatës së Drejtësisë të japë një vendim paraprak për interpretimin e së drejtës së Bashkimit, duke përfshirë këtë Rregullore. Për më tepër, nëse një vendim i autoritetit mbikëqyrës që zbaton një vendim të Bordit kundërshtohet para një gjykate të brendshme dhe bëhet fjalë për vlefshmërinë e vendimit të Bordit, kjo gjykatë e brendshme nuk ka kompetencë të deklarojë të pavlefshëm vendimin e Bordit, por duhet t'ia referojë çështjen e vlefshmërisë Gjykatës së Drejtësisë në pajtim me Nenin 267 të TFEU-së, sipas interpretimit të Gjykatës së Drejtësisë, nëse ajo e konsideron vendimin të pavlefshëm. Megjithatë, një gjykatë e brendshme nuk mund ta referojë një çështje në lidhje me vlefshmërinë e vendimit të Bordit me kërkesë të një personi fizik ose juridik që kishte mundësinë të ngrinte një padi për anulimin e atij vendimi, veçanërisht nëse ai ka qenë individualisht dhe drejtpërdrejtë i interesuar për atë vendim, por nuk e ka bërë atë brenda afatit të parashikuar në Nenin 263 të TFEU-së.

(144) Nëse një gjykatë e investuar në një gjykim ndaj një vendimi të një autoriteti mbikëqyrës ka shkak për të besuar që gjykimi në lidhje me të njëjtin përpunim, si i njëjti objekt në lidhje me përpunimin nga i njëjti kontrollues ose përpunues, ose i njëjti shkak padie, ka filluar në një gjykatë kompetente në një Shtet tjetër anëtar, ajo duhet të kontaktojë atë gjykatë me qëllim që të konfirmojë ekzistencën e këtyre gjykimeve të lidhura. Nëse një gjykim i lidhur ka filluar në një gjykatë në një Shtet tjetër Anëtar, secila gjykatë përveç asaj që ka investuar në fillim mund të pezullojë gjykimin dhe, me kërkesë të një prej palëve, të shpallë mungesën e juridiksionit në favor të gjykatës së investuar fillimisht nëse ajo gjykatë ka juridiksion mbi gjykimin në fjalë dhe ligji i saj e lejon bashkimin e këtyre gjykimeve të lidhura. Gjykimet konsiderohen të jenë të lidhura nëse ato janë të lidhura aq ngushtë sa është e dobishme që të shqyrtohen dhe vendosen së bashku me qëllim që të mënjanohet risku i vendimeve kontradiktore që rrjedhin nga gjykime të veçanta.

(145) Në lidhje me gjykimet në ngarkim të një kontrolluesi ose përpunuesi, paditësi duhet të ketë zgjedhjen për të ngritur padi në gjykatat e Shteteve Anëtare ku kontrolluesi ose përpunuesi ka një strukturë ose ku subjekti i të dhënave është me vendbanim, përveç kur kontrolluesi është një autoritet publik i një Shteti Anëtar i cili vepron në përmbushje të kompetencave publike.

(146) Kontrolluesi ose përpunuesi duhet të kompensojë çdo dëm që mund të pësojë një person si rezultat i përpunimit që shkel këtë Rregullore. Kontrolluesi ose përpunuesi duhet të përjashtohet nga përgjegjësia nëse ai provon që ai nuk është në asnjë mënyrë përgjegjës për dëmin. Koncepti i dëmit duhet të interpretohet më gjerë nën dritën e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë në një mënyrë që reflekton tërësisht objektivat e kësaj Rregulloreje. Kjo nuk cenon asnjë pretendim për dëmet që rrjedhin nga shkelja e rregullave të tjera të të drejtës së Bashkimit ose të Shtetit Anëtar. Përpunimi që shkel këtë Rregullore përfshin gjithashtu përpunimin që shkel aktet e deleguar dhe zbatuese që janë miratuar në pajtim me këtë Rregullore dhe të drejtën e Shtetit Anëtar që specifikon

rregullat e kësaj Rregulloreje. Subjektet e të dhënave duhet të marrin kompensim të plotë dhe të efektshëm për dëmin që kanë pësuar. Nëse kontrolluesit ose përpunuesit janë përfshirë në të njëjtin përpunim, secili kontrollues ose përpunues duhet të mbahet përgjegjës për të gjithë dëmin. Megjithatë, nëse ata janë pjesëmarrës në të njëjtin gjykim, në pajtim me të drejtën e Shtetit Anëtar, kompensimi mund të pjesëtohet sipas përgjegjësisë përkatëse të kontrolluesit ose përpunuesit për dëmin e shkaktuar nga përpunimi, me kusht që të garantohet kompensimi i efektshëm i subjektit të të dhënave që ka pësuar dëmin. Çdo kontrollues ose përpunues i cili ka paguar kompensimin e plotë mund të ngrejë më vonë padi regresi ndaj kontrolluesve ose përpunuesve të përfshirë në të njëjtin përpunim.

(147) Nëse kjo Rregullore përmban rregulla të specifikuar mbi juridiksionin, veçanërisht në lidhje me gjykimet për kërkimin e mbrojtjes gjyqësore duke përfshirë kompensimin ndaj një kontrolluesi ose përpunuesi, rregullat e përgjithshme për juridiksionin si ato të Rregullores (BE) nr 1215/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit nuk duhet të cenojnë zbatimin e këtyre rregullave specifike.

(148) Me qëllim që të fuqizohet zbatimi i rregullave të kësaj Rregulloreje, penalitetet duke përfshirë gjobat administrative duhet të vendosen për çdo shkelje të kësaj Rregulloreje, përveç, ose në vend të masave të përshtatshme që vendosen nga autoriteti mbikëqyrës në pajtim me këtë Rregullore. Në rastin e një shkeljeje të vogël ose nëse gjoba që mund të vendoset do të përbënte një barrë disproporcionale për një person fizik, mund të nxirret një vërejtje në vend të gjobës. Duhet ti kushtohet vëmendja e duhur natyrës, ashpërsisë dhe kohëzgjatjes së shkeljes, karakterit të qëllimshëm të shkeljes, veprimeve të marra për të zbutur dëmin e pësuar, shkallën e përgjegjësisë ose çdo shkelje përkatëse të mëparshme, mënyrën në të cilën shkelja është bërë e ditur për autoritetin mbikëqyrës, përputhshmërinë me masat e caktuara ndaj kontrolluesit ose përpunuesit, respektimi i kodit të sjelljes dhe çdo faktor tjetër rëndësues ose lehtësues. Caktimi i penaliteteve duke përfshirë gjobat administrative duhet t'u nënshtrohet garancive të përshtatshme procedurale në pajtim me parimet e përgjithshme të së drejtës së Bashkimit dhe Kartës, duke përfshirë mbrojtjen gjyqësore efektive dhe procesin e rregullt.

(149) Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të vendosin rregulla mbi dënimet penale për shkak të shkeljes së kësaj Rregulloreje, duke përfshirë për shkeljen e rregullave të brendshme të miratuar në pajtim me brenda kufijve të kësaj Rregulloreje. Këto dënime penale mund të lejojnë gjithashtu heqjen e fitimeve të përftuara nëpërmjet shkeljes së kësaj Rregulloreje. Megjithatë, caktimi i dënimeve penale për shkeljet e këtyre rregullave të brendshme dhe e penaliteteve administrative nuk duhet të çojnë në një shkelje të parimit të *ne bis in idem*, sipas interpretimit nga Gjykata e Drejtësisë.

(150) Me qëllim që të fuqizohet dhe harmonizohen penalitetet administrative për shkeljet e kësaj Rregulloreje, çdo autoritet administrativ duhet të ketë kompetencën të vendosë gjoba administrative. Kjo Rregullore duhet të tregojë shkeljet dhe kufirin maksimal dhe kriteret për caktimin e gjobave administrative, të cilat duhet të përcaktohen nga autoritet mbikëqyrës kompetent në çdo rast të veçantë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse për situatën specifike duke i kushtuar rëndësinë e duhur natyrës, ashpërsisë dhe kohëzgjatjes së shkeljes dhe të pasojave të saj dhe masave të marra për të garantuar përputhshmëri me detyrimet sipas kësaj Rregulloreje dhe për të penguar ose zbutur pasojat e shkeljes. Nëse vendoset gjobë administrative për një ndërmarrje, si ndërmarrje kuptohet të jetë ndërmarrja sipas Nenit 101 dhe 102 të TFEU-së për këto qëllime. Nëse gjobat

administrative vendosen për personat që nuk janë ndërmarrje, autoriteti mbikëqyrës duhet të marrë parasysh nivelin e përgjithshëm të të ardhurave në Shtetin Anëtar, si dhe gjendjen financiare të personit në caktimin e shumës së përshtatshme të gjobës. Mekanizmi i përputhshmërisë mund të përdoret gjithashtu për të nxitur aplikimin e njëtrajtshëm të gjobave administrative. Duhet t'u lihet Shteteve Anëtare të përcaktojnë nëse dhe në cilën masë autoritetet publike duhet tu nënshtrohen gjobave administrative. Caktimi i gjobave administrative ose dhënie e një paralajmërimi nuk cenon aplikimin e kompetencave të tjera të autoriteteve mbikëqyrëse ose të penalteteve të tjera sipas kësaj Rregulloreje.

(151) Sistemet ligjore të Danimarkës dhe Estonisë nuk lejojnë caktimin e gjobave administrative sipas parashikimit të kësaj Rregulloreje. Rregullat për gjobat administrative mund të caktohen në një mënyrë të tillë që në Danimarkë gjoba të vendoset nga gjykatat e brendshme kompetente si një dënim penal dhe në Estoni gjoba vendoset nga autoriteti mbikëqyrës në kuadrin e një gjykimi për kundërvajtjet, me kusht që një aplikimi i tillë i rregullave në ato Shtete Anëtare të kenë një efekt të barasvlershëm me gjobat administrative të vendosura nga autoritetet mbikëqyrëse. Kështu, gjykatat e brendshme kombëtare duhet të marrin parasysh rekomandimin e autoritetit mbikëqyrës që fillon gjobën. Në çdo rast, gjobat e caktuara duhet të jenë efektive, proporcionale dhe penguese.

(152) Nëse kjo Rregullore nuk i harmonizon penaltetet administrative ose, sipas rastit në situata të tjera, për shembull në rastet e shkeljes së rëndë të kësaj Rregulloreje, Shtetet Anëtare duhet të zbatojnë një sistem që parashikon penaltete efektive, proporcionale dhe penguese. Natyra e këtyre penalteteve, penale apo administrative, duhet të përcaktohet nga drejta e Shtetit Anëtar.

(153) E drejta e Shteteve Anëtare duhet të përshtatin rregullat që rregullojnë lirinë e shprehjes dhe informimit, duke përfshirë shprehjen gazetareske, akademike, artistike ose letrare me të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale në pajtim me këtë Rregullore. Përpunimi i të dhënave personale vetëm për qëllime gazetareske ose për qëllimet e shprehjes akademike, artistike ose letrare duhet tu nënshtrohet shmangieve dhe përjashtimeve nga dispozita të caktuara të kësaj Rregulloreje, nëse është e nevojshme të përshtatet e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale me të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informimit, sipas mishërimit në Nenin 11 të Kartës. Kjo duhet të zbatohet veçanërisht për përpunimin e të dhënave personale në sferën audio-vizuale dhe në arkivat e lajmeve dhe libraritë e shtypit. Kështu, Shtetet Anëtare duhet të miratojnë masa legjislative që përcaktojnë përjashtimet dhe shmangiet e nevojshme për qëllimet e balancimit të atyre të drejtave themelore. Shtetet Anëtare duhet të miratojnë këto përjashtime dhe shmangie mbi parimet e përgjithshme, të drejtat e subjektit të të dhënave, kontrolluesit dhe përpunuesit, transferimin e të dhënave personale tek vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare, autoritetet e pavarura mbikëqyrëse, bashkëpunimin dhe vazhdimësinë dhe situatat specifike për përpunimin e të dhënave. Nëse këto përjashtime dhe shmangie ndryshojnë nga një Shtet Anëtar në një tjetër, duhet të zbatohet e drejta e Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet kontrolluesi. Me qëllim që të merret parasysh rëndësia e lirisë së shprehjes në çdo shoqëri demokratike, është e nevojshme të interpretohen këto koncepte në lidhje me lirinë, si gazetaria, në masë të gjerë.

(154) Kjo Rregullore lejon marrjen parasysh të parimit të aksesit publik në dokumentet zyrtare gjatë zbatimit të kësaj Rregulloreje. Aksesit publik tek dokumentet zyrtare mund të konsiderohet të jetë në interes publik. Të dhënat personale në dokumentet e mbajtura nga një autoritet publik ose një organ publik duhet të jenë në gjendje të deklarohen nga ai autoritet ose organ nëse deklarimi është i

parashikuar nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet autoriteti publik ose organi publik. Këto ligje duhet të përshtatin aksesin publik tek dokumentet zyrtare dhe ri-përdorimin e informacionit të sektorit publik me të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe mund të parashikojnë përshtatjen e nevojshme me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale sipas kësaj Rregulloreje. Referenca tek autoritetet publike dhe organet publike duhet të përfshijë në këtë kontekst të gjitha autoritetet ose organet e tjera të mbuluara nga e drejta e Shtetit Anëtar për aksesin publik tek dokumentet. Direktiva 2003/98/KE e parlamentit Evropian dhe e Këshillit (1) lë në fuqi dhe nuk cenon në asnjë mënyrë nivelin e mbrojtjes së personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale sipas dispozitave të së drejtës së Bashkimit dhe shtetit Anëtar, veçanërisht nuk ndryshon detyrimet dhe të drejtat e parashikuara në këtë Rregullore. Veçanërisht, kjo direktivë nuk duhet të zbatohet për dokumentet aksesit tek të cilët është i përjashtuar ose i kufizuar në sajë të regjimeve të aksesit për shkak të mbrojtjes së të dhënave personale dhe pjesët e dokumenteve të aksesueshme në sajë të atyre regjimeve që përmbajnë të dhëna personale ri-përdorimi i të cilave është i parashikuar me ligj të jetë në përputhje me ligjin në lidhje me mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

(155) E drejta e Shtetit Anëtar ose marrëveshjet kolektive, duke përfshirë ‘marrëveshjet e brendshme’, mund të parashikojnë rregulla specifike për përpunimin e të dhënave personale të të punësuarve në kontekstin e punësimit, veçanërisht për kushtet në të cilat të dhënat personale në kontekstin e punësimit mund të përpunohen në bazë të pëlqimit të të punësuarit, qëllimet e rekrutimit, përmbushjen e kontratës së punësimit, duke përfshirë përmbushjen e detyrimeve të parashikuara me ligj ose nga marrëveshjet kolektive, menaxhimi, planifikimi dhe organizimi i punës, barazia dhe diversiteti në vendin e punës, shëndeti dhe sigurimi në punë dhe për qëllimet e ushtrimit dhe gëzimit, në bazë kolektive dhe individuale, të të drejtave dhe përfitimeve në lidhje me punësimin dhe për qëllimet e prishjes së marrëdhënies së punësimit.

(156) Përpunimi i të dhënave personale për qëllimet e arkivimit për qëllimet e interesit publik, shkencor ose historik ose për qëllime statistikore duhet t’u nënshtrohen garancive të përshtatshme për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave sipas kësaj Rregulloreje. Këto garanci duhet të sigurojnë që masat teknike dhe organizative janë në fuqi për të garantuar, veçanërisht, parimin e minimizimit të të dhënave. Përpunimi i mëtejshëm i të dhënave personale për qëllime arkivimi në interes publik, qëllime të kërkimit shkencor dhe historik ose qëllime statistikore duhet të kryhet pasi kontrolluesi të ketë vlerësuar fizibilitetin për të përmbushur qëllimet nëpërmjet përpunimit të të dhënave që nuk lejojnë ose nuk lejojnë më tej identifikimin e subjekteve të të dhënave, me kusht që të ekzistojnë garanci të përshtatshme (si, për shembull, anonimizimi i të dhënave). Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë garanci të përshtatshme për përpunimin e të dhënave personale për qëllime arkivimi në interes publik, për qëllime të kërkimit historik ose shkencor ose qëllime statistikore. Shtetet Anëtare duhet të autorizohen të parashikojnë, në kushte specifike dhe duke iu nënshtuar garancive të përshtatshme për subjektet e të dhënave, specifikimet dhe shmangiet në lidhje me kërkesat për informacion dhe të drejtat për korrigjim, fshirje harrim, kufizimin e përpunimit, portabilitetin e të dhënave dhe kundërshtimit në rastin e përpunimit të të dhënave personale për qëllime arkivimi në interesin publik, qëllimet e kërkimit shkencor ose qëllime statistikore. Kushtet dhe garancitë në fjalë mund të sjellin procedura të veçanta për subjektet e të dhënave për të ushtruar ato të drejta nëse kjo është e përshtatshme në dritën e qëllimeve të ndjekura nga përpunimi specifik së bashku me masat teknike dhe organizative që synojnë minimizimin e përpunimit të të dhënave personale në pajtim me parimet e proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë. Përpunimi i të dhënave personale për qëllime

shkencore duhet të jetë në përputhje me ligjet e tjera përkatëse si për kërkimet klinike.

(157) Duke kryqëzuar informacione nga regjistrat, kërkuesit mund të përftojnë njohuri të reja me vlerë të madhe në lidhje me gjendjet e përhapura mjekësore, si sëmundjet kardiovaskulare, kanceri dhe depresioni. Në bazë të regjistrave mund të përmirësohen rezultatet e kërkimit, pasi ato mbështeten në një popullatë më të gjerë. Brenda shkencës sociale, kërkimi mbi bazën e regjistrave u mundëson kërkuesve të përftojnë njohuri thelbësore në lidhje me bashkërendimin afat-gjatë të një numri gjendjesh sociale, si papunësia dhe arsimi me gjendje të tjera jetësore. Rezultatet e kërkimit të përfutuara nga regjistrat ofrojnë një njohuri të shëndoshë dhe me cilësi të lartë që ofron një bazë për formulimin dhe zbatimin e politikave të bazuara në njohuri, përmirësojnë cilësinë e jetës për një numër njerëzish dhe përmirësojnë eficiencën e shërbimeve sociale. Me qëllim që të lehtësohet kërkimi shkencor, të dhënat personale mund të përpunohen për qëllime të kërkimeve shkencore, duke iu nënshtuar kushteve dhe garancive të përshtatshme të parashikuara në të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar.

(158) Nëse të dhënat personale përpunohen për qëllime arkivimi, kjo Rregullore duhet të zbatohet edhe për këtë përpunim, duke pasur parasysh që kjo Rregullore nuk duhet të zbatohet për personat e vdekur. Autoritetet publike ose organet publike apo private që mbajnë regjistra në interes publik duhet të jenë shërbime që, në pajtim me të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar, duhet të kenë një detyrim ligjor për të përfutur, ruajtur, vlerësuar, kryer, përshkruar, komunikuar, nxitur, shpërndarë dhe dhënë akses tek regjistrat me vlerë të qëndrueshme për interesin e përgjithshëm publik. Shtetet Anëtare duhet të autorizohen të parashikojnë përpunime të mëtejshme të të dhënave personale për qëllime arkivimi, për shembull me qëllim dhënien e informacionit specifik në lidhje me sjelljen politike nën regjimet shtetërore totalitare të mëparshme, gjenocidin, kërkimet kundër njerëzimit, veçanërisht Holokaustin ose krimet e luftës.

(159) Nëse të dhënat personale përpunohen për qëllime kërkimore shkencore, kjo Rregullore po ashtu duhet të zbatohet në këtë përpunim. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, përpunimi i të dhënave personale për qëllimet e kërkimeve shkencore nuk duhet të interpretohet në një mënyrë të gjerë, duke përfshirë, për shembull, zhvillimin dhe demonstrimin teknologjik, kërkimin bazë, kërkimin e aplikuar dhe kërkimin e financuar privatisht. Përveç kësaj, duhet marrë parasysh objekti i Bashkimit sipas nenit 179(1) të TFEU-së për krijimin e një Zone Evropiane të Kërkimeve. Qëllimet e kërkimeve shkencore duhet të përfshijnë gjithashtu studimet e zhvilluara në interes publik në sferën e shëndetit publik. Për të përmbushur specifikat e përpunimit të të dhënave personale për qëllime kërkimore shkencore, duhet të zbatohen kushte specifike veçanërisht në lidhje me publikimin ose deklarimin ndryshe të të dhënave personale në kontekstin e qëllimeve të kërkimeve shkencore. Nëse rezultati i kërkimit shkencor veçanërisht në kontekstin e shëndetit përbën shkak për masa të tjera në interesin e subjektit të të dhënave, duhet të zbatohen rregullat e përgjithshme të kësaj Rregulloreje në lidhje me këto masa.

(160) Nëse të dhënat personale përpunohen për qëllime të kërkimit historik, kjo Rregullore duhet të zbatohet edhe për këtë përpunim. Kjo duhet të marrë parasysh gjithashtu kërkimin shkencor dhe kërkimet për qëllime gjenealogjike, duke pasur parasysh që kjo Rregullore nuk duhet të zbatohet për personat e vdekur.

(161) Për qëllimin e dhënies së pëlqimit për pjesëmarrje në aktivitetet e kërkimeve shkencore në

kërkimet klinike, duhet të zbatohen dispozitat përkatëse të Rregullores 536/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit(1).

(162) Nëse të dhënat personale përpunohen për qëllime statistikore, për këtë përpunim duhet të zbatohet kjo Rregullore. E drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar, brenda kufijve të kësaj Rregulloreje, duhet të përcaktojë përmbajtjen statistikore, kontrollin e aksesit, specifikimet për përpunimin e të dhënave personale për qëllime statistikore dhe masat e përshtatshme për të garantuar të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave për të siguruar konfidencialitetin statistikor. Qëllime statistikore janë operacionet për mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e të dhënave personale të nevojshme për sondazhet statistikore ose për prodhimin e rezultateve statistikore. Këto rezultate statistikore mund të përdoren më tej për qëllime të ndryshme, duke përfshirë një qëllim kërkimor shkencor. Qëllimi statistikor nënkupton që rezultati i përpunimit të të dhënave statistikore nuk janë të dhënat personale por tërësia e të dhënave dhe që ky rezultat ose të dhënat personale nuk përdoren në mbështetje të masave ose vendimeve në lidhje me një person të caktuar fizik.

(163) Informacioni konfidencial që Bashkimi dhe autoritetet statistikore të brendshme mbledhin për prodhimin e statistikave zyrtare evropiane dhe zyrtare të brendshme duhet të mbrohen. Statistikat evropiane duhet të zhvillohen, prodhohen dhe shpërndarë në pajtim me parimet statistikore sipas parashikimit në Nenin 338(2) të TFEU-së, ndërsa statistikat e brendshme duhet gjithashtu të respektojnë të drejtën e Shtetit Anëtar. Rregullorja (KE) Nr 223/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (1) parashikon specifikime të mëtejshme për konfidencialitetin statistikor për statistikatat evropiane.

(164) Në lidhje me kompetencat e autoriteteve mbikëqyrëse për të përfutur nga kontrolluesi ose përpunuesi akses tek të dhënat personale dhe akses tek mjediset e tyre, Shtetet Anëtare mund të miratojnë me ligj, brenda kufijve të kësaj Rregulloreje, rregulla specifike për të garantuar detyrimet profesionale ose të tjera të barasvlershme për fshehtësinë, në masën që është e nevojshme për të përshtatur të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale me një detyrim për fshehtësinë profesionale. Kjo nuk cenon detyrimet ekzistuese të Shtetit Anëtar për të miratuar rregulla mbi fshehtësinë profesionale nëse kërkohet nga e drejta e Bashkimit.

(165) Kjo Rregullore respekton dhe nuk cenon statusin sipas së drejtës ekzistuese të kishave dhe shoqatave ose komuniteteve fetare në Shtetet Anëtare, siç njihen nga Neni 17 i TFEU-së.

(166) Për të përmbushur objektivat e kësaj Rregulloreje, që është për mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë dhe veçanërisht të drejtën e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale dhe për të siguruar lëvizjen e lirë të të dhënave personale brenda Bashkimit, kompetenca për të miratuar akte në pajtim me nenin 290 të TFEU-së duhet ti delegohet Komisionit. Veçanërisht, aktet e deleguara duhet të miratohen në lidhje me kriteret dhe kërkesat për mekanizmat e certifikimit, informacionin që duhet të prezantohet nga ikonat dhe procedurat e standardizuara për dhënien e këtyre ikonave. Është e një rëndësie tepër të madhe që Komisioni të kryejë konsultime të përshtatshme gjatë punës paraprake, duke përfshirë nivelin e ekspertëve. Komisioni, gjatë përgatitjes dhe përpilimit të akteve të deleguara, duhet të garantojë një transmetim njëherazi, në kohën e duhur dhe të përshtatshëm të dokumenteve përkatës tek Parlamenti Evropian dhe Këshilli.

(167) Për të garantuar kushte të unifikuara për zbatimin e kësaj Rregulloreje, kompetencat e

zbatimit duhet ti jepen Komisionit nëse parashikohet në këtë Rregullore. Këto kompetenca duhet të ushtrohen në pajtim me Rregulloren (BE) Nr 182/2011. Në këtë kontekst, Komisioni duhet të konsiderojë masa specifike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

(168) Procedura e shqyrtimit duhet të përdoret për miratimin e akteve zbatuese mbi klauzolat kontraktuale standarde ndërmjet kontrolluesve dhe përpunuesve dhe ndërmjet përpunuesve; kodet e sjelljes; standardet teknike dhe mekanizmat për certifikimin; nivelin e përshtatshëm për mbrojtje të ofruar nga një vend i tretë, një territor ose një sektor i specifikuar brenda atij vendi të tretë, ose një organizate ndërkombëtare; klauzolat standarde të mbrojtjes; formatet dhe procedurat për shkëmbimin e informacionit me mjete elektronike ndërmjet kontrolluesve, përpunuesve dhe autoriteteve mbikëqyrëse për rregullat detyruese të brendshme; ndihmën e ndërsjellë; dhe masat për shkëmbimin e informacionit me mjete elektronike ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe Bordit.

(169) Komisioni duhet të miratojë menjëherë akte të përshtatshme zbatimi nëse provat e disponueshme tregojnë që një vend i tretë, një territor ose një sektor i caktuar brenda atij vendi të tretë ose një organizatë ndërkombëtare nuk garanton një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes dhe këtë e kërkojnë shkaqe të domosdoshme të urgjencës.

(170) Meqenëse objektivi kësaj Rregulloreje, që është garantimi i një niveli të përshtatshëm mbrojtjeje për personat fizikë dhe fluksin e lirë të të dhënave personale në të gjithë Bashkimin, nuk mund të arrihet në masën e mjaftueshme nga Shtetet Anëtare dhe, nga ana tjetër, për shkak të shkallës ose efekteve të veprimit, mund të arrihet më mirë në nivelin e Bashkimit, Bashkimi mund të miratojë masat në pajtim me parimin e subsidiaritetit sipas parashikimit në Nenin 5 të Traktatit për Bashkimin Evropian (TEU). Në pajtim me parimin e proporcionalitetit sipas parashikimit në këtë Nen, kjo Rregullore nuk shkon tej asaj që është e nevojshme me qëllim që të arrihet ky objektivi.

(171) Direktiva 95/46/KE duhet të shfuqizohet nga kjo Rregullore. Përpunimi i filluar para datës së zbatimit të kësaj Rregulloreje duhet të silltet në pajtim me këtë Rregullore brenda periudhës së dy viteve pasi kjo Rregullore të ketë hyrë në fuqi. Nëse përpunimi bazohet në pëlqim në pajtim me Direktivën 95/46/KE, nuk është e nevojshme për subjektin e të dhënave të japë pëlqimin e tij përsëri nëse mënyra në të cilën pëlqimi është dhënë është në pajtim me kushtet e kësaj Rregulloreje, për të lejuar kontrolluesin të vazhdojë këtë përpunim pas datës së zbatimit të kësaj Rregulloreje. Vendimet e Komisionit të miratuara dhe autorizimet nga autoritetet mbikëqyrëse të bazuara në Direktivën 95/46/KE mbeten në fuqi derisa të ndryshohen, zëvendësohen ose shfuqizohen.

(172) Mbikëqyrësi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave u konsultua në pajtim me Nenin 28(2) të Rregullores (KE) Nr 45/2001 dhe dha një opinion më 7 mars 2012 (1).

(173) Kjo Rregullore duhet të zbatohet për të gjitha çështjet në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kundrejt përpunimit të të dhënave personale që nuk i nënshtrohen detyrimeve specifike me të njëjtin objektivi të caktuar në Direktivën 2002/58/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (2), duke përfshirë detyrimet mbi kontrolluesin dhe të drejtat e personave fizikë. Me qëllim që të sqarohet raporti ndërmjet kësaj Rregulloreje dhe Direktivës 202/58/KE, kjo Direktivë duhet të ndryshohet përkatësisht. Pas miratimit të kësaj Rregulloreje, Direktiva 202/58/KE duhet të rishikohet veçanërisht me qëllim që të garantohet përputhshmëria me këtë Rregullore.

KAPITULLI I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Objekti dhe objektivat

1. Kjo Rregullore përcakton rregullat në lidhje me mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe rregulla në lidhje me lëvizjen e lirë të të dhënave personale.
2. Kjo Rregullore mbron të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë dhe veçanërisht të drejtën e tyre për të mbrojtur të dhënat personale.
3. Lëvizja e lirë e të dhënave personale brenda Bashkimit nuk kufizohet ose ndalohet për shkaqe që kanë të bëjnë me mbrojtjen e personave fizikë për sa i takon përpunimit të të dhënave personale.

Neni 2

Fusha e zbatimit lëndor

1. Kjo Rregullore zbatohet për përpunimin e të dhënave personale plotësisht ose pjesërisht me mjete automatike dhe për përpunimin e ndryshëm nga me mjete automatike të të dhënave personale që janë pjesë e sistemit të skedimit ose që destinohen të jenë pjesë e sistemit të skedimit.
2. Kjo Rregullore nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave personale:
 - (a) në vazhden e aktivitetit që del jashtë fushës së zbatimit të së drejtës së Bashkimit;
 - (b) nga Shtetet Anëtare gjatë kryerjes së aktiviteteve që përfshihen në sferën e Kapitullit 2 të Titullit V të TEU-së;
 - (c) nga një person fizik në vazhden e një aktiviteti thjesht personal ose familjar;
 - (d) nga autoritetet kompetente për qëllimet e parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë garancitë ndaj dhe parandalimin e kërcënimeve për sigurinë publike.
3. Për përpunimin e të dhënave personale nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit, zbatohet Rregullorja (KE) Nr 45/2001. Rregullorja (EC) Nr 45/2001 dhe aktet e tjera ligjore të Bashkimit të zbatueshme për këtë përpunim të të dhënave personale duhet të përshtatet me parimet dhe rregullat e përcaktuara në këtë Rregullore në pajtim me Nenin 98.
4. Kjo Rregullore nuk cenon zbatimin e Direktivës 2000/31/EC, veçanërisht në lidhje me rregullat për përgjegjësinë e ofruesve të shërbimit si ndërmjetës në Nenin 12 deri 15 të kësaj Direktive.

Fusha e zbatimit territorial

1. Kjo Rregullore zbatohet për përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e aktiviteteve të një strukture të një kontrolluesi ose përpunuesi në Bashkim, pavarësisht nëse përpunimi kryhet brenda Bashkimit.
2. Kjo Rregullore zbatohet për përpunimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave që janë në Bashkim nga një kontrollues ose përpunues që nuk është i vendosur në Bashkim, nëse aktivitetet përpunuese kanë të bëjnë me:
 - (a) ofrimin e mallrave ose shërbimeve, pavarësisht nëse kërkohet një pagesë nga subjekti i të dhënave, për këto subjekte të dhënash në Bashkim, ose
 - (b) Monitorimin e sjelljes së tyre, në masën që sjellja e tyre kryhet brenda Bashkimit.
3. Kjo Rregullore zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nga një kontrollues që nuk është i vendosur në Bashkim por në një vend ku e drejta e Shtetit Anëtar zbatohet në saj të së drejtës ndërkombëtare publike.

Neni 4

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje:

- (1) ‘të dhëna personale’ është çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (‘subjekt i të dhënave’); një person fizik i identifikueshëm është ai i cili mund të identifikohet, drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi si një emër, një numër identifikimi, të dhëna për vendndodhjen, një identifikues *online*, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik;
- (2) ‘përpunim’ është çdo operacion ose komplet operacionesh që kryhen me të dhënat personale ose kompletet e të dhënave personale, me mjete automatike ose jo, si mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, deklarimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi;
- (3) ‘kufizimi i përpunimit’ është shënjimi i të dhënave personale të ruajtura me synim kufizimin e përpunimit të tyre në të ardhmen;
- (4) ‘profilizimi’ është çdo formë e përpunimit automatik të të dhënave personale që konsiston në përdorimin e të dhënave personale për të vlerësuar aspektet personale në lidhje me një person fizik veçanërisht për të analizuar ose parashikuar aspekte në lidhje me mbarëvajtjen e personit në punë, gjendjen ekonomike, shëndetin, preferencat personale, interesat, besueshmërinë, sjelljen, vendndodhjen ose lëvizjet e tij;
- (5) ‘anonimizim’ është përpunimi i të dhënave personale në një mënyrë të tillë që të dhënat personale të mos vazhdojnë ti vishen një subjekti të caktuar të të dhënave pa përdorimin e

informacionit shtesë, me kusht që ky informacion shtesë të mbahet veçmas dhe tu nënshtrohet masave teknike dhe organizative për të garantuar që të dhënat personale të mos i vishen një personi fizik të identifikuar ose të identifikueshëm;

(6) ‘sistem skedimi’ është një komplet i strukturuar të dhënash personale që janë të aksesueshme në pajtim me kriteret specifike, të centralizuara, decentralizuara ose të shpërndara mbi bazë funksionale ose gjeografike;

(7) ‘kontrollues’ është personi fizik ose juridik, autoriteti publik, agjencia ose një organ tjetër, që vetëm ose së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mjetet e përpunimit të të dhënave personale; nëse qëllimet dhe mjetet e këtij përpunimi përcaktohen nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar, kontrolluesi ose kriteret specifike për emërtimin e tij mund të parashikohen nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar;

(8) ‘përpunues’ është një person fizik ose juridik, autoritet publike, agjenci ose organ tjetër që përpunon të dhëna personale në emër të kontrolluesit;

(9) ‘marrës’ është një person fizik ose juridik autoritet publik, agjenci ose organ tjetër, të cilit i deklarohen të dhënat personale, qoftë palë e tretë ose jo. Megjithatë, autoritetet publike që mund të marrin të dhëna personale në kuadrin e një hetimi të veçantë në pajtim me të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar nuk konsiderohen si marrës; përpunimi i këtyre të dhënave nga autoritetet publike janë në pajtim me rregullat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave sipas qëllimeve të përpunimit;

(10) ‘palë e tretë’ është një person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose organ i ndryshëm nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi, përpunuesi dhe personat që, sipas autoriteteve të drejtpërdrejta të kontrolluesit ose përpunuesit, janë autorizuar për të përpunuar të dhëna personale;

(11) ‘pëlqim’ i subjektit të të dhënave është një tregues i dhënë lirisht, specifik, i informuar dhe i qartë i dëshirave të subjektit të të dhënave nëpërmjet të cilit ai ose ajo, me një deklarament ose me një veprim të qartë pohues, shpreh pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të;

(12) ‘shkelje e të dhënave personale’ është një shkelje e sigurisë që sjell asgjësimin, humbjen, ndryshimin, deklarimin e paautorizuar, aksidental ose të paligjshëm, ose aksesin tek të dhënat personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara ndryshe;

(13) ‘të dhëna gjenetike’ janë të dhënat personale në lidhje me karakteristikat gjenetike të trashëguara ose të përfutuara të një personi fizik që jep informacion unik në lidhje me fiziologjinë ose shëndetin e atij personi fizik dhe që rezulton, veçanërisht, nga një analizë e një kampioni biologjik nga personi fizik në fjalë;

(14) ‘të dhëna biometrike’ janë të dhënat personale që rezultojnë nga përpunimi specifik teknik në lidhje me karakteristikat fizike, fiziologjike ose të sjelljes së një personi fizik që lejon ose konfirmon identifikimin unik të atij personi fizik, si imazhet pamore ose të dhënat daktiloskopike;

(15) ‘të dhënat në lidhje me shëndetin’ janë të dhënat personale në lidhje me shëndetin fizik ose mendor të një personi fizik, duke përfshirë dhënien e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, që tregojnë informacion në lidhje me gjendjen e tij ose të saj shëndetësore;

(16) ‘Struktura kryesore’ është:

(a) në lidhje me një kontrollues me struktura në më shumë se një Shtet Anëtar, vendi i administratës së tij qendrore në Bashkim, përveç kur vendimet për qëllimet dhe mjetet e përpunimit të të dhënave personale merren nga një strukturë tjetër i kontrolluesit në Bashkim dhe struktura e fundit ka kompetencën që ti zbatohen vendimet dhe në këtë rast struktura që ka marrë vendime të tilla duhet të konsiderohet struktura kryesore;

(b) në lidhje me një përpunues me struktura në më shumë se një Shtet Anëtar, vendi i administrimit të tij qendror në Bashkim ose, nëse përpunuesi nuk ka administrim qendror në

Bashkim, struktura e përpunuesit në Bashkim nëse aktivitetet kryesore përpunuese në kontekstin e aktiviteteve të një strukture të përpunuesit zhvillohen në masën që përpunuesi u nënshtrohet detyrimeve specifike sipas kësaj Rregulloreje;

(17) ‘përfaqësues’ është një person fizik ose juridike i vendosur në Bashkim, i cili, i caktuar nga kontrolluesi ose përpunuesi me shkrim në pajtim me Nenin 27, përfaqëson kontrolluesin ose përpunuesin në lidhje me detyrimet e tyre përkatëse sipas kësaj Rregulloreje;

(18) ‘ndërmarrje’ është një person fizik ose juridik i angazhuar në një aktivitet ekonomik, pavarësisht nga forma e tij ligjore, duke përfshirë partneritetet ose shoqatat që angazhohen rregullisht në një aktivitet ekonomik;

(19) ‘grup ndërmarrjesh’ është një ndërmarrje kontrolli dhe ndërmarrjet e kontrolluara prej saj;

(20) ‘rregulla të brendshme detyruese’ janë politikat për mbrojtjen e të dhënave personale që respektohen nga një kontrollues ose përpunues i vendosur në territorin e një Shteti Anëtar për transferimet ose një komplet transferimesh të të dhënave personale tek një kontrollues ose përpunues në një ose më shumë vende të tretë brenda një grupi ndërmarrjesh, ose një grupi ndërmarrjesh të angazhuara në një aktivitet të përbashkët ekonomik;

(21) ‘autoritet mbikëqyrës’ është një autoritet publik i pavarur që është i vendosur nga një Shtet Anëtar në pajtim me Nenin 51;

(22) ‘autoritet mbikëqyrës i interesuar’ është një autoritet mbikëqyrës që është i interesuar në përpunimin e të dhënave personale, sepse:

(a) kontrolluesi ose përpunuesi është vendosur në territorin e Shtetit Anëtar të atij autoriteti mbikëqyrës;

(b) subjektet e të dhënave me banim në Shtetin Anëtar të atij autoriteti mbikëqyrësi janë thelbësisht të ndikuar ose mund të ndikohen thelbësisht nga përpunimi, ose

(c) është bërë një ankim tek ai autoritet mbikëqyrës;

(23) ‘përpunim ndër-kufitar’ është:

(a) përpunim i të dhënave personale që kryhet në kontekstin e aktiviteteve të strukturave në më shumë se një Shtet Anëtar i kontrolluesit ose përpunuesit në Bashkim, nëse kontrolluesi ose përpunuesi është i vendosur në më shumë se një Shtet Anëtar; ose

(b) Përpunimi i të dhënave personale që kryhet në kontekstin e aktiviteteve të një strukture të vetme të një kontrolluesi ose përpunuesi në Bashkim, por që ndikon thelbësisht ose mund të ndikojë thelbësisht të subjektet e të dhënave në më shumë se një Shtet Anëtar.

(24) ‘kundërshtim përkatës dhe i arsyetuar’ është një kundërshtim për një projekt-vendim në lidhje me faktin nëse ka një shkelje të kësaj Rregulloreje, ose nëse veprimi i parashikuar në lidhje me kontrolluesin ose përpunuesin është në përputhje me këtë Rregullore, që demonstroi qartazi rëndësinë e risqeve që rrjedhin nga projekt-vendimi në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të të dhënave dhe, sipas rastit, fluksin e lirë të të dhënave personale brenda Bashkimit;

(25) ‘shërbim i shoqërisë së informacionit’ është një shërbim i sipas përcaktimit të Nenit 1(1) të Direktivës (BE) 2015/1535 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (1);

(26) ‘Organizatë ndërkombëtare’ është një organizatë dhe organet e veta vartëse të rregulluara nga drejta ndërkombëtare publike ose një organ tjetër që është i ngritur nga ose në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë vendeve.

KAPITULLI II

Parimet

Parimet në lidhje me përpunimin e të dhënave personale

1. Të dhënat personale:

(a) përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente në lidhje me subjektin e të dhënave ('ligjshmëria, drejtësia dhe transparencja');

(b) Mblidhen për qëllime të specifikuar, të qarta dhe legjitime dhe nuk përpunohen më tej në një mënyrë që nuk është në përputhje me ato qëllime; përpunimi i mëtejshëm për interesin publik, qëllime të kërkimeve shkencore ose historike, në pajtim me Nenin 89(1), nuk konsiderohen të jenë në mospërputhje me qëllimet fillestare ('kufizimi i qëllimit');

(c) të jenë të përshtatshme, të rëndësishme dhe të kufizuara në lidhje me qëllimet për të cilën ato përpunohen (minimizimi i të dhënave');

(d) të jenë të sakta dhe, sipas rastit, të mbahen të përditësuara; duhet të merret çdo hap i arsyeshëm për të garantuar që të dhënat personale që janë të pasakta, duke pasur parasysh qëllimet për të cilat janë përpunuar të fshihen ose të korrigjohen pa vonesë ('saktësia');

(e) të mbahen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave jo më gjatë se sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale; të dhënat personale mund të ruhen për afate me të gjata për sa kohë të dhënat personale përpunohen vetëm për qëllime arkivimi në interes publik, qëllime të kërkimit shkencor ose historik ose qëllime statistikore në pajtim me Nenin 89(1) në pajtim me zbatimin e masave të përshtatshme teknike dhe organizative që kërkohen nga kjo Rregullore me qëllim që të garantohen të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave ('kufizimi i ruajtjes');

(f) të përpunohen në një mënyrë që garanton siguri të përshtatshme të të dhënave personale, duke përfshirë mbrojtjen ndaj përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe ndaj humbjes, asgjësimit ose dëmtimit aksidental, duke përdorur masat e përshtatshme teknike dhe organizative ('integriteti dhe konfidencialiteti').

2. Kontrolluesi është përgjegjës dhe në gjendje të demonstrojë përputhshmërinë me paragrafin 1 ('përgjegjshmëria').

Neni 6

Ligjshmëria e përpunimit

1. Përpunimi është i ligjshëm vetëm nëse dhe në masën që zbatohet të paktën një nga sa më poshtë:

(a) Subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij ose të saj personale për një ose më shumë qëllime specifike;

(b) Përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një kontrate ku subjekti i të dhënave është palë ose me qëllim që të ndërmerren hapat me kërkesën e subjektit të të dhënave për të lidhur një kontratë;

(c) Përpunimi është i nevojshëm për përputhshmërinë me një detyrim ligjor të cilit i nënshtrohet kontrolluesi;

(d) përpunimi është i nevojshëm me qëllim që të mbrohen interesat jetike të subjektit të të dhënave ose personave të tjerë fizikë;

(e) përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një detyre të kryer në interes publik ose në ushtrim të autoritetit zyrtar të veshur kontrolluesit;

(f) përpunimi është i nevojshëm për qëllimet e interesave legjitime të ndjekura nga kontrolluesi ose një palë e tretë, përveç kur këta interesa tejkalohen nga interesat ose të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave që kërkon mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht nëse subjekti i të dhënave është fëmijë.

Pika (f) i nën-paragrafit të parë nuk zbatohet për përpunimin e kryer nga autoritetet publike në përmbushje të detyrave të tyre.

2. Shtetet Anëtare mund të mbajnë ose prezantojnë dispozita më specifike për të përshtatur zbatimin e rregullave të kësaj Rregulloreje në lidhje me përpunimin për përputhshmërinë me pikat (c) dhe (E) të paragrafit 1 nëpërmjet caktimit të kërkesave më specifike për përpunimin dhe masa të tjera për të garantuar përpunimin e ligjshëm dhe të drejtë duke përfshirë për situata të tjera specifike përpunuese sipas parashikimit në Kapitullin IX.

3. Baza për përpunimin e referuar në pikën (c) dhe (e) të paragrafit 1 përcaktohet nga:

(a) e drejta e Bashkimit; ose

(b) e drejta e Shtetit Anëtar të cilës i nënshtrohet kontrolluesi.

Qëllimi i përpunimit përcaktohet në të bazë ligjore ose, në lidhje me përpunimin e referuar në pikën (e) të paragrafit 1, është i nevojshëm për përmbushjen e një detyre që kryhet në interesin publik ose në ushtrim të autoritetit zyrtar të veshur kontrolluesit. Baza ligjore mund të përmbajë dispozita specifike për të përshtatur aplikimin e rregullave të kësaj Rregulloreje, ndër të tjera: kushtet e përgjithshme që rregullojnë ligjshmërinë e përpunimit nga kontrolluesi; tipat e të dhënave që i nënshtrohet përpunimit; subjektet e të dhënave të interesuar; subjektet të cilave ose qëllimet për të cilat mund të deklarohen të dhënat personale; kufizimi i qëllimit; afatet e ruajtjes; dhe operacionet e përpunimit dhe procedurat e përpunimit, duke përfshirë masat për të siguruar një përpunim të ligjshëm dhe të drejtë në lidhje me ato për situata të tjera specifike sipas parashikimit në Nenin IX. E drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar përmbush një objektiv të interesit publik dhe është proporcional me qëllimin legjitim të ndjekur.

4. Nëse përpunimi për një qëllim tjetër nga ai për të cilin janë mbledhur të dhëna personale nuk bazohet në pëlqimin e subjektit të të dhënave ose në të drejtën e Bashkimit ose të Shtetit Anëtar që përbën një masë të nevojshme dhe proporcional në një shoqëri demokratike për të garantuar objektivat e përmendura në Nenin 23(1), kontrolluesi, me qëllim që të konstatohet nëse përpunimi për një qëllim tjetër është në pajtim me qëllimin për të cilin janë mbledhur fillimisht të dhënat personale, ndërmjet të tjerash, merr parasysh:

(a) çdo lidhje ndërmjet qëllimeve për të cilat janë mbledhur të dhënat personale dhe qëllimet e përpunimit të mëtejshëm të synuar;

(b) kontekstin në të cilin janë mbledhur të dhënat personale, veçanërisht në lidhje me raportin ndërmjet subjekteve të dhënave dhe kontrolluesit;

(c) natyrën e të dhënave personale, veçanërisht nëse përpunohen kategoritë e veçanta të t dhënave personale, në pajtim me Nenin 9, ose nëse përpunohen të dhënat personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale, në pajtim me Nenin 10;

(d) pasojat e mundshme të përpunimit të synuar të mëtejshëm për subjektet e të dhënave;

(e) ekzistencën e garancive të përshtatshme, që mund të përfshijnë enkriptimin ose anonimizimin.

Kushtet për pëlqimin

1. Nëse përpunimi bazohet në pëlqim, kontrolluesi duhet të jenë në gjendje të demonstrojë që subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij ose të saj personale.
2. Nëse pëlqimi i subjektit të të dhënave jepet në kontekstin e një deklarimi me shkrim që ka të bëjë edhe me çështje të tjera, kërkesa për pëlqim duhet të paraqitet në një mënyrë që është qartësisht e dallueshme nga çështjet e tjera, në një formë të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme, duke përdorur gjuhë të qartë dhe të thjeshtë. Çdo pjesë e një deklarimi të tillë që përbën një shkelje të kësaj Rregulloreje nuk është detyruese.
3. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të tërheqë pëlqimin e tij ose të saj në çdo kohë. Tërheqja e pëlqimit nuk ndikon në ligjshmërinë e përpunimit bazuar në pëlqim para tërheqjes. Para dhënies së pëlqimit, subjekti i të dhënave vihet për këtë në dijeni. Tërheqja duhet të jetë aq e lehtë sa edhe dhënia e pëlqimit.
4. Gjatë vlerësimit nëse pëlqimi është i dhënë lirisht, duhet të merret veçanërisht parasysh nëse, ndërmjet të tjerash, përmbushja e një kontrate, duke përfshirë dhënien e një shërbimi, kushtëzohet me pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale që nuk është i nevojshëm për përmbushjen e asaj kontrate.

Neni 8

Kushtet që zbatohen për pëlqimin e fëmijës në lidhje me shërbimet e shoqërisë së informacionit

1. Nëse pika (a) e Nenit 6(1), në lidhje me ofertën e shërbimeve të shoqërisë së informacionit drejtpërdrejtë me një fëmijë, përpunimi i të dhënave personale të një fëmije është e ligjshme nëse fëmija është të paktën 16 vjeç. Nëse fëmija është nën 16 vjeç, ky përpunim është i ligjshëm vetëm nëse dhe në masën që ai pëlqen jepet ose autorizohet nga zotëruesi i përgjegjësishë prindërore për atë fëmijë. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë me ligj një moshë më të ulët për këto qëllime, me kusht që kjo moshë më e vogël të mos jetë poshtë 1 vjeç.
2. Kontrolluesi bën përpjekje të arsyeshme për të verifikuar në këto raste që pëlqimi jepet ose autorizohet nga zotëruesi i përgjegjësishë prindërore për fëmijën, duke marrë parasysh teknologjinë e disponueshme.
3. Paragrafi 1 nuk ndikon të drejtën e përgjithshme të kontratave të Shteteve Anëtare, si rregullat për vlefshmërinë, lindjen ose efektin e një kontrate në lidhje me një fëmijë.

Neni 9

Përpunimi i kategorive të veçanta të të dhënave personale

1. Përpunimi i të dhënave personale që tregon origjinën racore ose etnike, bindjet politike, bindjet fetare ose filozofike, anëtarësinë në bashkimet profesionale dhe përpunimi i të dhënave gjenetike, të dhënave biometrike për qëllimet e identifikimit të një personi fizik në mënyrë unike, të dhënat në lidhje me shëndetin ose të dhënat në lidhje me jetën seksuale ose orientin seksual të një

personi fizik është i ndaluar.

2. Paragrafi 1 nuk zbatohet nëse zbatohet një nga sa më poshtë:

(a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e qartë për përpunimin e atyre të dhënave personale për një ose disa qëllime më specifike, përveç kur e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar parashikojnë që ndalimi i parashikuar në paragrafin 1 nuk mund të anulohet nga subjekti i të dhënave;

(b) përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve dhe ushtrimin e të drejtave specifike të kontrolluesit ose të subjektit të të dhënave në sferën e së drejtës së punësimit, sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale, në masën që është i autorizuar nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar ose një marrëveshje kolektive sipas së drejtës së Bashkimit Evropian për garanci të përshtatshme për të drejtat themelore dhe interesat e subjektit të të dhënave;

(c) përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër fizik, nëse subjekti i të dhënave nuk është fizikisht ose ligjërisht në gjendje të japë pëlqimin;

(d) përpunimi kryhet në vazhden e aktiviteteve të tij të ligjshme me garanci të përshtatshme nga një fondacion, shoqatë ose një organ tjetër jo-fitimprurës me një qëllim politik, filozofik, fetar ose të bashkimeve profesionale dhe me kusht që përpunimi të ketë të bëjë vetëm me anëtarët ose ish-anëtarët e organit ose personat që kanë kontakt të rregullt me të në lidhje me qëllimet e saj dhe që të dhënat personale nuk deklarohen jashtë atij organi pa pëlqimin e subjekteve të të dhënave;

(e) përpunimi ka të bëjë me të dhënat personale që duket se bëhen publike nga subjektet e të dhënave;

(f) përpunimi është i nevojshëm për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore ose kurdoherë që gjykatat veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore;

(g) përpunimi është i nevojshëm në interesin thelbësor publik mbi bazën e së drejtës së Bashkimit ose Shtetit Anëtar që është proporcional me qëllimin e ndjekur, respektimit të thelbit të së drejtës së mbrojtjes së të dhënave dhe parashikojnë masa të përshtatshme dhe specifike për garantimin e të drejtave themelore dhe interesave të subjektit të të dhënave;

(h) përpunimi është i nevojshëm për qëllimet e mjekësisë parandaluese ose të punës, për vlerësimin e kapacitetit të punës së punonjësit, diagnozës mjekësore, dhënien e kujdesit shëndetësor social, trajtimin, menaxhimin e sistemeve të kujdesit shëndetësor ose social dhe shërbimet mbi bazën e së drejtës së Bashkimit ose Shtetit Anëtar ose në pajtim me kontratat me një profesionist shëndeti dhe në pajtim me kushtet dhe garancitë e referuara në paragrafin 3;

(i) përpunimi është i nevojshëm për shkaqe të interesit publik në sferën e shëndetit publik si mbrojtja ndaj kërcënimeve të rënda ndër-kufitare për shëndetin ose garantimin e standardeve të larta të cilësisë dhe sigurisë të kujdesit shëndetësor dhe të produkteve mjekësore ose pajisjeve mjekësore, mbi bazën e së drejtës së Bashkimit ose të Shtetit Anëtar që parashikon masa të përshtatshme dhe specifike për të garantuar të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave, veçanërisht fshehtësinë profesionale;

(j) përpunimi është i nevojshëm për qëllimet e arkivimit në interes publik, qëllime të kërkimeve shkencore ose historike ose qëllime statistikore në pajtim me Nenin 89(1) bazuar në të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar që do të jetë proporcional me qëllimin e ndjekur, respektimin e thelbit të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave dhe parashikon masa të përshtatshme dhe specifike për të garantuar të drejtat themelore dhe interesat e subjektit të të dhënave.

3. Të dhënat personale të përmendura në paragrafin 1 mund të përpunohen për qëllimet e

përmendura në pikën (h) të paragrafit 2 nëse këto të dhëna përpunohen nga ose nën përgjegjësinë e një profesionisti në pajtim me detyrimet e fshehtësisë profesionale sipas së drejtës së Bashkimit ose të Shtetit Anëtar ose rregullave të vendosura nga organet kompetente të brendshme ose nga një person tjetër që gjithashtu i nënshtrohet detyrimit të fshehtësisë sipas së drejtës së Bashkimit ose të Shtetit Anëtar ose rregullave të vendosura nga organet kompetente të brendshme.

4. Shtetet Anëtare mund të mbajnë dhe prezantojnë kushte të tjera, duke përfshirë kufizimet, në lidhje me përpunimin e të dhënave gjenetike, të dhënave biometrike ose të dhënave në lidhje me shëndetin.

Neni 10

Përpunimi i të dhënave personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale

Përpunimi i të dhënave personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale ose masat përkatëse të sigurisë bazuar në Nenin 6(1) kryhet vetëm nën kontrollin e autoritetit zyrtar ose nëse përpunimi është i autorizuar nga e drejta e Bashkimit ose Shtetit Anëtar që parashikon garanci të përshtatshme për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave. Çdo regjistër i plotë i dënimeve penale mbahet vetëm nën kontrollin e një autoriteti zyrtar.

Neni 11

Përpunimi që nuk kërkon identifikim

1. Nëse qëllimet për të cilat një kontrollues përpunon të dhëna personale nuk kërkon ose nuk vazhdon të kërkojë identifikimin e një subjekti të dhënash nga kontrolluesi, kontrolluesi nuk është i detyruar të mbajë, përftojë ose përpunojë informacion shtesë për të identifikuar subjektin e të dhënave për qëllimin e vetëm të respektimit të kësaj Rregulloreje.

2. Nëse, në rastet e përmendura në paragrafin 1 të këtij Neni, kontrolluesi është në gjendje të demonstrojë që ai nuk është në gjendje të identifikojë subjektin e të dhënave, kontrolluesi informon përkatësisht subjektin e të dhënave, sipas rastit. Në këto raste, Nenet 15 deri 20 nuk zbatohen përveç kur subjekti i të dhënave, për qëllimet e ushtrimit të të drejtave të tij ose të saj sipas këtyre Neneve, jep informacion shtesë duke mundësuar identifikimin e tij ose të saj.

KAPITULLI III

Të drejtat e subjektit të të dhënave

Seksioni 1

Transparenca dhe modalitetet

Neni 12

Informimi transparent, komunikimi dhe modalitetet për ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave

1. Kontrolluesi merr masat e përshtatshme për të dhënë çdo informacion të referuar në Nenet 13 dh 14 dhe çdo komunikim sipas Neneve 15 deri 22 dhe 34 në lidhje me përpunimin e të dhënave personale që i nënshtrohen një formati konciz, transparent, të kuptueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm, duke përdorur gjuhë të qartë dhe të pastër, veçanërisht për çdo informacion drejtuar specifikisht një fëmije. Informacioni jepet me shkrim ose me mjete të tjera, duke përfshirë, sipas rastit, me mjete elektronike. Nëse kërkohet nga subjekti i të dhënave, informacioni mund të jepet me gojë, me kusht që identiteti i subjektit të të dhënave të provohet me mjete të tjera.

2. Kontrolluesi lehtëson ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave sipas Neneve 15 deri 22. Në rastet e përmendura në Nenin 11(2), kontrolluesi nuk refuzon të veprojë me kërkesën e subjektit të të dhënave për ushtrimin e të drejtave të tij ose të saj sipas Neneve 15 deri 22, përveç kur kontrolluesi demonstroi që nuk është në gjendje të identifikojë subjektin e të dhënave.

3. Kontrolluesi jep informacion mbi veprimet e ndërmarra me kërkesë sipas Neneve 15 deri 22 për subjektin e të dhënave pa vonesë të panevojshme dhe në çdo rast brenda një muaji nga marrja e kërkesës. Ky afat mund të zgjatet me dy muaj të tjerë nëse është e nevojshme, duke marrë parasysh kompleksitetin dhe numrin e kërkesave. Kontrolluesi njofton subjektin e të dhënave për çdo zgjatje të tillë brenda një muaji nga marrja e kërkesës, së bashku me shkaqet e vonesës. Kur subjekti i të dhënave bën kërkesë me mjete në format elektronik informacioni jepet me mjete elektronike, sipas rastit, përveç kur kërkohet ndryshe nga subjekti i të dhënave.

4. Nëse kontrolluesi nuk vepron në lidhje me kërkesën për subjektin e të dhënave, kontrolluesi njofton subjektin e të dhënave pa vonesë dhe jo më vonë se një muaj nga marrja e kërkesës për shkaqet për mosveprimin dhe mbi mundësinë e paraqitjes së kërkesës tek autoriteti mbikëqyrës dhe paraqitjen e një mjeti gjyqësor mbrojtës.

5. Informacioni i dhënë sipas Neneve 13 dhe 14 dhe çdo komunikim dhe masë e ndërmarrë sipas Neneve 15 deri 22 dhe 34 jepet falas. Nëse kërkesat nga një subjekt të dhënash duket se janë të pabazuara ose të tepërta, veçanërisht për shkak të karakterit të tyre përsëritës, kontrolluesi mund të:

(a) caktojë një tarifë të arsyeshme duke marrë parasysh shpenzimet administrative të dhënies së informacionit ose komunikimit ose marrjen e masës së kërkuar; ose

(b) refuzojë të veprojë në lidhje me kërkesën.

Kontrolluesi ka barrën e demonstrimit të karakterit haptazi të pabazuar ose të tepërt të kërkesës.

6. Pa cenuar Nenin 11, nëse kontrolluesi ka dyshime të arsyeshme në lidhje me identitetin e personit fizik që bën kërkesën në lidhje me Nenet 15 deri 21, kontrolluesi mund të kërkojë dhënien e informacionit shtesë të nevojshëm për konfirmimin e identitetit të subjektit të të dhënave.

7. Informacioni, që duhet tu jepet subjekteve të të dhënave në pajtim me Nenet 13 dhe 14, mund të jepet i kombinuar me ikonat e standardizuara me qëllim që të ofrohet një vështrim i përgjithshëm i përpunimit të synuar në një mënyrë të dukshme, të kuptueshme dhe lehtësisht të lexueshme. Nëse ikonat ofrohen elektronikisht, ato duhet të jenë të lexueshme në mënyrë automatike.

8. Komisioni është i autorizuar të miratojë aktet e deleguara në pajtim me Nenin 92 për qëllimin e përcaktimit të informacionit për tu paraqitur nga ikonat dhe procedurat për dhënien e ikonave të standardizuara.

Informacioni që duhet të jepet nëse të dhënat personale mblidhen nga subjekti i të dhënave

1. Nëse të dhënat personale në lidhje me një subjekt të dhënash mblidhen nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi, në momentin kur përftohen të dhënat personale, i japin subjektit të të dhënave informacionin e mëposhtëm:

(a) hollësitë e identitetit dhe kontaktit të kontrolluesit dhe, sipas rastit, të përfaqësuesit të kontrolluesit;

(b) hollësitë e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave, sipas rastit;

(c) qëllimin e përpunimit për të cilin janë të destinuara të dhënat personale, si dhe bazën ligjore për përpunimin;

(d) nëse përpunimi bazohet në pikën (f) të Nenit 6(1), interesat legjitime të ndjekura nga kontrolluesi ose nga një palë e tretë;

(e) marrësit ose kategoritë e marrësve të të dhënave personale, sipas rastit;

(f) sipas rastit, faktin që kontrolluesi synon të transferojë të dhëna personale tek një vend i tretë ose organizatë ndërkombëtare dhe ekzistencën ose mungesën e një vendimi përshtatshmërie të Komisionit, ose në rastin e transferimeve të referuara në Nenin 46 ose 47, ose nën-paragrafin e dytë të Nenit 49(1), referenca tek garancitë e përshtatshme ose të përshtatshme dhe mjetet me të cilat merret një kopje e tyre ose ku ato janë ofruar.

2. Përveç informacionit të përmendur në paragrafin 1, kontrolluesi, në momentin kur përftohen të dhënat personale, i jep subjektit të të dhënave informacionin e mëposhtëm shtesë të nevojshëm për të garantuar një përpunim të drejtë dhe transparent:

(a) Afatin për të cilin ruhen të dhënat personale, ose nëse kjo nuk është e mundur, kriteret e përdorura për të përcaktuar këtë afat;

(b) ekzistencën e së drejtës për të kërkuar nga kontrolluesi akses dhe korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personal ose kufizimin e përpunimit në lidhje me subjektin e të dhënave ose për të kundërshtuar përpunimin, si dhe të drejtën për transferueshmërinë e të dhënave;

(c) nëse përpunimi bazohet në pikën (a) të Nenit 6(1) ose pikën (a) të Nenit 9(2), ekzistencën e së drejtës për të tërhequr pëlqimin në çdo kohë, pa ndikuar në ligjshmërinë e përpunimit bazuar në pëlqimin para tërheqjes së tij;

(d) të drejtën për të paraqitur një kërkesë tek autoriteti mbikëqyrës;

(e) nëse dhënia e të dhënave personale është një kërkesë ligjore ose kontraktuale, ose një kërkesë e nevojshme për të lidhur një kontratë, si dhe nëse subjekti i të dhënave është i detyruar të jap të dhëna personale dhe për pasojat e mundshme për mosdhënien e këtyre të dhënave;

(f) ekzistencën e vendimmarrjes së automatizuar, duke përfshirë profilizimin, të përmendur në nenin 22(1) dhe (4) dhe, të paktën në ato raste, informacionin e duhur në lidhje me logjikën përkatëse, si dhe rëndësinë dhe pasojat e parashikuara të këtij përpunimi për subjektin e të dhënave.

3. Nëse kontrolluesi synon të përpunojë më tej të dhëna personale për një qëllim të ndryshëm nga ai për të cilin të dhënat personale janë mbledhur, kontrolluesi, para këtij përpunimi të mëtejshëm, duhet ti japë subjektit të të dhënave informacion mbi qëllimin tjetër dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm, sipas referimit në paragrafin 2.

4. Paragrafët 1, 2 dhe 3 nuk zbatohen nëse dhe në masën që subjekti i të dhënave e ka

Neni 14

Informacioni që duhet të jepet nëse të dhënat personale nuk janë mbledhur nga subjekti i të dhënave

1. Nëse informacioni nuk është marrë nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi i jep subjektit të të dhënave informacionin e mëposhtëm:
 - (a) hollësitë e identitetit dhe kontaktit të kontrolluesit dhe, sipas rastit, të përfaqësuesit të kontrolluesit;
 - (b) hollësitë e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave, sipas rastit;
 - (c) qëllimin e përpunimit për të cilin janë të destinuara të dhënat personale, si dhe bazën ligjore për përpunimin;
 - (d) kategoritë e të dhënave personale përkatëse;
 - (e) marrësit ose kategoritë e marrësve të të dhënave personale, sipas rastit;
 - (f) sipas rastit, që kontrolluesi synon të transferojë të dhëna personale tek një marrës në një vend të tretë ose organizatë ndërkombëtare dhe ekzistencën ose mungesën e një vendimi përshtatshmërie të Komisionit, ose në rastin e transferimeve të referuara në Nenin 46 ose 47, ose nën-paragrafin e dytë të Nenit 49(1), referenca tek garancitë e përshtatshme ose të përshtatshme dhe mjetet me të cilat merret një kopje e tyre ose ku ato janë ofruar.
2. Përveç informacionit të referuar në paragrafin 1, kontrolluesi i jep subjektit të të dhënave informacionin e mëposhtëm për të garantuar një përpunim të drejtë dhe transparent në lidhje me subjektin e të dhënave:
 - (a) afatin për të cilin ruhen të dhënat personale, ose nëse kjo nuk është e mundur, kriteret e përdorura për të përcaktuar këtë afat;
 - (b) nëse përpunimi bazohet në pikën (f) të Nenit 6(1), interesat legjitime të ndjekura nga kontrolluesi ose nga një palë e tretë;
 - (c) ekzistencën e së drejtës për të kërkuar nga kontrolluesi akses dhe korigjimin dhe fshirjen e të dhënave personale ose kufizimin e përpunimit në lidhje me subjektin e të dhënave ose për të kundërshtuar përpunimin, si dhe të drejtën për transferimin e të dhënave;
 - (d) nëse përpunimi bazohet në pikën (a) të Nenit 6(1) ose pikën (a) të Nenit 9(2), ekzistencën e së drejtës për të tërhequr pëlqimin në çdo kohë, pa ndikuar në ligjshmërinë e përpunimit bazuar në pëlqimin para tërheqjes së tij;
 - (e) të drejtën për të paraqitur një kërkesë tek autoriteti mbikëqyrës;
 - (f) Nga cili burim e kanë origjinën të dhënat personale, dhe sipas rastit, nëse kanë ardhur nga një burim i aksesueshëm publikisht;
 - (g) ekzistencën e vendimmarrjes së automatizuar, duke përfshirë profilizimin, të përmendur në nenin 22(1) dhe (4) dhe, të paktën në ato raste, informacionin e duhur në lidhje me logjikën përkatëse, si dhe rëndësinë dhe pasojat e parashikuara të këtij përpunimi për subjektin e të dhënave.
3. Kontrolluesi jep informacionin e përmendur në paragrafin 1 dhe 2:
 - (a) brenda një afati të arsyeshëm pas marrjes së të dhënave personale, por jo më vonë se një muaj, duke pasur parasysh rrethanat specifike në të cilat përpunohen të dhënat personale;
 - (b) nëse të dhënat personale do të përdoren për komunikimin me subjektin e të dhënave, jo më vonë se komunikimi i parë me atë subjekt të dhënash, ose

(c) nëse parashikohet deklarimi ndaj një marrësi tjetër, jo më vonë se kur deklarohen për herë të parë të dhënat personale.

4. Nëse kontrolluesi synon të përpunojë më tej të dhëna personale për një qëllim të ndryshëm nga ai për të cilin të dhënat personale janë përfutur, kontrolluesi, para këtij përpunimi të mëtejshëm, duhet ti japë subjektit të të dhënave informacion mbi qëllimin tjetër dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm, sipas referimit në paragrafin 2.

5. Paragrafët 1 deri 4 nuk zbatohen nëse dhe në masën që:

(a) subjekti i të dhënave e ka informacionin;

(b) dhënia e këtij informacioni duket i pamundur ose do të përfshinte një përpjekje jo-proporcionale, veçanërisht për përpunimin për qëllime arkivimi në interesin publik, qëllime të kërkimeve shkencore ose historike, qëllime statistikore, në pajtim me kushtet dhe garancitë e referuara në Nenin 89(1) ose në masën që detyrimi i referuar në paragrafin 1 të këtij Neni mund ta bëjë të pamundur ose rrezikojë seriozisht arritjen e objektivave të këtij përpunimi. Në këto raste kontrolluesi merr masat e përshtatshme për të mbrojtur të drejtat dhe liritë dhe interesat legjitime të subjekteve të të dhënave, duke përfshirë ofrimin e informacionit publikisht;

(c) marrja ose deklarimi parashikohet shprehimisht nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet kontrolluesi dhe që merr masa të përshtatshme për të mbrojtur interesat legjitime të subjektit të të dhënave; ose

(d) nëse të dhënat personale duhet të mbeten konfidenciale duke iu nënshtuar një detyrimi të fshehtësisë profesionale të rregulluar nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar, duke përfshirë një detyrim ligjor të fshehtësisë.

Neni 15

E drejta e aksesit nga subjekti i të dhënave

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të marrë konfirmimin nga kontrolluesi nëse po përpunohen ose jo të dhënat që kanë të bëjnë me të dhe, nëse është rasti, akses tek të dhënat personale dhe informacionin e mëposhtëm:

(a) qëllimet e përpunimit;

(b) kategoritë e të dhënave personale përkatëse;

(c) marrësit ose kategoritë e marrësve të cilëve u janë ose do t'u deklarohen të dhënat personale, veçanërisht marrësit në vendet e tretë ose organizatat ndërkombëtare;

(d) sipas rastit, afati i parashikuar gjatë të cilit do të ruhen të dhënat personale, ose, nëse nuk është e mundur, kriteret e përdorura për të përcaktuar atë afat;

(e) ekzistencën e së drejtës për të kërkuar nga kontrolluesi korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale ose kufizimin e përpunimit të të dhënave personale në lidhje me subjektin e të dhënave ose për të kundërshtuar një përpunim të tillë;

(f) të drejtën për të paraqitur një kërkesë tek autoriteti mbikëqyrës;

(g) nëse të dhënat personale nuk mblidhen nga subjekti i të dhënave, çdo informacion të disponueshëm si dhe burimin e tyre;

(h) ekzistencën e vendimmarrjes së automatizuar, duke përfshirë profilizimin, të përmendur në nenin 22(1) dhe (4) dhe, të paktën në ato raste, informacionin e duhur në lidhje me logjikën përkatëse, si dhe rëndësinë dhe pasojat e parashikuara të këtij përpunimi për subjektin e të dhënave.

2. Nëse të dhënat personale transferohen tek një vend i tretë ose tek një organizatë ndërkombëtare, subjekti i të dhënave ka të drejtën të informohet për garancitë e përshtatshme në

pajtim me nenin 46 në lidhje me transferimin.

3. Kontrolluesi jep një kopje të të dhënave personale që i nënshtrohet përpunimit. Për çdo kopje tjetër të kërkuar nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi mund të caktojë një tarifë të përshtatshme bazuar në shpenzimet administrative. Nëse subjekti i të dhënave e bën kërkesën me mjete elektronike dhe, përveç kur kërkohet ndryshe nga subjekti i të dhënave, informacioni jepet në një format elektronik të përdorur bashkërisht.

4. E drejta për të përfutur kopjen e përmendur në paragrafin 3 nuk ndikon negativisht të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Seksioni 3

Korrigjimi dhe fshirja

Neni 16

E drejta e korrigjimit

Subjekti i të dhënave ka të drejtën të përftojë nga kontrolluesi pa vonesë të panevojshme korrigjimin e të dhënave personale të pasaktë në lidhje me të. Duke marrë parasysh qëllimet e përpunimit, subjekti i të dhënave ka të drejtën ti plotësohen të dhënat personale të paplota, duke përfshirë nëpërmjet bërjes së një deklarimi shtesë.

Neni 17

E drejta e fshirjes ('e drejta për tu harruar')

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të që kontrolluesi të bëjë fshirjen e të dhënave personale në lidhje me të pa vonesë dhe kontrolluesi ka detyrimin të fshijë të dhënat personale pa vonesë të panevojshme, nëse zbatohet një prej shkaqeve të mëposhtme:

(a) të dhënat personale nuk janë më të nevojshme në lidhje me qëllimet për të cilat ato janë mbledhur ose përpunuar;

(b) subjekti i të dhënave e tërheq pëlqimin mbi të cilin bazohet përpunimi sipas pikës (a) të nenit 6(1), ose pikës (a) të nenit 9(2), dhe nëse nuk ka shkak tjetër ligjor për përpunimin;

(c) subjekti i të dhënave e kundërshton përpunimin në pajtim me nenin 21(1) dhe nuk ka shkaqe legjitime mbizotëruese për përpunimin, ose subjekti i të dhënave e kundërshton përpunimin në pajtim me Nenin 21(2);

(d) të dhënat personale janë përpunuar në mënyrë të paligjshme;

(e) të dhënat personale duhet të fshihen për të përmbushur një detyrim ligjor në të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet kontrolluesi;

(f) të dhënat personale janë mbledhur në lidhje me ofertën e shërbimeve të shoqërisë së informacionit të referuara në Nenin 8(1).

2. Nëse kontrolluesi i ka bërë të dhënat personale publike dhe është i detyruar sipas paragrafit 1 ti fshijë të dhënat personale, kontrolluesi, duke marrë parasysh teknologjinë e disponueshme dhe shpenzimet për zbatimin, ndërmerr hapat e arsyeshëm, duke përfshirë masat teknike, për të informuar

kontrolluesit që po përpunojnë të dhënat personale që subjekti i të dhënave ka kërkuar fshirjen nga këta kontrollues të çdo lidhjeje ose kopje apo përsëritje të këtyre të dhënave personale.

3. Paragrafët 1 dhe 2 nuk zbatohen në masën që përpunimi është i nevojshëm:

- (a) për ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit;
- (b) për përmbushjen e një detyrimi ligjor që kërkon përpunimin nga e drejta e Bashkimit ose Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet kontrolluesi ose për përmbushjen e një detyre në interesin publik ose në ushtrim të autoritetit zyrtar të veshur kontrolluesit
- (c) për shkaqe të interesit publik në sferën e shëndetit publik në pajtim me pikat (h) dhe (i) të nenit 9(2) si dhe të nenit 9(3);
- (d) për qëllime arkivimi në interesin publik ose qëllime të kërkimit shkencor ose historik ose qëllime statistikore në pajtim me Nenin 89(1), në masën që e drejta e përmendur në paragrafin 1 mund ta bëjë të pamundur ose ta rrezikojë rëndë arritjen e objektivave të atij përpunimi; ose
- (e) për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e të pretendimeve ligjore.

Neni 18

E drejta e kufizimit të përpunimit

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të përftojë nga kontrolluesi kufizimin e përpunimit nëse zbatohet një nga sa më poshtë:

- (a) saktësia e të dhënave personale kundërshtohet nga subjekti i të dhënave për një afat që i mundëson kontrolluesit të verifikojë saktësinë e të dhënave personale;
- (b) përpunimi është i paligjshëm dhe subjekti i të dhënave e kundërshton fshirjen e të dhënave personale dhe në vend të saj kërkon kufizimin e përdorimit të tyre;
- (c) kontrolluesit nuk vazhdojnë ti duhen të dhënat personale për qëllimet e përpunimit, por ato kërkohen nga subjekti i të dhënave për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore;
- (d) subjekti i të dhënave e ka kundërshtuar përpunimin në pajtim me Nenin 21(1) në pritje të verifikimit nëse shkaqe legjitime të kontrolluesit mbizotërojnë ato të subjektit të të dhënave.

2. Nëse përpunimi është kufizuar sipas paragrafit 1, këto të dhëna personale, me përjashtim të ruajtjes, përpunohen vetëm me pëlqimin e subjektit të të dhënave për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore ose për mbrojtjen e të drejtave të një personi tjetër fizik ose juridik ose për shkaqe të interesit të rëndësishëm publik të Bashkimit ose të një Shteti Anëtar.

3. Një subjekt të dhënash që ka përfutur kufizimin e përpunimit në pajtim me paragrafin 1 informohet nga kontrolluesi para revokimit të kufizimit të përpunimit.

Neni 19

Detyrimi i njoftimit në lidhje me korigjimin ose fshirjen e të dhënave personale ose kufizimin e përpunimit

Kontrolluesi komunikon çdo korigjim ose fshirje të të dhënave personale ose kufizim të përpunimit të kryer në pajtim me Nenin 16, nenin 17(1) dhe Nenin 18 për çdo marrës të cilit i janë deklaruar të dhënat personale, përveç kur kjo duhet e pamundur ose lidhet me përpjekje jo-proporcionale. Kontrolluesi njofton subjektin e të dhënave në lidhje me këta marrës nëse subjekti i të dhënave e kërkon këtë.

Neni 20

E drejta e transferueshmërisë së të dhënave

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të marrë të dhëna personale në lidhje me të, që ai ose ajo i ka dhënë kontrolluesit, në një format të strukturuar, të përdorur gjerësisht dhe të lexueshëm automatikisht dhe ka të drejtën për të transmetuar ato të dhëna tek një kontrollues tjetër pa pengesë nga një kontrollues të cilit i janë dhënë të dhënat personale, nëse:
 - (a) përpunimi bazohet në pëlqimin në pajtim me pikën (a) të nenit 6(1) ose pikën (a) të nenit 9(2) ose në një kontratë në pajtim me pikën (b) të nenit 6(1); dhe
 - (b) përpunimi bëhet me mjete automatike.
2. Në ushtrimin e të drejtës së tij ose të saj për transferueshmërinë në pajtim me paragrafin 1, subjekti i të dhënave ka të drejtën për transferimin e të dhënave personale nga një kontrollues në tjetrin, nëse është teknikisht e mundur.
3. Ushtrimi i së drejtës së përmendur në paragrafin 1 të këtij Neni nuk e prek Nenin 17. Kjo e drejtë nuk zbatohet në përpunimin e nevojshëm për përmbushjen e një detyre të kryer në interesin publik ose në ushtrim të një autoriteti zyrtar të veshur kontrolluesit.
4. E drejta e përmendur në paragrafin 1 nuk ndikon negativisht në të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Seksioni 4

E drejta për të kundërshtuar dhe vendimmarrja individuale automatike

Neni 21

E drejta për të kundërshtuar

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën për të kundërshtuar, për shkaqe në lidhje me situatën e veçantë të tij ose të saj, në çdo kohë përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të që bazohet në pikën (e) ose (f) të nenit 6(1), duke përfshirë profilizimin e bazuar në këto dispozita. Kontrolluesi nuk vazhdon të përpunojë të dhëna personale përveç kur kontrolluesi demonstroi shkaqe detyruese legjitime për përpunimin që mbizotërojnë mbi interesat, të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore.
2. Nëse të dhënat personale përpunohen për qëllime të drejtpërdrejta marketingu, subjekti i të dhënave ka të drejtën të kundërshtojë në çdo kohë përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të për këtë marketing, që përfshin profilizimin në masën që ai ligjet me këtë marketing.
3. Nëse subjekti i të dhënave kundërshton përpunimin për qëllime të drejtpërdrejta marketing, të dhënat personale nuk vazhdojnë të përpunohen për këto qëllime.
4. Jo më vonë se në momentin e komunikimit të parë me subjektin e të dhënave, e drejta e referuar në paragrafët 1 dhe 2 sillet shprehimisht në vëmendjen e subjektit të të dhënave dhe i paraqitet qartazi dhe veçmas nga çdo informacion tjetër.
5. Në kontekstin e përdorimit të shërbimeve të shoqërisë së informacionit dhe pavarësisht Direktivës 2002/58/KE, subjekti i të dhënave mund të ushtrojë të drejtën e tij ose të saj për të kundërshtuar mjetet automatike që përdorin specifikime teknike.
6. Nëse të dhënat personale përpunohen për qëllime të kërkimeve shkencore ose historike ose qëllime statistikore në pajtim me Nenin 89(1), subjekti i të dhënave, për shkaqe në lidhje me gjendjen

e tij ose të veçantë, ka të drejtën të kundërshtojë përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të, përveç kur përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një detyre të kryer për shkaqe të interesit publik.

Neni 22

Vendim-marrja e automatizuar individuale, duke përfshirë profilizimin

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të mos i nënshtrohet një vendimi të bazuar vetëm në një përpunim automatik duke përfshirë profilizimin, që prodhon efekte në lidhje me të ose ndikon në mënyrë të ngjashme atë.
2. Paragrafi 1 nuk zbatohet nëse vendimi:
 - (a) është i nevojshëm për të lidhur ose përmbushur një kontratë ndërmjet subjektit të të dhënave dhe një kontrolluesi të dhënash;
 - (b) autorizohet nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet kontrolluesi dhe që përcakton edhe masat e përshtatshme për të garantuar të drejtat dhe liritë dhe interesat legjitime e subjektit të të dhënave; ose
 - (c) bazohet në pëlqimin e qartë të subjektit të të dhënave.
3. Në rastet e referuara në pikat (a) dhe (c) të paragrafit 2, kontrolluesi i të dhënave zbaton masa të përshtatshme për të garantuar të drejtat dhe liritë dhe interesat legjitime të subjektit të të dhënave, të paktën të drejtën për të realizuar ndërhyrjen e njeriut nga ana e kontrolluesit, për të shprehur këndvështrimin e tij dhe për të kundërshtuar vendimin.
4. Vendimet e përmendura në paragrafin 2 nuk bazohen në kategoritë e veçanta të të dhënave personale të përmendura në Nenin 9(1), përveç kur pika (a) ose (g) e nenit 9(2) zbatohet dhe masat e përshtatshme për të garantuar të drejtat, liritë dhe interesat legjitime të subjektit të të dhënave janë në fuqi.

Seksioni 5

Kufizimet

Neni 23 Kufizimet

1. E drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet kontrolluesi ose përpunuesi i të dhënave mund të kufizojë nëpërmjet një mase legjislative objektin e detyrimeve dhe të drejtave të parashikuara në Nenet 12 deri 22 dhe Nenin 34, si dhe Nenin 5, në masën që dispozitat e saj përputhen me të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në nenet 12 deri 22, nëse një kufizim i tillë respekton thelbin e të drejtave dhe lirive themelore dhe është një masë e nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike për të garantuar:
 - (a) sigurinë kombëtare;
 - (b) mbrojtjen;
 - (c) sigurinë publike;
 - (d) parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë garantimin ndaj parandalimit të kërcënimeve për sigurinë publike;
 - (e) objektiva të tjera të rëndësishme të interesit të përgjithshëm publik të Bashkimit ose të një Shteti Anëtar, veçanërisht një interes i rëndësishëm ekonomik ose financiar i Bashkimit ose i një Shteti Anëtar, duke përfshirë çështjet monetare, buxhetore ose të tatimeve, shëndetit publik dhe

sigurisë sociale;

(f) mbrojtja e pavarësisë gjyqësore dhe e procedimeve gjyqësore;

(g) parandalimin, hetimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të shkeljes së etikës për profesionet e rregulluara;

(h) një funksion monitorues, inspektues ose rregullator që lidhet, edhe rastësisht, me ushtrimin e autoritetit zyrtar në rastet e përmendura në pikat (a) deri (e) dhe (g);

(i) mbrojtjen e subjektit të të dhënave ose të të drejtave dhe lirive të të tjerëve;

(j) ekzekutimin e pretendimeve sipas së drejtës civile.

2. Veçanërisht, çdo masë legjislative e përmendur në paragrafin 1 përmban dispozita specifike të paktën, sipas rastit, në lidhje me:

(a) qëllimet e përpunimit ose kategoritë e përpunimit;

(b) kategoritë e të dhënave personale;

(c) objektin e kufizimeve të prezantuara;

(d) garancitë për të parandaluar abuzimin ose aksesin ose transferimin e paligjshëm;

(e) specifikimin e kontrolluesit ose kategorive të kontrolluesit;

(f) afatet e ruajtjes dhe garancitë e zbatueshme duke marrë parasysh natyrën, objektin dhe qëllimet për përpunimin ose kategoritë e përpunimit;

(g) risqet për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave; dhe

(h) të drejtën e subjekteve të të dhënave për tu informuar në lidhje me kufizimin, përveç kur kjo mund të jetë në dëm të qëllimit të kufizimit.

KAPITULLI IV

Kontrolluesi dhe përpunuesi

Seksioni 1

Detyrime të përgjithshme

Neni 24

Përgjegjësia e kontrolluesit

1. Duke marrë parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit si dhe risqet me eventualitet variabël dhe ashpërsinë për të drejtët dhe liritë e personave fizikë, kontrolluesi zbaton masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar qenien në gjendje për të demonstruar që përpunimi të kryhet në pajtim me këtë Rregullore. Këto masa rishikohen dhe përditësohen sipas nevojës.

2. Nëse është proporcionale në lidhje me aktivitetet përpunuese, masat e përmendura në paragrafin 1 përfshijnë zbatimin e politikave të përshtatshme për mbrojtjen e të dhënave nga kontrolluesi.

3. Respektimi i kodeve të aprovuar të sjelljes sipas referencën në Nenin 40 ose mekanizmave të aprovuara për certifikimin sipas referimit në Nenin 42 mund të përdoret si një element nëpërmjet të cilit të demonstrohet përputhshmëri me detyrimet e kontrolluesit.

Mbrojtja e të dhënave në mënyrë konkrete dhe rastësore

1. Duke marrë parasysh gjendjen e teknikës, koston e zbatimit dhe natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit si dhe risqet me eventualitet variabël dhe ashpërsinë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë që rrjedhin nga përpunimi, kontrolluesi, në momentin e përcaktimit të mjeteve të përpunimit dhe në momentin e vetë përpunimit zbatojnë masa të përshtatshme teknike dhe organizative, si anonimizimi, që janë të destinuara për të zbatuar parimet e mbrojtjes së të dhënave, si minimizimi i të dhënave, në një mënyrë të efektshme për të integruar garancitë e nevojshme në përpunim me qëllim që të përmbushen kërkesat e kësaj rregulloreje dhe mbrojtur të drejtat e subjekteve të të dhënave.
2. Kontrolluesi zbaton masat e përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar që, në mënyrë rastësore, të përpunohen vetëm të dhënat personale që janë të nevojshme për secilin qëllim specifik të përpunimit. Ky detyrim zbatohet për shumën e të dhënave personale që janë mbledhur, masën e përpunimit të tyre, afatin e ruajtjes së tyre dhe aksesueshmërisë së tyre. Veçanërisht, këto masa garantojnë që të dhënat personale nuk bëhen të aksesueshme në mënyrë rastësore pa ndërhyrjen e individit për një numër të pacaktuar të personave fizikë.
3. Një mekanizëm e aprovuar certifikimi në pajtim me Nenin 42 mund të përdoret si një element për të demonstruar përputhshmëri me kërkesat e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij Neni.

Neni 26

Kontrolluesit e përbashkët

1. Nëse dy ose më shumë kontrollues përcaktojnë së bashku qëllimet dhe mjetet e përpunimit, ato quhen kontrollues të përbashkët. Ata përcaktojnë në një mënyrë transparente përgjegjësitë e tyre përkatëse për përputhshmërinë me detyrimet sipas kësaj Rregulloreje, veçanërisht në lidhje me ushtrimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe detyrat e tyre përkatëse për të dhënë informacionin e referuar në Nenet 13 dhe 14, nëpërmjet një mase ndërmjet tyre, përveç kur dhe në masën që, përgjegjësitë përkatëse të kontrolluesve janë të përcaktuara nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohen kontrolluesit. Masa mund të përcaktojë një pikë kontakti për subjektet e të dhënave.
2. Masa e referuar në paragrafin 1 reflekton si duhen rolet dhe raportet e kontrolluesve të përbashkët kundrejt subjekteve të të dhënave. Thelbi i masës i bëhet e ditur subjektit të të dhënave.
3. Pavarësisht nga termat e masës së përmendur në paragrafin 1, subjekti i të dhënave mund të ushtrojë të drejtat e tij ose të saj sipas kësaj Rregulloreje në lidhje me dhe kundër çdo kontrolluesi.

Përfaqësuesit e kontrolluesit ose përpunuesit që nuk janë vendosur në Bashkim

1. Nëse zbatohet Neni 3(2), kontrolluesi ose përpunuesi cakton me shkrim një përfaqësues në Bashkim.
2. Detyrimi i parashikuar në paragrafin 1 të këtij Neni nuk zbatohet për:
 - (a) përpunimin që është rastësor, nuk përfshin, në masë të madhe, përpunimin e kategorive të veçanta të të dhënave të referuara në Nenin 9(1) ose përpunimin e të dhënave personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale të referuara në Nenin 10, dhe duket se nuk rezulton në një risk për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, duke marrë parasysh natyrën, kontekstin, objektin dhe qëllimet e përpunimit; ose
 - (b) një autoritet ose organ publik.
3. Përfaqësuesi vendoset në një prej shteteve Anëtare ku janë subjektet e të dhënave, të dhënat personale të të cilëve përpunohen në lidhje me ofrimin e mallrave ose shërbimeve për ta, ose sjellja e të cilëve monitorohet.
4. Përfaqësuesi autorizohet nga kontrolluesi ose përpunuesi të investohet, përveç ose në vend të kontrolluesit ose përpunuesit, veçanërisht, nga autoritetet mbikëqyrëse dhe subjektet e të dhënave, për të gjitha çështjet në lidhje me përpunimin, për qëllimet e sigurimit të përputhshmërisë me këtë Rregullore.
5. Caktimi i një përfaqësuesi nga kontrolluesi ose përpunuesi nuk pengon procedimet gjyqësore që mund të fillohen ndaj vetë kontrolluesit ose përpunuesit.

Neni 28

Përpunuesi

1. Nëse përpunimi duhet të kryhet në emër të një kontrolluesi, kontrolluesi përdor vetëm përpunues që ofrojnë garanci të mjaftueshme për të zbatuar masat e përshtatshme teknike dhe organizative në një mënyrë të tillë që përpunimi do të përmbushë kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe të garantojë mbrojtjen e të drejtave të subjektit të të dhënave.
2. Përpunuesi nuk angazhon një përpunues tjetër pa autorizimin paraprak specifik ose të përgjithshëm me shkrim të kontrolluesit. Në rastin e autorizimit të përgjithshëm me shkrim, përpunuesi informon kontrolluesin për çdo ndryshim të synuar në lidhje me shtimin ose zëvendësimin e përpunuesve të tjerë, duke i dhënë kontrolluesit mundësi për të kundërshtuar këto ndryshime.
3. Përpunimi nga një përpunues rregullohet nga një kontratë ose akt tjetër ligjor sipas së drejtës së Bashkimit ose të Shtetit Anëtar, që është detyrues për përpunuesin në lidhje me kontrolluesin dhe që përcakton objektin dhe kohëzgjatjen e përpunimit, natyrën dhe qëllimin e përpunimit, tipin e të dhënave personale dhe kategorive të subjekteve të të dhënave dhe detyrimet dhe të drejtët e kontrolluesit. Kjo kontratë ose akt tjetër ligjor parashikon, veçanërisht, që përpunuesi:
 - (a) përpunon të dhënat personale vetëm sipas udhëzimeve të dokumentuara nga kontrolluesi, duke përfshirë në lidhje me transferimet e të dhënave personale tek një vend i tretë ose një organizatë ndërkombëtare, përveç kur i kërkohet ta bëjë këtë nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet përpunuesi; në një rast të tillë, përpunuesi informon kontrolluesin për këtë kërkesë ligjore para përpunimit, përveç kur ligji e ndalon këtë informim për shkaqe të rëndësishme të interesit publik;

- (b) garanton që personat e autorizuar për të përpunuar të dhënat personale i janë nënshtruar konfidencialitetit ose janë nën detyrimin ligjor të përshtatshëm të konfidencialitetit;
- (c) merr të gjitha masat e kërkuara sipas nenit 32;
- (d) respekton kushtet e referuara në paragrafët 2 dhe 4 për angazhimin e një përpunuesi tjetër;
- (e) duke marrë parasysh natyrën e përpunimit, asiston kontrolluesin me masa të përshtatshme teknike dhe organizative, në masën që kjo është e mundur, për përmbushjen e detyrimit të kontrolluesit për t'iu përgjigjur kërkesave për ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave të parashikuara në Kapitullin III;
- (f) Asiston kontrolluesin në sigurimin e përputhshmërisë me detyrimet në pajtim me Nenet 32 deri 36 duke marrë parasysh natyrën e përpunimit dhe informacionin e ofruar përpunuesit;
- (g) sipas zgjedhjes së kontrolluesit, fshin ose kthen të gjitha të dhënat personale tek kontrolluesi pas përfundimit të dhënies së shërbimeve në lidhje me përpunimin, dhe fshin kopjet ekzistuese, përveç kur e drejta e Bashkimit ose Shtetit Anëtar e kërkon ruajtjen e të dhënave personale;
- (h) i ofron kontrolluesit të gjithë informacionin e nevojshëm për të demonstruar përputhshmëri me detyrimet e parashikuara në këtë Nen dhe lejon dhe kontribuon për auditimet, duke përfshirë inspektimet, e zhvilluara nga kontrolluesi ose një audit tjetër të autorizuar nga kontrolluesi.

Në lidhje me pikën (h) të nën-paragrafit të parë, përpunuesi njofton menjëherë kontrolluesin nëse, sipas mendimit të tij, një udhëzim e shkel këtë Rregullore ose dispozita të tjera të bashkimit ose Shtetit Anëtar për mbrojtjen e të dhënave.

4. Nëse një përpunues angazhon një përpunues tjetër për kryerjen e aktiviteteve specifike të përpunimit në emër të kontrolluesit, të njëjtat detyrime për mbrojtjen e të dhënave sipas parashikimit në kontratë ose në aktin tjetër ligjor ndërmjet kontrolluesit dhe përpunuesit, sipas referimit në paragrafin 3 i caktohen përpunuesit tjetër nëpërmjet një kontrate ose një akti tjetër ligjor sipas së drejtës së Bashkimit ose Shtetit Anëtar, veçanërisht duke dhënë garanci të mjaftueshme për zbatimin e masave të përshtatshme teknike dhe organizative në një mënyrë të tillë që përpunimi të përmbushë kërkesat e kësaj Rregulloreje. Nëse përpunuesi tjetër nuk përmbush detyrimet për mbrojtjen e të dhënave, përpunuesi i parë mbetet tërësisht përgjegjës kundrejt kontrolluesit për përmbushjen e detyrimeve të përpunuesit tjetër.

5. Respektimi nga një përpunues i kodeve të aprovuar të sjelljes sipas referencën në Nenin 40 ose mekanizmave të aprovuara për certifikimin sipas referimit në Nenin 42 mund të përdoret si një element nëpërmjet të cilit të demonstrohen garanci të mjaftueshme sipas referimit në paragrafët 1 dhe 4 të këtij Neni.

6. Pa cenuar një kontratë individuale ndërmjet kontrolluesit dhe përpunuesit, kontrata ose akti tjetër ligjor i referuar në paragrafët 3 dhe 4 të këtij Neni mund të bazohet, plotësisht ose pjesërisht, mbi klauzolat standarde kontraktuale të referuara në paragrafët 7 dhe 8 të këtij Neni, duke përfshirë kur ata janë pjesë e një certifikimi të dhënë kontrolluesit ose përpunuesit në pajtim me Nenet 42 dhe 43.

7. Komisioni mund të vendosë klauzola standarde kontraktuale për çështjet e referuara në paragrafin 3 dhe 4 të këtij Neni dhe në pajtim me procedurën e shqyrtimit të referuar në Nenin 93(2).

8. Një autoritet mbikëqyrës mund të miratojë klauzola kontraktuale standarde për çështjet e referuara në paragrafët 3 dhe 4 të këtij Neni dhe në pajtim me mekanizmin e përputhshmërisë të referuar në Nenin 63.

9. Kontrata ose akti tjetër ligjor i referuar në paragrafët 3 dhe 4 janë me shkrim, duke përfshirë formatin elektronik.

10. Pa cenuar Nenet 82, 83 dhe 84, nëse një përpunues e shkel këtë Rregullore duke përcaktuar qëllime dhe mjetet e përpunimit, përpunuesi konsiderohet të jetë një kontrollues në lidhje me këtë

Neni 29

Përpunimi nën autoritetin e kontrolluesit ose të përpunuesit

Përpunuesi dhe çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit ose të përpunuesit, i cili ka akses tek të dhënat personale, nuk i përpunon ato të dhëna përveç se sipas udhëzimeve nga kontrolluesi, përveç kur i kërkohet ta bëjë këtë nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar.

Neni 30

Regjistrat e aktiviteteve përpunuese

1. Secili kontrollues dhe, sipas rastit, përfaqësuesi i kontrolluesit, mban regjistrin e aktiviteteve të përpunimit nën përgjegjësinë e tij. Ky regjistër mban të gjithë informacionin e mëposhtëm:

- (a) emrin dhe hollësitë e kontaktit të kontrolluesit dhe, sipas rastit, kontrolluesin e përbashkët, përfaqësuesin e kontrolluesit dhe nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave;
- (b) qëllimet e përpunimit;
- (c) një përshkrim të kategorive të subjekteve të të dhënave dhe të kategorive të të dhënave personale;
- (d) kategoritë e marrësve të cilëve u janë ose do t'u deklarohen të dhënat personale duke përfshirë marrësit në vendet e tretë ose organizatat ndërkombëtare;
- (e) sipas rastit, transferimet e të dhënave personale tek një vend i tretë ose organizatë ndërkombëtare, duke përfshirë identifikimin e atij vendi të tretë ose organizate ndërkombëtare, dhe, në rastin e transferimeve të referuara në nën paragrafin e dytë të Nenit 49(1), dokumentacionin e garancive të përshtatshme;
- (f) sipas rastit, afatet kohore të parashikuara për fshirjen e kategorive të ndryshme të të dhënave;
- (g) sipas rastit, një përshkrim të përgjithshëm të masave teknike dhe organizative të sigurisë të referuara në Nenin 32(1).

2. Çdo përpunues dhe, sipas rastit, përfaqësuesi i përpunuesit mban një regjistër për të gjitha kategoritë e aktiviteteve të përpunimit të kryera në emër të kontrolluesit, që përmban:

- (a) emrin dhe hollësitë e kontaktit të përpunuesit ose përpunuesve dhe të çdo kontrolluesi në emër të të cilit vepron përpunuesi, dhe, sipas rastit, të përfaqësuesit të kontrolluesit ose përpunuesit, dhe nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave;
- (b) kategoritë e përpunimit të kryera në emër të secilit kontrollues;
- (c) sipas rastit, transferimet e të dhënave personale tek një vend i tretë ose organizatë ndërkombëtare, duke përfshirë identifikimin e atij vendi të tretë ose organizate ndërkombëtare, dhe, në rastin e transferimeve të referuara në nën paragrafin e dytë të Nenit 49(1), dokumentacionin e garancive të përshtatshme;
- (d) sipas rastit, një përshkrim të përgjithshëm të masave teknike dhe organizative të sigurisë të referuara në Nenin 32(1).

3. Regjistrat e referuar në paragrafët 1 dhe 2 janë me shkrim, duke përfshirë formatin elektronik.

4. Kontrolluesi ose përpunuesi dhe, sipas rastit, përfaqësuesi i kontrolluesit ose përfaqësuesit ia

paraqet regjistrin autoritetit mbikëqyrës me kërkesë.

5. Detyrimet e referuara në paragrafët 1 dhe 2 nuk zbatohen për një ndërmarrje ose një organizatë që ka të punësuar më pak se 250 persona, përveç kur përpunimi që kryen mund të rezultojë në një risk për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave, përpunimi nuk është rastësor ose përpunimi përfshin kategori të veçanta të të dhënave të referuara në Nenin 9(1) ose të dhënat personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale të përmendura në Nenin 10.

Neni 31

Bashkëpunimi me autoritetin mbikëqyrës

Kontrolluesi dhe përpunuesi dhe, sipas rastit, përfaqësuesit e tyre, bashkëpunojnë, me kërkesë, me autoritetin mbikëqyrës në përmbushjen e detyrave të tyre.

Seksioni 2

Siguria e të dhënave personale

Neni 32

Siguria e përpunimit

1. Duke marrë parasysh gjendjen e teknikës, shpenzimet e zbatimit dhe natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit si dhe riskun e mundësisë variabël dhe ashpërsinë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, kontrolluesi dhe përpunuesi zbaton masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm për riskun, duke përfshirë, ndër të tjera, sipas rastit:

- (a) Anonimizimin dhe enkriptimin e të dhënave personale;
- (b) Aftësinë për të siguruar konfidencialitetin integritetin, disponibilitetin dhe qëndrueshmërinë në vazhdim të sistemeve dhe shërbimeve të përpunimit;
- (c) aftësinë për të rivendosur disponibilitetin dhe aksesin tek të dhënat personale në kohën e duhur në rastin e një incidenti fizik ose teknik;
- (d) Një proces të testimit, vlerësimit të rregullt të efektivitetit të masave teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e përpunimit.

2. Në vlerësimin e nivelit të përshtatshëm të sigurisë duhet të merret parasysh veçanërisht risqet që paraqiten nga përpunimi, veçanërisht nga asgjësimi, humbja, ndryshimi aksidental ose i paligjshëm, deklarimi i paautorizuar ose aksesit tek të dhënat personale të transmetuara, ruajtura ose përpunuara ndryshe.

3. Respektimi i një kodi të aprovuar të sjelljes sipas referencën në Nenin 40 ose mekanizmave të aprovuara për certifikimin sipas referimit në Nenin 42 mund të përdoret si një element nëpërmjet të cilit të demonstrohen përputhshmëri me kërkesat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij Neni.

4. Kontrolluesi dhe përpunuesi ndërmerr hapa për të garantuar që çdo person fizik që vepron nën autoritetin e kontrolluesit ose të përpunuesit, i cili ka akses tek të dhënat personale, nuk i përpunon ato përveç se sipas udhëzimeve nga kontrolluesi, përveç kur i kërkohet ta bëjë këtë nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar.

Njoftimi i autoritetit mbikëqyrës për një shkeljeje të të dhënave personale

1. Në rastin e një shkeljeje të të dhënave personale, kontrolluesi pa vonesë dhe, sipas rastit, jo më vonë se 72 orë pas ardhjes në dijeni të saj, njofton autoritetin mbikëqyrës kompetent në pajtim me nenin 55 për shkeljen e të dhënave personale, përveç kur shkelja e të dhënave personale nuk mund të rezultojë në një risk për të drejtat dhe liritë e personave fizikë. Nëse njoftimi i autoritetit mbikëqyrës nuk bëhet brenda 72 orëve, ai shoqërohet me shkaqet e vonesës.
2. Përpunuesit njoftojnë kontrolluesin pa vonesë të panevojshme pas ardhjes në dijeni të një shkeljeje të të dhënave personale.
3. Njoftimi i përmendur në paragrafin 1 të paktën:
 - (a) përshkruan natyrën e shkeljes së të dhënave personale duke përfshirë, sipas rastit, kategoritë dhe numrin e përafërt të subjekteve të të dhënave dhe kategoritë me numrin e përafërt të regjistrave të të dhënave personale përkatëse;
 - (b) komunikon emrin dhe të dhënat e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave dhe çdo pikë tjetër të kontaktit nëse mund të merret më shumë informacion;
 - (c) përshkruan pasojat e mundshme të shkeljes së të dhënave personale;
 - (d) përshkruan masat e marra ose të propozuara për tu marrë nga kontrolluesi për të trajtuar shkeljen e të dhënave personale, duke përfshirë, sipas rastit, masat për të zbutur efektet e mundshme negative.
4. Nëse dhe në masën që nuk është e mundur që informacioni të jepet në të njëjtën kohë, informacioni mund të jepet në faza pa vonesë tjetër të panevojshme.
5. Kontrolluesi dokumenton çdo shkelje të të dhënave personale, që përbëhet nga faktet në lidhje me shkeljen e të dhënave personale, efektet e saj dhe veprimi korrigjues i marrë. Ky dokumentacion i mundëson autoritetit mbikëqyrës për të verifikuar përputhshmërinë me këtë Nen.

Komunikimi i shkeljes së të dhënave personale subjektit të të dhënave

1. Nëse shkelja e të dhënave personale mund të rezultojë në një risk të lartë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, kontrolluesi ia komunikon shkeljen e të dhënave personale subjektit të të dhënave pa vonesë të panevojshme.
2. Komunikimi drejtuar subjektit të të dhënave personale sipas referimit në paragrafin 1 të këtij neni përshkruan në një gjuhë të pastër dhe të qartë natyrën e shkeljes së të dhënave personale dhe përmban të paktën informacionin dhe masat e përmendura në pikat (b), (c) dhe (d) të nenit 33(3).
3. Komunikimi drejtuar subjektit të të dhënave të përmendur në paragrafin 1 nuk kërkohet nëse përmbushet një prej kushteve të mëposhtme:
 - (a) kontrolluesi ka zbatuar masa të përshtatshme teknike dhe organizative mbrojtëse dhe këto masa u zbatuan për të dhënat personale të ndikuara nga shkelja e të dhënave personale, veçanërisht ato që i bëjnë të dhënat personale të pakuptueshme për çdo person që nuk është i autorizuar për të aksesuar atë, si enkriptimi;
 - (b) kontrolluesi ka marrë masa pasuese që garantojnë që risku i lartë për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave të përmendura në paragrafin 1 nuk vazhdon të jetë i mundur për tu realizuar;

(c) do të kishte të bënte me një përpjekje disproporcionale. Në një rast të tillë, në vend të kësaj do të ketë një komunikim publik ose një masë e ngjashme nëpërmjet të cilës subjektet e të dhënave informohen në një mënyrë njëlloj të efektshme.

4. Nëse kontrolluesi nuk ia ka komunikuar shkeljen e të dhënave personale subjektit të të dhënave, autoriteti mbikëqyrës, duke marrë parasysh mundësinë që shkelja e të dhënave personale të rezultojë në një risk të lartë, mund të kërkojë ta bëjë këtë ose të vendosë që të përmbushet një prej kushteve të referuara në paragrafin 3.

Seksioni 3

Vlerësimi i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave dhe konsultimet paraprake

Neni 35

Vlerësimi i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave

1. Nëse një tip i përpunimit, veçanërisht përdorimi i teknologjive të reja dhe duke marrë parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, mund të rezultojë në një risk të lartë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, kontrolluesi, para përpunimit, kryhen një vlerësim të ndikimit të operacioneve të parashikuara të përpunimit mbi përpunimin e të dhënave personale. Një vlerësim i vetëm mund të trajtojë një komplet operacionesh të ngjashme përpunimi që paraqesin risqe të larta të ngjashme.

2. Kontrolluesi kërkon këshillën e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave, nëse është caktuar, në kryerjen e vlerësimit të ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave.

3. Një vlerësim i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave i përmendur në paragrafin 1 veçanërisht kërkohet në rastin e:

(a) një vlerësimi sistematik dhe ekstensiv të aspekteve personale në lidhje me personat fizikë, i cili bazohet në përpunimin automatik, duke përfshirë profilizimin dhe në të cilin bazohen vendimet që prodhojnë efekte ligjore në lidhje me personat fizikë ose ndikojnë në masë të ngjashme personin fizik;

(b) përpunimit në shkallë të gjerë të kategorive të veçanta të të dhënave të përmendura në Nenin 9(1), ose të të dhënave personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale të përmendura në Nenin 10; ose

(c) një monitorimi sistematik të një zone me akses publik në një shkallë të gjerë.

4. Autoriteti mbikëqyrës përpilon dhe bën publike një listë për llojin e operacioneve të përpunimit që i nënshtrohen kërkesës së një vlerësimi të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave në pajtim me paragrafin 1. Autoriteti mbikëqyrës i komunikon ato lista Bordit të përmendur në nenin 68.

5. Autoriteti mbikëqyrës mund të përpilojë dhe bëjë publike një listë me llojin e operacioneve të përpunimit për të cilat nuk kërkohet vlerësimi i ndikimit të mbrojtjes së të dhënave. Autoriteti mbikëqyrës ia komunikon këto lista bordit.

6. Para miratimit të listave të përmendura në paragrafët 4 dhe 5, autoriteti kompetent mbikëqyrës zbaton mekanizmat e përputhshmërisë së përmendur në Nenin 63, nëse këto lista përfshijnë aktivitete përpunimi të cilat kanë të bëjnë me ofrimin e mallrave ose shërbimeve

subjekteve të të dhënave ose monitorimin e sjelljes së tyre në disa Shtete Anëtare, ose mund të ndikojnë në mënyrë thelbësore lëvizjen e lirë të të dhënave personale brenda Bashkimit.

7. Vlerësimi të paktën përmban:

(a) një përshkrim sistematik të operacioneve të përpunimit të parashikuar dhe qëllimet e përpunimit, duke përfshirë, sipas rastit, interesin legjitim të ndjekur nga kontrolluesi;

(b) një vlerësim të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të operacioneve të përpunimit në lidhje me qëllimet;

(c) një vlerësim të risqeve për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave të referuara në paragrafin 1; dhe

(d) masat e parashikuara për të trajtuar risqet, duke përfshirë garancitë, masat e sigurisë dhe mekanizmat për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe për të demonstruar përputhshmëri me këtë Rregullore duke marrë parasysh të drejtat dhe interesat legjitime të subjekteve të të dhënave dhe personave të tjerë të interesuar.

8. Respektimi i kodeve të aprovuar të sjelljes të referuar në nenin 40 nga kontrolluesit ose përpunuesit merren parasysh në vlerësimin e ndikimit të operacioneve të përpunimit të kryera nga këta kontrollues ose përpunues, veçanërisht për qëllimet e vlerësimit të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave.

9. Sipas rastit, kontrolluesi kërkon mendimet e subjekteve të të dhënave ose përfaqësuesve të tyre mbi përpunimin e synuar, pa cenuar mbrojtjen e interesave tregtare ose publike ose sigurinë e operacioneve të përpunimit.

10. Nëse përpunimi në pajtim me pikën (c) ose (e) të Nenit 6(1) ka një bazë ligjore në të drejtën e Bashkimit ose në të drejtën e Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet kontrolluesi, kjo e drejtë rregullon operacionet specifike të përpunimit ose kompletin e operacioneve në fjalë, dhe një vlerësimi i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave është kryer si pjesë e një vlerësimi të përgjithshëm të ndikimit në kontekstin e miratimit të asaj baze ligjore, paragrafët 1 deri 7 nuk zbatohen përveç kur Shtetet Anëtare e konsiderojnë të nevojshme për të kryer një vlerësim të tillë para aktiviteteve përpunuese.

11. Sipas rastit, kontrolluesi kryhen një rishikim për të vlerësuar nëse përpunimi kryhen në pajtim me vlerësimin e ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave të paktën kur ka një ndryshim të riskut të përfaqësuar nga operacionet e përpunimit.

Neni 36

Konsultimi paraprak

1. Kontrolluesi konsultohet me autoritetin mbikëqyrës para përpunimit nëse vlerësimi i ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave sipas Nenit 35 tregon që përpunimi do të rezultonte në një risk të lartë në mungesë të masave të marra nga kontrolluesi për të zbutur riskun.

2. Nëse autoriteti mbikëqyrës është i mendimit që përpunimi i synuar i referuar në paragrafin 1 do të shkelte këtë Rregullore, veçanërisht nëse kontrolluesi ka identifikuar ose zbutur riskun në masë të pamjaftueshme, autoriteti mbikëqyrës, brenda një afati deri në tetë javë nga marrja e kërkesës për konsultim, i paraqet kontrolluesit këshillim më shkrim dhe, nëse zbatohet për përpunuesin, mund të përdorë një prej kompetencave të përmendura në Nenin 58. Ky afat mund të zgjatet gjashtë javë, duke marrë parasysh kompleksitetin e përpunimit të synuar. Autoriteti mbikëqyrës informon

kontrolluesin dhe, sipas rastit, përpunuesin për çdo zgjatje të tillë brenda një muaji nga marrja e kërkesës për konsultime së bashku me shkaqet e vonesës. Këto afate mund të pezullohen derisa autoriteti mbikëqyrës të ketë përftuar informacionin që ai ka kërkuar për qëllimet e konsultimeve.

3. Gjatë konsultimit me autoritetin mbikëqyrës në pajtim me paragrafin 1, kontrolluesi i paraqet autoritetit mbikëqyrës:

- (a) sipas rastit, përgjegjësitë përkatëse të kontrolluesit, kontrolluesit të përbashkët dhe përpunuesve të përfshirë në përpunim, veçanërisht për përpunimin brenda një grupi të ndërmarrjeve;
- (b) qëllimet dhe mjetet e përpunimit të synuar;
- (c) masat dhe garancitë e parashikuara për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave në pajtim me këtë Rregullore;
- (d) sipas rastit, hollësitë e kontaktit për nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave;
- (e) vlerësimin e ndikimit të mbrojtjes së të dhënave të parashikuar në Nenin 35; dhe
- (f) çdo informacion tjetër të kërkuar nga autoriteti mbikëqyrës.

4. Shtetet Anëtare konsultohen me autoritetin mbikëqyrës gjatë përgatitjes së një propozimi që një masë legjislative të miratohet nga një parlament i brendshëm ose e një mase rregullatore të bazuar në një masë legjislative të tillë, që ka të bëjë me përpunimin.

5. Pavarësisht paragrafit 1, e drejta e Shtetit Anëtar mund të kërkojë që kontrolluesit të konsultohen dhe të marrin autorizim paraprak nga autoriteti mbikëqyrës në lidhje me përpunimin nga një kontrollues për kryerjen e një detyre që përmbushet nga kontrolluesi në interes publik, duke përfshirë përpunimin në lidhje me mbrojtjen sociale dhe shëndetin publik.

Seksioni 4

Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave

Neni 37

Caktimi i nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave

1. Kontrolluesi dhe përpunuesi caktojnë një nëpunës për mbrojtjen e të dhënave në çdo rast nëse:

- (a) përpunimi kryhet nga një autoritet ose organ publik, përveç gjykatave që veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore;
- (b) aktivitetet kryesore të kontrolluesit ose të përpunuesit përbëhen nga operacionet përpunuese që në saj të natyrës, objektit dhe/ose qëllimit të tyre, kërkojnë monitorim të rregullt dhe sistematik të subjektit të të dhënave në një shkallë të gjerë; ose
- (c) aktivitetet kryesore të kontrolluesit ose të përpunuesit përbëhen nga përpunimi në një shkallë të gjerë i kategorive të veçanta në pajtim me Nenin 9 dhe të dhëna personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale të referuara në Nenin 10.

2. Një grup ndërmarrjesh mund të caktojë një nëpunës të vetëm për mbrojtjen e të dhënave, me kusht që një nëpunës i mbrojtjes së të dhënave të jetë lehtësisht i aksesueshëm nga çdo strukturë.

3. Nëse kontrolluesi ose përpunuesi është një autoritet ose organ publik, mund të caktohet një nëpunës i vetëm për mbrojtjen e të dhënave për disa autoriteti ose organe të tilla, duke pasur parasysh strukturën e tyre organizative dhe madhësinë.

4. Në raste të ndryshme nga ato të referuara në paragrafin 1, kontrolluesi ose përpunuesi ose shoqatat ose organet e tjera që përfaqësojnë kategori të kontrolluesve ose përpunuesve mund ose, nëse kërkohet nga e drejta e Bashkimit ose Shtetit Anëtar, cakton një nëpunës për mbrojtjen e të dhënave. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave mund të veprojë për këto shoqata ose organe të tjera që përfaqësojnë kontrolluesit ose përpunuesit.

5. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave caktohet mbi bazën e cilësive profesionale dhe, veçanërisht, ekspertiza për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave praktikat dhe aftësia për të përmbushur detyrat e përmendura në Nenin 39.

6. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave mund të jetë anëtar personeli kontrolluesit ose përpunuesit ose të përmbushë detyrat mbi bazën e një kontrate shërbimi.

7. Kontrolluesi ose përpunuesi publikon hollësitë e kontaktit të nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave dhe ia komunikon ato autoritetit mbikëqyrës.

Neni 38

Pozicioni i nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave

1. Kontrolluesi dhe përpunuesi garantojnë që nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave përfshihet në mënyrën dhe kohën e duhur, në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Kontrolluesi dhe përpunuesi mbështet nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave në përmbushjen e detyrave të referuara në Nenin 39 duke parashikuar masat e nevojshme për të kryer ato detyra dhe aksesuar operacionet e përpunimit të të dhënave personale dhe për të mbajtur ekspertizën e vet.

3. Kontrolluesi dhe përpunuesi garantojnë që nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave nuk merr udhëzime në lidhje me ushtrimin e këtyre detyrave. Ai ose ajo nuk pushohet apo penalizohet nga kontrolluesi ose përpunuesi për përmbushjen e detyrave të tij. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave raporton drejtpërdrejtë në nivelin më të lartë të menaxhimit të kontrollit ose përpunuesit.

4. Subjektet e të dhënave mund të kontaktojnë nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave në lidhje me çështjet për sa i takojnë përpunimit të të dhënave të tyre personale dhe për ushtrimin e të drejtave të tyre sipas kësaj Rregulloreje.

5. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave i nënshtrohet fshehtësisë ose konfidencialitetit në lidhje me përmbushjen e detyrave të tij ose të saj, në pajtim me të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar.

6. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave mund të përmbushë detyra të tjera. Kontrolluesi ose përpunuesi garantojnë që çdo detyrë tjetër e tillë nuk rezulton në konflikt interesash.

Neni 39

Detyrat e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave

1. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave ka të paktën detyrat e mëposhtme:

(a) informon dhe këshillon kontrolluesin ose përpunuesin dhe të punësuarit të cilët kryejnë përpunimin mbi detyrimet e tyre në pajtim me këtë Rregullore dhe dispozitat e tjera të Bashkimit ose

Shtetit Anëtar për mbrojtjen e të dhënave;

(b) monitoron respektimin e kësaj Rregulloreje, me dispozitat e tjera të Bashkimit ose Shtetit Anëtar për mbrojtjen e të dhënave dhe politikave të kontrolluesit ose përpunuesit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë caktimin e përgjegjësive, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e personelit të përfshirë në operacionet e përpunimit dhe auditimet përkatëse;

(c) jep këshilla, sipas rastit, në lidhje me vlerësimin e ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave dhe monitoron performancën në pajtim me nenin 35;

(d) bashkëpunon me autoritetin mbikëqyrës;

(e) vepron si pikë kontakti për autoritetin mbikëqyrës për çështjet në lidhje me përpunimin, duke përfshirë konsultimin paraprak të referuar në Nenin 36 dhe konsultohet, sipas rastit, në lidhje me çdo çështje tjetër.

2. Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave, në përmbushje të detyrave të tij ose të saj, merr parasysh si duhet riskun që shoqëron operacionet e përpunimit, duke marrë parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit.

Seksioni 5

Kodet e sjelljes dhe certifikimi

Neni 40

Kodet e sjelljes

1. Shtetet Anëtare, autoritetet mbikëqyrëse, Bordi dhe Komisioni inkurajojnë përpilimin e kodeve të sjelljes që janë të destinuar të kontribuojnë në zbatimin e duhur të kësaj Rregulloreje, duke marrë parasysh tiparet specifike të sektorëve të ndryshëm të përpunimit dhe nevojat specifike të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

2. Shoqatat dhe organet e tjera që përfaqësojnë kategoritë e kontrolluesve ose përpunuesve mund të përgatisin kode të sjelljes, ose të ndryshojnë ose zgjerojnë këto kode, për qëllimin e specifikimit të zbatimit të kësaj Rregulloreje, si në lidhje me:

(a) përpunimin e drejtë dhe transparent;

(b) interesat legjitime të ndjekura nga përpunuesit në kontekste specifike;

(c) mbledhjen e të dhënave personale;

(d) anonimizimin e të dhënave personale;

(e) informacionin e dhënë publikut dhe subjekteve të të dhënave;

(f) ushtrimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave;

(g) informacionin e dhënë fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre dhe mënyrën në të cilën merret pëlqimi i zotëruesve të përgjegjësishë prindërore për fëmijët;

(h) masat dhe procedurat e referuara në nenet 24 dhe 25 dhe masat për të garantuar sigurinë e përpunimit të referuar në nenin 32;

(i) njoftimin e shkeljeve të të dhënave personale autoriteteve dhe komunikimi i këtyre shkeljeve të të dhënave personale subjekteve të të dhënave;

(j) transferimin e të dhënave personale tek vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare; ose

(k) procedurat jashtë-gjyqësore dhe procedurat e tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet kontrolluesve dhe subjekteve të të dhënave në lidhje me përpunimin, pa cenuar të drejtat e subjekteve

të dhënave në pajtim me Nenet 77 dhe 79.

3. Përveç respektimit nga kontrolluesit ose përpunuesit që i nënshtrohen kësaj Rregulloreje, kodet e sjelljes të aprovuar në pajtim me paragrafin 5 të këtij Neni dhe që kanë një vlefshmëri të përgjithshme në pajtim me paragrafin 9 të këtij Neni mund të respektohen nga kontrolluesit ose përpunuesit që nuk i nënshtrohen kësaj Rregulloreje në pajtim me Nenin 3 me qëllim që të ofrojnë garanci të përshtatshme brenda kuadrit të transferimeve të të dhënave personale tek vendet e tretë ose organizatat ndërkombëtare sipas termave të referuara në pikën (e) të Nenit 46(2). Këta kontrollues ose përpunues marrin angazhime detyruese dhe të ekzekutueshme, nëpërmjet instrumenteve detyrues kontraktualë ose ligjorë të tjerë për të zbatuar ato garanci të përshtatshme duke përfshirë në lidhje me të drejtat e subjektet e të dhënave.

4. Një kod sjelljeje i referuar në paragrafin 2 të këtij Neni përmban mekanizmat që i mundësojnë organit të përmendur në Nenin 41(1) për të kryer monitorimin e detyrueshëm të përputhshmërisë së dispozitat e tij nga kontrolluesit ose përpunuesit që ndërmarrin ta zbatojnë atë, pa cenuar detyrat dhe kompetencat e autoriteteve mbikëqyrëse kompetente në pajtim me Nenet 55 dhe 56.

5. Shoqatat ose organet e tjera të referuara në paragrafin 2 të këtij Neni që synojnë të përgatisin një kod sjelljeje ose të ndryshojnë apo zgjerojnë një kod ekzistues paraqesin një projekt-kod, ndryshim ose zgjerim tek autoriteti mbikëqyrës që është kompetent në pajtim me Nenin 55. Autoriteti mbikëqyrës paraqet një opinion nëse projekt kodi, ndryshimi ose zgjerimi përputhet me këtë Rregullore dhe aprovon projekt kodin, ndryshimin ose zgjerimin nëse konstaton që ai ofron garanci të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

6. Nëse projekt kodi, ndryshimi ose zgjerimi aprovohet në pajtim me paragrafin 5 dhe nëse kodi përkatës i sjelljes nuk lidhet me aktivitetet përpunuese në disa Shtete Anëtare, autoriteti mbikëqyrës regjistron dhe publikon kodin.

7. Nëse projekt kodi i sjelljes ka të bëjë me aktivitete përpunuese në disa Shtete Anëtare, autoriteti mbikëqyrës që është kompetent në pajtim me Nenin 55, para aprovimit të projekt kodit, ndryshimit ose zgjerimit, e paraqet atë në procedurën e referuar në Nenin 63 tek Bordi që mund të japë një opinion nëse projekt kodi, ndryshimi ose zgjerimi përputhet me këtë Rregullore ose, në situatën e referuar në paragrafin 3 të këtij Neni, parashikon garanci të përshtatshme.

8. Nëse opinioni i referuar në paragrafin 7 konfirmon që projekt kodi, ndryshimi ose zgjerimi përputhet me këtë Rregullore, ose, në situatën e referuar në paragrafin 3, parashikon garanci të përshtatshme, Bordi paraqet opinionin e tij tek Komisioni.

9. Komisioni, nëpërmjet akteve zbatuese, mund të vendosë që kodi i sjelljes, ndryshimi ose zgjerimi i miratuar i paraqitur atij në pajtim me paragrafin 8 të këtij Neni të ketë vlefshmëri të përgjithshme brenda Bashkimit. Këto akte zbatuese miratohen në pajtim me procedurën e shqyrtimit të parashikuar në Nenin 93(2).

10. Komisioni garanton publikimin e duhur të kodeve të aprovuar që janë deklaruar sikur kanë vlefshmëri të përgjithshme në pajtim me paragrafin 9.

11. Bordi i përfshin të gjithë kodet e sjelljes, ndryshimet dhe zgjerimet e aprovuar në një regjistër dhe i bën ata të disponueshëm nga publiku nëpërmjet mjeteve të përshtatshme.

Neni 41

Monitorimi i kodeve të miratuar të sjelljes

1. Pa cenuar detyrat dhe kompetencat e autoritetit mbikëqyrës kompetent sipas neneve 57 dhe

58, monitorimi i përputhshmërisë me kodin e sjelljes në pajtim me Nenin 40 mund të kryhet nga një organ i cili ka një nivel të përshtatshëm të ekspertizës në lidhje me objektin e kodit dhe akreditohet për këtë qëllim nga autoriteti mbikëqyrës kompetent.

2. një organ i referuar në paragrafin 1 mund të akreditohet për të monitoruar përputhshmërinë me një kod sjelljeje nëse ai organ ka:

(a) demonstruar pavarësinë dhe ekspertizën e tij në lidhje me objektin e kodit duke bindur autoritetin mbikëqyrës kompetent;

(b) caktuar procedura që i mundësojnë vlerësimin e përshtatshmërisë të kontrolluesve dhe përpunuesve të interesuar për të zbatuar kodin, monitorimin e përputhshmërisë prej tyre me dispozitat e tij dhe rishikimin periodik të operacioneve të veta;

(c) caktuar procedura dhe struktura për të trajtuar ankimet në lidhje me shkeljet e kodit ose mënyrën në të cilin kodi është zbatuar, ose po zbatohet nga një kontrollues ose përpunues dhe për të bërë ato procedura dhe struktura transparente për subjektet e të dhënave dhe publikun; dhe

(d) demonstruar duke bindur autoritetin kompetent mbikëqyrës që detyrat e tij nuk rezultojnë në konflikt interesash.

3. Autoriteti mbikëqyrës kompetent ia paraqet projekt kriteret për akreditimin e një organi të referuar në paragrafin 1 të këtij Neni Bordit në pajtim me mekanizmin e përputhshmërisë të referuar në Nenin 63.

4. Pa cenuar detyrat dhe kompetencat e autoritetit mbikëqyrës kompetent dhe dispozitat e Kapitullit VIII, një organ i referuar në paragrafin 1 të këtij Neni, në pajtim me garancitë e përshtatshme, merr masat e përshtatshme në rastet e shkeljeve të kodit nga një kontrollues ose përpunues, duke përfshirë pezullimin ose përjashtimin e kontrolluesit ose përpunuesit përkatës nga kodi. Ai njofton autoritetin mbikëqyrës kompetent në lidhje me këto masa dhe shkaqet për marrjen e tyre.

5. Autoriteti mbikëqyrës kompetent revokon akreditimin e një organi të referuar në paragrafin 1 nëse kushtet për akreditim nuk janë ose nuk vazhdojnë të përmbushen ose nëse masat e marra nga organi e shkelin këtë Rregullore.

6. Ky Nen nuk zbatohet për përpunimin e kryer nga autoritetet dhe organet publike.

Neni 42

Certifikimi

1. Shtetet Anëtare, autoritetet mbikëqyrëse dhe Komisioni inkurajojnë, veçanërisht në nivelin e Bashkimit, ngritjen e mekanizmave të certifikimit të mbrojtjes së të dhënave dhe të vulave dhe shenjave të mbrojtjes së të dhënave, me qëllim demonstrimin e përputhshmërisë me këtë Rregullore të operacioneve të përpunimit nga kontrolluesit dhe përpunuesit. Nevojat specifike të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme merren parasysh.

2. Përveç respektimit nga kontrolluesit ose përpunuesit që i nënshtrohen kësaj Rregulloreje, mekanizmat e certifikimit të mbrojtjes së të dhënave, vulat dhe shenjat e aprovuar në pajtim me paragrafin 5 të këtij Neni mund të vendosen me qëllim demonstrimin e ekzistencës së garancive të përshtatshme në pajtim me Nenin 3 brenda kuadrit të transferimeve të të dhënave personale tek vendet e tretë ose organizatat ndërkombëtare sipas termave të referuara në pikën (f) të Nenit 46(2). Këta kontrollues ose përpunues marrin angazhime detyruese dhe të ekzekutueshme, nëpërmjet instrumenteve detyrues kontraktualë ose ligjorë të tjerë për të zbatuar ato garanci të përshtatshme duke përfshirë në lidhje me të drejtat e subjekteve të të dhënave.

3. Certifikimi është vullnetar dhe i disponueshëm nëpërmjet një procesi që është transparent.
4. Një certifikim në pajtim me këtë Nen nuk e kufizon përgjegjësinë e kontrolluesit ose të përpunuesit për përputhshmërinë me këtë Rregullore dhe nuk i cenon detyrat dhe kompetencat e autoriteteve mbikëqyrëse që janë kompetentë në pajtim me Nenet 55 dhe 56.
5. Një certifikim në pajtim me këtë Nen lëshohet nga organet e certifikimit të referuar në Nenin 43 ose nga autoriteti mbikëqyrës kompetent, në bazë të kriterëve të aprovuar nga ai autoritet kompetent mbikëqyrës në pajtim me Nenin 58(3) ose nga Bordi në pajtim me Nenin 63. Nëse kriteret aprovohen nga Bordi, kjo mund të rezultojë në një certifikim të përbashkët, Vula Evropiane e Mbrojtjes së të Dhënave.
6. Kontrolluesi ose përpunuesi i cili i paraqet përpunimin e tij mekanizmit të certifikimit i jep organit të certifikimit të referuar në Nenin 43 ose, sipas rastit, autoritetit mbikëqyrës kompetent, të gjithë informacionin dhe aksesin tek aktivitetet e tij përpunuese të cilat janë të nevojshme për të zhvilluar procedurën e certifikimit.
7. Certifikimi i lëshohet një kontrolluesi ose përpunuesi brenda një afati maksimal prej tre vjetësh dhe mund të rinovohet, sipas të njëjtave kushte, me kusht që të vazhdojnë të përmbushen kërkesat përkatëse. Certifikimi tërhiqet, sipas rastit, nga organet e certifikimit të referuar në Nenin 43 ose nga autoriteti mbikëqyrës kompetent nëse nuk vazhdojnë të përmbushen kërkesat për certifikimin.
8. Bordi i përfshin të gjithë mekanizmat e certifikimit dhe vulat e mbrojtjes së të dhënave dhe shenjat në një regjistër dhe i bën ata të disponueshëm nga publiku nëpërmjet mjeteve të përshtatshme.

Neni 43

Organet e certifikimit

1. Pa cenuar detyrat dhe kompetencat e autoritetit mbikëqyrës kompetent sipas Neneve 57 dhe 58, organet e certifikimit që kanë një nivel të përshtatshëm të ekspertizës në lidhje me mbrojtjen e të dhënave, pas informimit të autoritetit mbikëqyrës për të lejuar ushtrimin e kompetencave në pajtim me Nenin 58(2), sipas rastit, lëshojnë dhe rinovojnë certifikimin. Shtetet Anëtare garantojnë që këto organe certifikimi të akreditohen nga një ose të dy sa më poshtë:
 - (a) Autoriteti mbikëqyrës që është kompetent në pajtim me Nenin 55 ose 56;
 - (b) Organi kombëtar i akreditimit i emërtuar në pajtim me Rregulloren (KE) Nr 765/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (1) në pajtim me EN-ISO/IEC 17065/2012 dhe me kërkesat shtesë të përcaktuara nga autoriteti mbikëqyrës që është kompetent në pajtim me Nenin 55 ose 56.
2. Organet e certifikimit të referuara në paragrafin 1 akreditohen në pajtim me atë paragraf vetëm nëse to kanë:
 - (a) demonstruar pavarësinë dhe ekspertizën e tij në lidhje me objektin e Certifikimit duke bindur autoritetin mbikëqyrës kompetent;
 - (b) Marrë përsipër të respektojnë kriteret e përmendura në Nenin 42(5) dhe të aprovuar nga autoriteti mbikëqyrës që është kompetent në pajtim me Nenin 55 dhe 56 ose nga Bordi në pajtim me Nenin 63;
 - (c) Vendosur procedurat për lëshimin, rishikimin periodik dhe tërheqjen e certifikimit, vulave dhe shenjave të mbrojtjes së të dhënave;
 - (d) caktuar procedura dhe struktura për të trajtuar ankimet në lidhje me shkeljet e certifikimit ose mënyrën në të cilin certifikimi është zbatuar, ose po zbatohet nga një kontrollues ose përpunues dhe për ti bërë ato procedura dhe struktura transparente për subjektet e të dhënave dhe publikun; dhe
 - (e) demonstruar duke bindur autoritetin kompetent mbikëqyrës që detyrat e tij nuk rezultojnë në

konflikt interesash.

3. Akreditimi i organeve të certifikimit të përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij Neni kryhet mbi bazën e kriterëve të aprovuara nga organi mbikëqyrës që është kompetent në pajtim me Nenin 55 ose 56 ose nga Bordi në pajtim me Nenin 63. Në rastin e akreditimit në pajtim me pikën (b) të paragrafit 1 të këtij Neni, këto kërkesa plotësojnë ato të parashikuara në Rregulloren Nr. 765/2008 dhe rregullat teknike që përshkruajnë metodat dhe procedurat për organet e certifikimit.

4. Organet e certifikimit të përmendura në paragrafin 1 janë përgjegjëse për vlerësimin e duhur që çon në certifikimin ose tërheqjen e këtij certifikimi pa cenuar përgjegjësinë e kontrolluesit ose përpunuesit për respektimin e kësaj Rregulloreje. Akreditimi lëshohet për një afat maksimal prej pesë vjetësh dhe mund të rinovohet sipas të njëjtave kushteve, me kusht që organi i certifikimit të përmbushë kërkesat e parashikuara në këtë Nen.

5. Organet e certifikimit të përmendura në paragrafin 1 i paraqesin autoritetit mbikëqyrës kompetent shkaqet për dhënien ose tërheqjen e certifikimit të kërkuar.

6. Kërkesat e referuar në paragrafin 3 të këtij Neni dhe kriteret e referuara në Nenin 42(5) bëhen publike nga autoriteti mbikëqyrës në një format lehtësisht të aksesueshëm. Autoritetet mbikëqyrëse ia transmetojnë këto kërkesa dhe kriteret edhe Bordit. Bordi i përfshin të gjithë mekanizmat e certifikimit dhe vultat e mbrojtjes së të dhënave në një regjistër dhe i bën ata të disponueshëm nga publiku nëpërmjet mjeteve të përshtatshme.

7. Pa cenuar Kapitullin VIII, autoriteti mbikëqyrës kompetent ose organi kombëtar i akreditimit e revokon një akreditim të një organi certifikimi në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni nëse kushtet e akreditimit nuk përmbushen ose nuk vazhdojnë të përmbushen ose nëse masat e marra nga një organ certifikimi e shkelin këtë Rregullore.

8. Komisioni është i autorizuar të miratojë aktet e deleguara në pajtim me Nenin 92 për qëllimin e përcaktimit të kërkesave për tu marrë parasysh për mekanizmat e mbrojtjes së të dhënave të referuara në Nenin 42(1).

9. Komisioni mund të miratojë akte zbatuese duke përcaktuar standardet teknike për mekanizmat e certifikimit dhe vultat dhe shenjat e mbrojtjes së të dhënave dhe mekanizmat për të nxitur dhe njohur ato mekanizma, vula dhe shenja certifikimi. Këto akte zbatuese miratohen në pajtim me procedurën e shqyrtimit të referuar në Nenin 93(2).

KAPITULLI V

Transferimet e të dhënave personale tek vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare

Neni 44

Parime të përgjithshme për transferimet

Çdo transferim i të dhënave personale që po i nënshtrohen përpunimit ose janë destinuar për përpunim pas transferimi në një vend të tretë ose në një organizatë ndërkombëtare zhvillohet vetëm nëse, në pajtim me dispozitat e tjera të kësaj Rregulloreje, kushtet e përcaktuara në këtë Kapitull përmbushen nga kontrolluesi dhe përpunuesi, duke përfshirë transferimet e mëtejshme të të dhënave personale nga vendi i tretë ose një organizatë ndërkombëtare në një vend tjetër të tretë ose një

organizatë tjetër ndërkombëtare. Të gjitha dispozitat e këtij Kapitulli zbatohen me qëllim që të garantohet mos-dëmtimi i nivelit të mbrojtjes së personave fizikë të garantuar nga kjo Rregullore.

Neni 45

Transferimet mbi bazën e një vendimi përshtatshmërie

1. Një transferim i të dhënave personale në një vend të tretë ose një organizatë ndërkombëtare mund të kryhet nëse Komisioni ka vendosur që vendi i tretë, një territor ose një ose disa sektorë të specifikuar brenda vendit të tretë ose organizata ndërkombëtare në fjalë garanton një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje. Një transferim i tillë nuk kërkon ndonjë autorizim specifik.

2. Gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë së nivelit të mbrojtjes, Komisioni, veçanërisht, merr parasysh elementët e mëposhtëm:

(a) shtetin ligjor, respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, legjislacionin përkatës, të përgjithshëm dhe sektorial duke përfshirë atë në lidhje me sigurinë publike, mbrojtjen, sigurinë kombëtare, të drejtën penale dhe aksesin e autoriteteve publike tek të dhënat personale, si dhe zbatimin e këtij legjislacioni, rregullat për mbrojtjen e të dhënave, rregullat profesionale dhe masat e sigurisë, duke përfshirë rregullat për transferimin e mëtejshëm të të dhënave personale tek një vend i tretë ose organizatë ndërkombëtare që respektohen në atë vend ose organizatë ndërkombëtare, praktikën gjyqësore, si dhe të drejtat efektive dhe të ekzekutueshme të subjekteve të të dhënave dhe mjetet e mbrojtjes efektive administrative dhe gjyqësore për subjektet e të dhënave, të dhënat personale të të cilëve transferohen;

(b) ekzistencën dhe funksionimin efektiv të një ose më shumë autoriteteve mbikëqyrëse të pavarura në një vend të tretë ose të cili i nënshtrohet një organizate ndërkombëtare, me përgjegjësi për të garantuar dhe ekzekutuar respektimin e rregullave të mbrojtjes së të dhënave, duke përfshirë kompetenca të përshtatshme ekzekutimi, për të asistuar dhe ndihmuar subjektet e të dhënave në ushtrimin e të drejtave të tyre dhe për bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse të Shteteve Anëtare dhe

(c) angazhimet ndërkombëtare që ka marrë përsipër vendi i tretë ose organizata ndërkombëtare, ose detyrime të tjera që rrjedhin nga konventat ose instrumentet ligjërisht detyruese, si dhe nga pjesëmarrja e tij në sisteme shumëpalëshe ose rajonale, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Komisioni, pas vlerësimit të përshtatshmërisë së nivelit të mbrojtjes, mund të vendosin, nëpërmjet aktit zbatues, që një vend i tretë, një territor ose një ose më shumë sektorë të specifikuar brenda një territori ose një organizatë ndërkombëtare garanton një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje brenda kuptimit të paragrafit 2 të këtij Neni. Akti i zbatimit parashikon një mekanizëm të rishikimit periodik, të paktën një herë në katër vjet, që merr parasysh të gjitha zhvillimet përkatëse në vendin e tretë ose organizatën ndërkombëtare. Akti zbatues specifikon zbatimin e tij territorial dhe sektorial dhe, sipas rastit, identifikon autoritetin mbikëqyrës ose autoritetet e referuar në pikën (b) të paragrafit 2 të këtij Neni. Akti standard miratohet nga Komisioni në pajtim me procedurën e shqyrtimit të përmendur në Nenin 93(2);

4. Komisioni, në vazhdimësi, monitoron zhvillimet në vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare që mund të ndikojnë funksionimin e vendimeve të miratuara në pajtim me paragrafin 3 të këtij Neni dhe vendimet e miratuara në bazë të nenit 25(6) të Direktivës 95/46/KE.

5. Komisioni, nëse vihet në dukje nga informacioni i ofruar, veçanërisht pas rishikimit të

referuar në paragrafin 3 të këtij Neni, që një vend i tretë, një territor ose një ose disa sektorë të specifikuar të një vendi të tretë ose një organizatë ndërkombëtare nuk vazhdon të garantojë një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje brenda kuptimit të paragrafit 2 të këtij Neni, në masën e nevojshme, anulojnë, ndryshojnë ose pezullojnë vendimin e referuar në paragrafin 3 të këtij neni nëpërmjet akteve të zbatimit pa efekt prapaveprues. Këto akte zbatuese miratohen në pajtim me procedurën shqyrtimit të referuar në Nenin 93(2).

Për shkaqe të urgjencës dhe të justifikuara rregullisht, Komisioni miraton menjëherë aktet zbatuese në pajtim me procedurën e referuar në Nenin 93(3).

6. Komisioni hyn në bisedime me vendin e tretë ose organizatën ndërkombëtare me synim korigjimin e situatës që shkakton vendimin e marrë në pajtim me paragrafin 5.

7. Një vendim në pajtim me paragrafin 5 të këtij Neni nuk cenon transferimet e të dhënave personale tek vendi i tretë, një territor ose një apo disa sektorë të specifikuar brenda atij vendi të tretë ose organizatë ndërkombëtare në fjalë në pajtim me Nenin 46 deri 49.

8. Komisioni publikon në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe në faqen e internetit një listë të vendeve të treta, territoreve dhe sektorëve të specifikuar brenda një vendi të tretë dhe organizatave ndërkombëtare për të cilat ai ka vendosur një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje ose nuk vazhdon të garantohet.

9. Vendimet e miratuara nga Komisioni mbi bazën e Nenit 25(5) të Direktivës 95/46/BE mbeten në fuqi deri sa të ndryshohen, zëvendësohen ose anulohen nga një Vendim i Komisionit të miratuar në pajtim me paragrafin 3 ose 5 të këtij Neni.

Neni 46

Transferimet që u nënshtrohen garancive të përshtatshme

1. Në mungesë të një vendimi në pajtim me Nenin 45(3), një kontrollues ose përpunues mund të transferojë të dhëna personale në një vend të tretë ose organizatë ndërkombëtare vetëm nëse kontrolluesi ose përpunuesi ka dhënë garancitë e përshtatshme dhe me kusht që të ekzistojnë të drejtat e realizueshme të subjektit të të dhënave dhe mjeteve ligjore të efektshme për subjektet e të dhënave.

2. Garancitë e përshtatshme të përmendura në paragrafin 1 mund të parashikohen, pa kërkuar autorizim specifik nga një autoritet mbikëqyrës, nëpërmjet:

(a) Një instrumenti ligjërish detyruës dhe të ekzekutueshëm ndërmjet autoriteteve ose organeve publike;

(b) Rregullave të brendshme detyruese në pajtim me Nenin 47;

(c) Klauzolave standarde për mbrojtjen e të dhënave të miratuara nga Komisioni në pajtim me procedurën e shqyrtimit të përmendur në Nenin 93(2);

(d) Klauzolave standarde për mbrojtjen e të dhënave nga një autoritet mbikëqyrës dhe të aprovuar nga Komisioni në pajtim me procedurën e shqyrtimit të përmendur në Nenin 93(2);

(e) Një kodi të aprovuar sjelljeje në pajtim me Nenin 40 së bashku me angazhimet detyruese dhe të zbatueshme të kontrolluesit dhe përpunuesit në vendin e tretë për të zbatuar garancitë e përshtatshme, duke përfshirë ato në lidhje me të drejtat e subjekteve të të dhënave; ose

(f) Një mekanizmi të aprovuar certifikimi në pajtim me Nenin 42 së bashku me angazhimet

detyruese dhe të zbatueshme të kontrolluesit dhe përpunuesit në vendin e tretë për të zbatuar garancitë e përshtatshme, duke përfshirë ato në lidhje me të drejtat e subjekteve të të dhënave.

3. Në pajtim me autorizimin nga autoriteti mbikëqyrës kompetent, garancitë e përshtatshme të përmendura në paragrafin 1 mund të jepen veçanërisht, nëpërmjet:

(a) Klauzolare kontraktuale ndërmjet kontrolluesit ose përpunuesit dhe kontrolluesit, përpunuesit ose marrësit të të dhënave personale në vendin e tretë ose organizatës ndërkombëtare; ose

(b) Dispozitave të përfshira në masat administrative ndërmjet autoriteteve publike ose organeve që përfshijnë të drejtat e zbatueshme dhe efektive të subjekteve të të dhënave.

4. Autoriteti mbikëqyrës zbaton mekanizmin e njëtrajtshmërisë të përmendur në Nenin 63 në rastet e përmendura në paragrafin 3 të këtij Neni.

5. Autorizimet nga një Shtet Anëtar ose autoritet mbikëqyrës në bazë të Nenit 26(2) të Direktivës 95/46/BE mbeten të vlefshme deri sa të ndryshohen, zëvendësohen ose anulohen, sipas rastit, nga ai autoritet mbikëqyrës. Vendimet e miratuara nga Komisioni mbi bazën e Nenit 26(2) të Direktivës 95/46/BE mbeten në fuqi deri sa të ndryshohen, zëvendësohen ose anulohen, sipas rastit, nga një Vendim i Komisionit të miratuar në pajtim me paragrafin 2 të këtij Neni.

Neni 47

Rregullat e brendshme detyruese

1. Autoriteti mbikëqyrës kompetent aprovon rregullat detyruese të brendshme në pajtim me mekanizmin e njëtrajtshmërisë të përcaktuar në nenin 63, me kusht që ato:

(a) të jenë ligjrisht detyruese dhe të zbatohen nga çdo anëtar i interesuar i grupit të ndërmarrjeve ose grupit të ndërmarrjeve të angazhuara në një aktivitet të përbashkët ekonomik, duke përfshirë punonjësit e tyre;

(b) u caktojnë shprehimisht subjekteve të të dhënave të drejta të ekzekutueshme në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale; dhe

(c) të përmbushin kërkesat e parashikuar në paragrafin 2.

2. Rregullat detyruese të brendshme të referuara në paragrafin 1 specifikojnë të paktën:

(a) strukturën dhe hollësitë e kontaktit të grupit të ndërmarrjeve ose grupit të ndërmarrjeve të angazhuar në një aktivitet ekonomik të përbashkët dhe secilit prej anëtarëve të tij;

(b) transferimet e të dhënave ose kompletet e transferimeve, duke përfshirë kategoritë e të dhënave personale, tipin e përpunimit dhe qëllimeve të tij, tipin e subjekteve të të dhënave të prekur dhe identifikimin e vendit ose vendeve të treta në fjalë;

(c) natyrën e tyre ligjore detyruese, me efekt të brendshëm dhe të jashtëm;

(d) zbatimin e parimeve të përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave, veçanërisht kufizimin e qëllimit, minimizimin e të dhënave, afatet e kufizuara të ruajtjes, cilësinë e të dhënave, mbrojtjen e të dhënave në mënyrë konkrete dhe abstrakte, bazën ligjore për përpunimin, përpunimin e kategorive të veçanta të të dhënave personale, masat për të garantuar sigurinë e të dhënave dhe kërkesat në lidhje me transferimet e mëtejshme tek organet që nuk u nënshtrohen rregullave detyruese të brendshme;

(e) të drejtat e subjekteve të të dhënave në lidhje me përpunimin dhe mjetet për të ushtruar ato të drejta, duke përfshirë të drejtën për të mos iu nënshtrohet vendimeve të bazuar vetëm në përpunim automatik, duke përfshirë profilizimin në pajtim me Nenin 22, të drejtën për të paraqitur një ankim

tek autoriteti kompetent mbikëqyrës dhe para gjykatave kompetente të Shteteve Anëtare në pajtim me Nenin 79 dhe të përftohet rikuperim dhe sipas rastit, kompensim për një shkelje të rregullave detyruese të brendshme;

(f) pranimin nga kontrolluesi ose përpunuesi i vendosur në territorin e një Shteti Anëtar që është përgjegjës për çdo shkelje të rregullave të brendshme detyruese nga një anëtar i interesuar që nuk është i vendosur në Bashkim; kontrolluesi ose përpunuesi përjashtohet nga kjo përgjegjësi, pjesërisht ose plotësisht, vetëm nëse provon që ai anëtar nuk është përgjegjës për ngjarjen që ka shkaktuar dëmin;

(g) si jepet informacioni për rregullat e brendshme detyruese, veçanërisht për dispozitat e referuara në pikat (d), (e) dhe (f) të këtij paragrafi për subjektet e të dhënave përveç Neneve 13 dhe 14;

(h) Detyrat e çdo nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave të caktuar në pajtim me nenin 37 ose çdo person tjetër ose subjekt i ngarkuar për përputhjen e monitorimit me rregullat e brendshme detyruese brenda grupit të ndërmarrjeve ose grupit të ndërmarrjeve të angazhuara në një aktivitet të përbashkët ekonomik, si dhe trajnimin mbi monitorimin dhe trajtimin e ankesave.

(i) procedurat e ankimit;

(j) mekanizmat brenda grupit të ndërmarrjeve, ose grupit të ndërmarrjeve të angazhuara në një aktivitet ekonomik të përbashkët për të garantuar verifikimin e përputhshmërisë me rregullat e brendshme detyruese. Këto mekanizma përfshijnë auditimet për mbrojtjen e të dhënave dhe metodat për të garantuar masat korrigjuese për të mbrojtur të drejtat e subjektit të të dhënave. Rezultatet e këtij verifikimi duhet ti komunikohen personit ose subjektit të referuar në pikën (h) dhe bordit që kontrollon ndërmarrjen ose grupin e ndërmarrjeve ose grupin e ndërmarrjeve të angazhuara në një aktivitet ekonomik, dhe duhet të jenë të disponueshme me kërkesë të autoritetit kompetent mbikëqyrës;

(k) mekanizmat e raportimit dhe regjistrimit të ndryshimeve në rregullat dhe raportimin e këtyre ndryshimeve tek autoriteti mbikëqyrës;

(l) mekanizmi i bashkëpunimit me autoritetin mbikëqyrës për të garantuar respektimin nga çdo anëtar i grupit të ndërmarrjeve ose grupit të ndërmarrjeve të angazhuara në një aktivitet ekonomik të përbashkët, veçanërisht duke i ofruar autoritetit mbikëqyrës rezultatet e verifikimeve të masave të referuara në pikën (j);

(m) mekanizmat e raportimit tek autoriteti mbikëqyrës kompetent të çdo kërkesë ligjore të cilës i nënshtrohet një anëtar i grupit të ndërmarrjeve ose grupi ndërmarrjeve të angazhuara në një aktivitet të përbashkët ekonomik në një vend të tretë që mund të kenë një efekt të konsiderueshëm negativ për garancitë e dhëna nga rregullat detyruese të brendshme; dhe

(n) trajnimin e përshtatshëm për mbrojtjen e të dhënave personale për personelin që ka akses të përhershëm ose të rregullt tek të dhënat personale.

3. Komisioni mund të specifikojë formatin dhe procedurat për shkëmbimin e informacionit ndërmjet kontrolluesve, përpunuesve dhe autoriteteve mbikëqyrëse për rregullat e brendshme detyruese brenda kuptimit të këtij Neni. Këto akte zbatuese miratohen në pajtim me procedurën e shqyrtimit të përcaktuar në Nenin 93(2).

Çdo vendim gjykatë ose tribunali dhe çdo vendim i një autoriteti administrativ i një vendi të tretë që i kërkon një kontrolluesi ose përpunuesi të transferojë ose deklarojë të dhënat personale mund të njihet ose të jetë i ekzekutueshëm në çdo mënyrë nëse bazohet në një marrëveshje ndërkombëtare, si një traktat i ndihmës së ndërsjellë juridike, në fuqi ndërmjet vendit të tretë kërkues të Bashkimit ose një Shteti Anëtar, pa cenuar shkaqet e tjera të transferimit sipas këtij Kapitulli.

Neni 49

Shmangiet për shkak të situatave specifike

1. Në mungesë të një vendimi përshtatshmërie në pajtim me Nenin 45(3), ose të garancive të përshtatshme sipas nenit 46, duke përfshirë rregullat e brendshme detyruese, një transferim ose një komplet transferimesh i të dhënave personale tek një vend i tretë ose organizatë ndërkombëtare kryhet vetëm më një nga kushtet e mëposhtme:

(a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin shprehimisht për transferimin e propozuar, pas informimit në lidhje me risqet e mundshme të këtyre transferimeve për subjektet e të dhënave për shkak të mungesës së një vendimi të përshtatshmërisë ose garancive të përshtatshme;

(b) transferimi është i nevojshëm për përmbushjen e një kontrate ndërmjet subjektit të të dhënave dhe kontrolluesit ose zbatimin e masave para-kontraktuale të marra me kërkesë të subjektit të të dhënave;

(c) transferimi është i nevojshëm për përfundimin ose përmbushjen e një kontrate të përfunduar në interes të subjektit të të dhënave ndërmjet kontrolluesit dhe një personi tjetër fizik ose juridik;

(d) transferimi është i nevojshëm për shkaqe të rëndësishme të interesit publik;

(e) transferimi është i nevojshëm për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore;

(f) transferimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetike për subjektin e të dhënave ose të personave të tjerë, nëse subjekti i të dhënave është fizikisht ose ligjërisht i pazotë për të dhënë pëlqimin;

(g) transferimi bëhet nga një regjistër që sipas së drejtës së Bashkimit ose të Shtetit Anëtar synon të japë informacion për publikun dhe që është i hapur për tu konsultuar nga publiku i gjerë ose nga çdo person që mund të demonstrojë një interes legjitim, por vetëm në masën që të përmbushen kushtet e parashikuara nga e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar për konsultimet në rastin e veçantë.

Nëse një transferim nuk mund të bazohet në një dispozitë në Nenin 45 ose 46, duke përfshirë dispozitat për rregullat e brendshme detyruese, dhe asnjë nga shmangiet për shkak të situatave specifike të referuara në nën-paragrafin e parë të këtij paragrafi nuk mund të zbatohen, një transferim në një vend të tretë ose një organizatë ndërkombëtare mund të kryhet vetëm nëse transferimi nuk është e përsëritur, ka të bëjë vetëm me një numër të kufizuar të subjekteve të të dhënave, është e nevojshme për qëllimet e interesave detyrues ligjorë që ndiqet nga kontrolluesi që nuk tejkalohen nga interesat ose të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave dhe kontrolluesi ka vlerësuar të gjitha të rrethanat që kanë të bëjnë me transferimin e të dhënave dhe mbi bazën e këtij vlerësimi ka dhënë garanci të përshtatshme në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Kontrolluesi njofton për transferimin autoritetin mbikëqyrës. Kontrolluesi, përveç dhënies së informacionit të referuar në Nenet 13 dhe 14, njofton subjektin e të dhënave për transferimin dhe për interesat detyrues legjitimë

të ndjekur.

2. Një transferim në pajtim me pikën (g) të nën-paragrafit të parë të paragrafit 1 nuk përfshin tërësinë e të dhënave personale ose të gjitha kategoritë e të dhënave personale që gjenden në regjistrë. Nëse regjistri është i destinuar të konsultohet nga personat që kanë një interes të ligjshëm, transferimi bëhet vetëm me kërkesë të atyre personave ose nëse ata duhet të jenë marrësit.

3. Pikat (a), (b) dhe (c) të nën-paragrafit të parë të paragrafit 1 dhe nën-paragrafi dytë i tij nuk zbatohen për aktivitetet e kryera nga autoritetet publike në ushtrim të kompetencave të tyre publike.

4. Interesi publik i referuar në pikën (d) të nën-paragrafit të parë të paragrafit 1 njihet nga ligji i Bashkimit ose në ligjin e Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet kontrolluesi.

5. Në mungesë të një vendimi përshtatshmërie, e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar, për shkaqe të rëndësishme të interesit publik, cakton shprehimisht kufij për transferimin e kategorive të caktuara të të dhënave personale në një vend të tretë ose një organizatë ndërkombëtare. Shtetet Anëtare ia njoftojnë këto dispozita Komisionit.

6. Kontrolluesi ose përpunuesi dokumenton vlerësimin si dhe garancitë e përshtatshme të referuara në nën-paragrafin e dytë të paragrafit 1 të këtij Neni në regjistrat e referuara në Nenin 30.

Neni 50

Bashkëpunimi ndërkombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale

Në lidhje me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, Komisioni dhe autoritetet mbikëqyrës marrin hapat e duhur për të:

(a) zhvilluar mekanizma të bashkëpunimit ndërkombëtar për të lehtësuar ekzekutimin e efektshëm të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale;

(b) dhënë ndihmë të ndërsjellë ndërkombëtare në zbatimin e legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë nëpërmjet njoftimit, referimit të ankesës, asistencës në hetim dhe shkëmbimin e informacionit, duke iu nënshtuar garancive të përshtatshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtave dhe lirive të tjera themelore;

(c) angazhuar aktorët përkatës në diskutime dhe aktivitete që synojnë bashkëpunim të mëtejshëm ndërkombëtar në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale;

(d) nxitur shkëmbimin dhe dokumentimin e legjislacionit dhe praktikës për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë konfliktet juridikionale me vendet e treta.

KAPITULLI VI

Autoritetet mbikëqyrës të pavarur

Seksioni 1

Statusi i pavarur

Neni 51

Autoriteti mbikëqyrës

1. Secili Shtet Anëtar parashikon që një ose më shumë autoritete publike të pavarura janë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kësaj Rregulloreje, me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë në lidhje me përpunimin dhe të lehtësohet fluksi i lirë i të dhënave personale brenda Bashkimit ('autoriteti mbikëqyrës').
2. Secili autoritet mbikëqyrës kontribuon në zbatimin e njëtrajtshëm të kësaj Rregulloreje në të gjithë Bashkimin. Për këtë qëllim, autoritetet mbikëqyrëse bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe Komisionin në pajtim me Kapitullin VII.
3. Nëse në një shtet Anëtar ngrihet më shumë se një autoritet mbikëqyrës, ky Shtet Anëtar cakton autoritetin mbikëqyrës që duhet të përfaqësojë ato autoritete në Bord dhe përcakton mekanizmat për të garantuar respektimin nga autoritetet të rregullave në lidhje me mekanizmin e njëtrajtshmërisë, të referuara në Nenin 63.
4. Secili Shtet Anëtar i njofton Komisionit dispozitat e së drejtës së vet që ai i miraton në pajtim me Kapitullin 25 maj 2018 dhe pa vonesë, çdo ndryshim pasues që prek ato.

Neni 52

Pavarësia

1. Çdo autoritet mbikëqyrës vepron me pavarësi të plotë në përmbushjen e detyrave dhe ushtrimin e kompetencave në pajtim me këtë Rregullore.
2. Anëtari ose anëtarët e çdo autoriteti mbikëqyrës, në përmbushje të detyrave të tyre dhe ushtrim të kompetencave të tyre në pajtim me këtë Rregullore, mbetet i lirë nga ndikimi i jashtëm, i drejtpërdrejtë ose jo, dhe nuk kërkon dhe nuk merr udhëzime nga askush.
3. Anëtari ose anëtarët e çdo autoriteti mbikëqyrës distancohen nga çdo veprim që nuk është në pajtim me detyrat e tyre dhe, gjatë mandatit të tyre, nuk angazhohen në asnjë aktivitet që nuk përputhet me të, fitimprurës ose jo.
4. Secili Shtet Anëtar garanton që çdo autoriteti mbikëqyrës ti vihen në dispozicion burime njerëzore, teknike dhe financiare, mjedise dhe infrastruktura e nevojshme për përmbushjen e efektshme të detyrave të tij dhe ushtrimin e kompetencave, duke përfshirë ato që kryhen në kontekstin e ndihmës së ndërsjellë, bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në Bord.
5. Çdo Shtet Anëtar garanton që çdo autoritet mbikëqyrës të zgjedhë dhe të ketë personelin e tij që u nënshtrohet udhëzimeve ekskluzive të anëtarit ose anëtarëve të autoritetit mbikëqyrës përkatës.
6. Çdo Shtet Anëtar garanton që secili autoritet mbikëqyrës ti nënshtrohet kontrollit financiar që nuk prek pavarësinë e tij dhe që të ketë buxhet të pavarur, publik dhe vjetor, që mund të jetë pjesë e buxhetit të përgjithshëm të shtetit ose kombëtar.

Neni 53

Kushte të përgjithshme për anëtarët e autoritetit mbikëqyrës

1. Shtetet Anëtare parashikojnë që çdo anëtar i autoriteteve të tyre mbikëqyrës të caktohet me anë të një procedure transparente nga:
 - parlamenti i tyre;

- qeveria e tyre;
 - kreu i shtetit të tyre; ose
 - një organ i pavarur i ngarkuar me emërimin sipas së drejtës së Shtetit Anëtar.
2. Çdo anëtar ka kualifikimet, eksperiencën dhe aftësitë, veçanërisht në sferën e mbrojtjes së të drejtave personale, që kërkohen për të përmbushur detyrat dhe ushtruar kompetencat e tyre.
 3. Detyrat e një anëtari përfundojnë në rastin e skadimit të mandatit, dorëheqjes ose daljes së detyruar në pension, në pajtim me të drejtën e Shtetit Anëtar përkatës.
 4. Një anëtar pushohet vetëm në rastet e sjelljes së rëndë ose nëse anëtari nuk vazhdon të përmbushë kushtet e kërkuara për përmbushjen e detyrave.

Neni 54

Rregullat për ngritjen e autoritetit mbikëqyrës

1. Çdo Shtet Anëtar parashikon me ligj sa më poshtë:
 - (a) ngritjen e çdo autoriteti mbikëqyrës;
 - (b) kualifikimet dhe kushtet e përshtatshmërisë që kërkohen për tu emëruar anëtar i çdo autoriteti mbikëqyrës;
 - (c) rregullat dhe procedurat për emërimin e anëtarit ose anëtarëve të çdo autoriteti mbikëqyrës;
 - (d) kohëzgjatjen e mandatit të anëtarit ose anëtarëve të çdo autoriteti mbikëqyrës prej jo më pak se katër vjet, përveç emërimit të parë pas datës 24 maj 2016, pjesë e të cilit mund të jetë për një periudhë më të shkurtër nëse kjo është e nevojshme për të mbrojtur pavarësinë e autoritetit mbikëqyrës nëpërmjet procedurës së emërimit të shtyrë në kohë;
 - (e) nëse dhe nëse është rasti, për sa mandate është i përshtatshëm për riemërim anëtari ose anëtarët e secilit autoritet mbikëqyrës;
 - (f) kushtet që rregullojnë detyrimet e anëtarit ose anëtarëve dhe personelit të secilit autoritet mbikëqyrës, ndalimet e veprimeve, angazhimet dhe përfitimet që nuk janë në pajtim me të gjatë dhe pas mandatit dhe rregullat që rregullojnë ndërprerjen e punësimit.
2. Anëtari ose anëtarët dhe personeli secilit autoritet mbikëqyrës, në pajtim me të drejtën e Bashkimit ose Shteteve Anëtare, i nënshtrohen detyrimit të fshehtësisë profesionale gjatë dhe pas mandatit, në lidhje me çdo informacion konfidencial që ka ardhur në dijeni të tyre në vazhden e përmbushjes së detyrave dhe ushtrimit të kompetencave. Gjatë mandatit të tyre, detyrimi i fshehtësisë profesionale zbatohet veçanërisht në lidhje me raportimin nga personat fizikë mbi shkeljet e kësaj Rregulloreje.

Seksioni 2

Kompetenca, detyrat dhe tagrat

Neni 55

Kompetenca

1. Çdo autoritet mbikëqyrës është kompetent për kryerjen e detyrave të caktuara dhe ushtrimin e tagrave të dhëna atij në pajtim me këtë Rregullore në territorin e Shtetit të vet Anëtar.

2. Nëse përpunimi kryhet nga autoritetet publike ose subjekte private që veprojnë në bazë të pikës (c) ose (e) të Nenit 6(1), kompetent është autoriteti mbikëqyrës i Shtetit Anëtar përkatës. Në këto raste nuk zbatohet Neni 56.

3. Autoritetet mbikëqyrëse nuk kanë kompetencë të mbikëqyrin operacionet përpunuese të gjykatave që veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore.

Neni 56

Kompetenca e autoritetit mbikëqyrës epror

1. Pa cenuar Nenin 55, autoriteti mbikëqyrës i selisë ose i një dege të kontrolluesit ose përpunuesit ka kompetencë të veprojë si autoritet mbikëqyrës epror për përpunimin ndërkufitar të kryer nga ai kontrollues ose përpunues në pajtim me procedurën e parashikuar në Nenin 60.

2. Ndryshe nga paragrafi 1, çdo autoritet mbikëqyrës ka kompetencë të trajtojë një ankim të paraqitur atij ose një shkelje të mundshme të kësaj Rregulloreje, nëse çështja ka të bëjë vetëm me një degë në Shtetin e tij Anëtar ose prek në mënyrë thelbësore subjektet e të dhënave vetëm në Shtetin e tij Anëtar.

3. Në rastet e përmendura në paragrafin 2 të këtij Neni, autoriteti mbikëqyrës informon autoritetin mbikëqyrës epror pa vonesë për çështjen. Brenda një periudhe tre-javore nga njoftimi, autoriteti mbikëqyrës epror vendos nëse ai do ta trajtojë çështjen në pajtim me procedurën e parashikuar në Nenin 60 ose jo, duke marrë parasysh nëse ka një degë të kontrolluesit ose të përpunuesit në Shtetin Anëtar autoriteti mbikëqyrës i të cilit ka informuar atë.

4. Nëse autoriteti mbikëqyrës epror vendos të trajtojë çështjen, zbatohet procedura e parashikuar në Nenin 60. Autoriteti mbikëqyrës i cili informoi autoritetin mbikëqyrës epror mund të paraqesë autoritetit mbikëqyrës epror një projekt për një vendim. Autoriteti mbikëqyrës epror i kushton rëndësi të madhe projektit gjatë përgatitjes së projekt-vendimit të përmendur në Nenin 60(3).

5. Nëse autoriteti mbikëqyrës epror vendos të mos e trajtojë çështjen, autoriteti mbikëqyrës që informoi autoritetin mbikëqyrës epror e trajton atë në pajtim me Nenet 61 dhe 62.

6. Autoriteti mbikëqyrës epror është pika e vetme e kontaktit për kontrolluesin ose përpunuesin për përpunimin ndërkufitar të kryer nga ai kontrollues ose përpunues.

Neni 57

Detyrat

1. Pa cenuar detyrat e tjera të përcaktuara sipas kësaj Rregulloreje, çdo autoritet mbikëqyrës në territorin e vet:

(a) Monitoron dhe realizon zbatimin e kësaj Rregulloreje;

(b) Nxit ndërgjegjësimin dhe konceptimin publik për rreziqet, rregullat, garancitë dhe të drejtat në lidhje me përpunimin. Aktivitetet që u drejtohen specifikisht fëmijëve u kushtohet vëmendje e veçantë;

(c) Këshillon, në pajtim me të drejtën e Shtetit Anëtar, parlamentin, qeverinë institucionet dhe organet e tjera të brendshme mbi masat legjislative dhe administrative në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave fizikë për sa i takon përpunimit;

(d) Nxit ndërgjegjësimin e kontrolluesve dhe përpunuesve për detyrimet e tyre sipas kësaj

Rregulloreje;

(e) Me kërkesë, i jep informacion çdo subjekti të të dhënave në lidhje me ushtrimin e të drejtave të tij sipas kësaj Rregulloreje dhe sipas rastit, bashkëpunon me autoritetet mbikëqyrëse në Shtetet e tjera Anëtare për këtë qëllim;

(f) Trajton ankimet e paraqitura nga një subjekt i të dhënave ose nga një organ, organizatë ose shoqatë në pajtim me Nenin 80 dhe heton, në masën e duhur, themelin e ankesës dhe informon ankuesin në lidhje me mbarëvajtjen dhe rezultatin e hetimit brenda një afati të arsyeshëm, veçanërisht nëse është i nevojshëm hetimi i mëtejshëm apo bashkërendimi me një organ tjetër mbikëqyrës;

(g) Bashkëpunon, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit dhe dhënien e ndihmës së ndërsjellë autoriteteve të tjera mbikëqyrëse me qëllim garantimin e njëtrajtshmërisë së zbatimit dhe ekzekutimit të kësaj Rregulloreje;

(h) Zhvillon hetime në lidhje me zbatimin e kësaj Rregulloreje, duke përfshirë në bazë të informacionit të marrë nga një organ tjetër mbikëqyrës ose autoritet tjetër publik;

(i) Monitoron zhvillimet përkatëse, në masën që ato kanë ndikim mbi mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht zhvillimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit dhe praktikave tregtare;

(j) Cakton klauzola kontraktuale standarde të përmendura në Nenin 28(8) dhe pika (d) e Nenit 46(2);

(k) Përpilon dhe mban një listë në lidhje me kërkesën për vlerësimin e ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave në pajtim me Nenin 35(4);

(l) Jep këshillim mbi operacionet e përpunimit të përmendura në Nenin 36(2);

(m) Inkurajon hartimin e kodeve të sjelljes në pajtim me Nenin 40(1) dhe jep një mendim dhe aprovon këto kode sjelljeje që ofrojnë garanci të mjaftueshme, në pajtim me Nenin 40(5);

(n) Inkurajon ngritjen e mekanizmave të certifikimit të mbrojtjes së të dhënave dhe të vulave dhe shenjave të mbrojtjes së të dhënave në pajtim me Nenin 42(1), dhe aprovon kriteret e certifikimit në pajtim me Nenin 42(5);

(o) Sipas rastit, kryhen një rishikim periodik të certifikimeve të dhëna në pajtim me Nenin 42(7);

(p) Përpilon dhe publikon kriteret për akreditimin e një organi për monitorimin e kodeve të sjelljes në pajtim me Nenin 41 dhe të një organi certifikimi në pajtim me Nenin 43;

(q) Kryen akreditimin e një organi për monitorimin e kodeve të sjelljes në pajtim me Nenin 41 dhe të një organi certifikimi në pajtim me Nenin 43;

(r) Autorizon klauzolat kontraktuale dhe dispozitat e përmendura në Nenin 46(3);

(s) Aprovon rregulla detyruese të brendshme në pajtim me Nenin 47;

(t) Kontribuon në aktivitetet e Bordit;

(u) Mban regjistra të brendshëm për shkeljet e kësaj Rregulloreje dhe të masave të marra në pajtim me Nenin 58(2); dhe

(v) Përmbush çdo detyrë tjetër në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Çdo autoritet mbikëqyrës lehtëson paraqitjen e ankesave të përmendura në pikën (f) të paragrafit 1 me masa të tilla si një formular për paraqitjen e kërkesës që mund të mbushet edhe elektronikisht, pa përjashtuar masa të tjera të komunikimit.

3. Kryerja e detyrave të tjera nga secili autoritet mbikëqyrës është falas për subjektin e të dhënave dhe, sipas rastit, për nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave.

4. Nëse kërkesat janë haptazi të pabazuara ose të tepërta, veçanërisht për shkak të karakterit të tyre përsëritës, autoriteti mbikëqyrës mund të vendosë një tarifë të arsyeshme, bazuar në shpenzimet administrative ose të refuzojë të veprojë në bazë të kërkesës. Autoriteti mbikëqyrës ka barrën e demonstrimit të karakterit haptazi të pabazuar ose të tepër të kërkesës..

Tagrat

1. Secili autoritet mbikëqyrës ka të gjithë tagrat e mëposhtëm për hetim:
 - (a) Të urdhërojë kontrolluesin dhe përpunuesin, dhe sipas rastit, përfaqësuesin e kontrolluesit ose përfaqësuesit të japë çdo inflamacion që i duhet për të përmbushur detyrat e tij;
 - (b) Të kryejë hetime në formën e auditimeve të mbrojtjes së të dhënave;
 - (c) Të kryejë një rishikim të certifikimeve të dhëna në pajtim me Nenin 42(7);
 - (d) Të njoftojë kontrolluesin ose përpunuesin për një shkelje të pretenduar të kësaj Rregulloreje;
 - (e) Të përftojë nga kontrolluesi ose përpunuesi akses tek të gjitha të dhënat personale dhe tek të gjithë informacioni i nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tij;
 - (f) Të përftojë akses tek çdo mjedis i kontrolluesit ose përpunuesit, duke përfshirë çdo pajisje dhe mjet për përpunimin e të dhënave, në pajtim me të drejtën procedurale të Bashkimit ose Shtetit Anëtar.
2. Secili autoritet mbikëqyrës ka të gjithë tagrat e mëposhtëm korrigjues:
 - (a) Të nxjerrë paralajmërimet për një kontrollues ose përpunues që operacionet përpunuese të synuara mund të shkelin dispozitat e kësaj Rregulloreje;
 - (b) Ti tërheqë vëmendjen një kontrolluesi ose përpunuesi nëse operacionet përpunuese kanë shkelur dispozitat e kësaj Rregulloreje;
 - (c) Të urdhërojë kontrolluesin ose përpunuesin të përmbushë kërkesat e subjektit të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tij ose të saj në pajtim me këtë Rregullore;
 - (d) Të urdhërojë kontrolluesin ose përpunuesin ti sjellë operacionet e përpunimit në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, sipas rastit, në një mënyrë të specifikuar dhe brenda një afati të specifikuar;
 - (e) Të urdhërojë kontrolluesin ti komunikojë subjektit të të dhënave një shkelje në lidhje me të dhënat personale;
 - (f) Të vendosë një kufizim të përkohshëm ose të përhershëm duke përfshirë ndalimin e përpunimit;
 - (g) Të urdhërojë korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale ose kufizimin e përpunimit në pajtim me Nenet 16, 17 dhe 18 dhe njoftimin e këtyre veprimeve marrësve të cilëve u janë deklaruar të dhënat personale në pajtim me Nenin 17(2) dhe Nenin 19;
 - (h) Të tërheqë një certifikim ose urdhërojë organin e certifikimit të tërheqë certifikimin në pajtim me Nenet 42 dhe 43 ose të urdhërojë organin e certifikimit të mos lëshojë certifikimin nëse nuk përmbushen ose nuk vazhdojnë të përmbushen kërkesat e certifikimit;
 - (i) Të vendosë gjobë administrative në pajtim me Nenin 83, përveç, ose në vend të masave të përmendura në këtë paragraf, në varësi të rrethanave të çdo rasti individual;
 - (j) Të urdhërojë pezullimin e fluksit të të dhënave tek një marrës në një vend të tretë ose një organizatë ndërkombëtare.
3. Secili autoritet mbikëqyrës ka të gjithë autorizimet dhe tagrat e mëposhtëm këshillues:
 - (a) Të këshillojë kontrolluesin në pajtim me procedurën paraprake të konsultimeve të përmendur në Nenin 36;
 - (b) Të lëshojë, me iniciativë të vet ose me kërkesë, opinione për parlamentin e brendshëm, qeverinë e Shtetit Anëtar ose në pajtim me të drejtën e Shtetit Anëtar, për institucionet dhe organet e tjera si dhe publikon për çdo çështje në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale;
 - (c) Të autorizojë përpunimin e përmendur në Nenin 36(5), nëse ligji i Shtetit Anëtar kërkon një

autorizim të tillë paraprak;

- (d) Të lëshojë një opinion dhe të aprovojë projekt-kodet e sjelljes në pajtim me Nenin 40(5);
- (e) Të akreditojë organet e certifikimit në pajtim me Nenin 43;
- (f) Të lëshojë certifikatat dhe aprovojë kriteret e certifikimit në pajtim me Nenin 42(5);
- (g) Të miratojë klauzola standarde për mbrojtjen e të dhënave të përmendura në Nenin 28(8) dhe pika (d) e Nenit 46(2);
- (h) Të autorizojë klauzola kontraktuale standarde të përmendura në pikën (d) e Nenit 46(3);
- (i) Të autorizojë masat administrative të përmendura në pikën (b) të Nenit 46(3);
- (j) Të aprovojë rregulla detyruese të brendshme në pajtim me Nenin 47.

4. Ushtrimi i tagrave të dhëna autoritetit mbikëqyrës në pajtim me këtë Nen u nënshtrohet garancive të përshtatshme, duke përfshirë mjetet gjyqësore të efektshme dhe procesin e rregullt, të caktuar në të drejtën e Bashkimit dhe Shtetit Anëtar në pajtim me Kartën.

5. Secili Shtet Anëtar parashikon me ligj që autoriteti i tij mbikëqyrës të ketë tagrin të sjellë shkeljet e kësaj Rregulloreje në vëmendje të autoriteteve gjyqësore dhe sipas rastit, të fillojë ose angazhohet ndryshe në çështje gjyqësore, me qëllim që të zbatojë dispozitat e kësaj Rregulloreje.

6. Secili shtet Anëtar mund të parashikojë me ligj që autoriteti i tij mbikëqyrës të ketë tagra shtesë ndaj atyre që përmenden në paragrafët 1, 2 dhe 3. Ushtrimi i këtyre tagrave nuk cenon zbatimin e efektshëm të Kapitullit VII.

Neni 59

Raportet e aktivitetit

Çdo autoritet mbikëqyrës përpilon një raport vjetor mbi aktivitetet e tij, që mund të përfshijnë një listë të tipave të shkeljeve të njoftuara dhe tipat e masave të marra në pajtim me nenin 58(2). Këto raporte u transmetohen parlamenteve të brendshme, qeverive dhe autoriteteve të tjera që caktohen nga e drejta e Shtetit Anëtar. Ato i ofrohen publikut, Komisionit dhe Bordit.

KAPITULLI VII

Bashkëpunimi dhe njëtrajtshmëria

Seksioni 1

Bashkëpunimi

Neni 60

Bashkëpunimi ndërmjet autoritetit mbikëqyrës epror dhe autoriteteve të tjera mbikëqyrëse të interesuar

1. Autoriteti mbikëqyrës epror bashkëpunon me autoritetet e tjera mbikëqyrës të interesuar në pajtim me këtë nen dhe përpiqet për të arritur konsensus. Autoriteti mbikëqyrës epror dhe autoritetet mbikëqyrës të interesuar shkëmbejnë të gjithë informacionin përkatës me njeri-tjetrin.
2. Autoriteti mbikëqyrës epror mund tu kërkojë në çdo kohë autoriteteve të tjerë mbikëqyrëse të interesuar për të dhënë ndihmë të ndërsjellë në pajtim me nenin 61 dhe mund të zhvillojë operacione të përbashkëta në pajtim me Nenin 62, veçanërisht në kryerjen e hetimeve ose për monitorimin e

zbatimit të një mase në lidhje me kontrollues ose përpunues të vendosur në një Shtet Anëtar tjetër.

3. Autoriteti mbikëqyrës epror, pa vonesë, ua komunikon informacionin për çështjen autoriteteve të tjerë mbikëqyrës të interesuar. Ai u paraqet pa vonesë një projekt vendim autoriteteve të tjerë mbikëqyrës të interesuar për mendim dhe merr parasysh si duhet mendimet e tyre.

4. Nëse ndonjë prej autoriteteve të tjerë mbikëqyrës të interesuar brenda një afati kohor prej katër javësh pas konsultimit në pajtim me paragrafin 3 të këtij Neni shpreh një kundërshtim me vend dhe të arsyetuar për projekt-vendimin, autoriteti mbikëqyrës epror, nëse ai nuk e përmbush kundërshtimin përkatës dhe të arsyetuar ose është i mendimit që kundërshtimi nuk është me vend dhe i arsyeshëm, ia paraqet çështjen mekanizmit të përputhshmërisë të referuar në Nenin 63.

5. Nëse autoriteti mbikëqyrës epror ka ndër mend të përmbushë kundërshtimin përkatës dhe të arsyetuar që është bërë, ai u paraqet anëtarëve të tjerë mbikëqyrës një projekt vendim të rishikuar për mendim. Ky projekt vendim i rishikuar i nënshtrohet procedurës të përmendur në paragrafin 4 brenda një afati prej dy javësh.

6. Nëse asnjë prej autoriteteve të tjerë mbikëqyrës të interesuar nuk kundërshton projekt vendimin e paraqitur nga autoriteti mbikëqyrës epror brenda afatit të referuar në paragrafët 4 dhe 5, autoriteti mbikëqyrës epror dhe autoritetet mbikëqyrëse të interesuar konsiderohen të jenë dakord me atë projekt vendim dhe i nënshtrohen atij.

7. Autoriteti mbikëqyrës epror miraton dhe i njofton vendimin strukturës kryesore ose strukturës së vetme të kontrolluesit ose përpunuesit, sipas rastit, dhe njofton autoritetet e tjerë mbikëqyrës të interesuar dhe Bordin në lidhje me vendimin në fjalë, duke përfshirë një përmbledhje të fakteve dhe shkaqeve përkatëse. Autoriteti mbikëqyrës tek i cili është bërë një ankim njofton ankimuesin në lidhje me vendimin.

8. Duke u shmangur nga paragrafi 7, nëse refuzohet ose rrëzohet një ankim, autoriteti mbikëqyrës ku është bërë ankimi miraton vendimin dhe ia njofton atë ankimuesit dhe për këtë njofton kontrolluesin.

9. Nëse autoriteti mbikëqyrës epror dhe autoritetet mbikëqyrëse të interesuar bien dakord të rrëzojnë ose refuzojnë pjesë të një ankimi dhe të veprojnë për pjesët e tjera të atij ankimi, miratohet një vendim i veçantë për secilën prej atyre pjesëve të çështjes. Autoriteti mbikëqyrës epror e miraton vendimin për pjesën në lidhje me veprimet në lidhje me kontrolluesin, ia njofton atë strukturës kryesore ose strukturës së vetme të kontrolluesit ose përpunuesit në territorin e Shtetit të tij Anëtar dhe për këtë njofton ankimuesin, ndërsa autoriteti mbikëqyrës i ankimuesit e miraton vendimin për pjesën në lidhje me rrëzimin ose refuzimin e atij ankimi dhe ia njofton atë ankimuesit si dhe njofton për këtë kontrolluesin dhe përpunuesin.

10. Pas njoftimit për vendimin e autoritetit mbikëqyrës epror në pajtim me paragrafët 7 dhe 9, kontrolluesi ose përpunuesi merr masat e nevojshme për të garantuar përputhshmërinë me vendimin në lidhje me aktivitetet përpunuese në kontekstin e të gjitha strukturave të tij në Bashkim. Kontrolluesi ose përpunuesi ia njofton masat e marra për të respektuar vendimin autoritetit mbikëqyrës epror, që njofton autoritetet e tjera mbikëqyrëse të interesuara.

11. Nëse në rrethana të veçanta, autoriteti mbikëqyrës i interesuar ka shkaqe për të konsideruar që ka një nevojë urgjente për të vepruar për të mbrojtur interesat e subjekteve të të dhënave, zbatohet procedura e urgjencës e përmendur në Nenin 66.

12. Autoriteti mbikëqyrës epror dhe autoritetet e tjera mbikëqyrëse të interesuara i japin njëri-tjetrit informacionin e kërkuar sipas këtij Neni me mjete elektronike, duke përdorur një format të standardizuar.

Ndihma e ndërsjellë

1. Autoritetet mbikëqyrëse i japin njëri-tjetrit informacionin e duhur dhe ndihmë të ndërsjellë për të zbatuar këtë Rregullore në një mënyrë të njëtrajtshme dhe merr masat për bashkëpunim të efektshëm me njëri-tjetrin. Ndihma e ndërsjellë, veçanërisht, mbulon kërkesat për informacion dhe masat mbikëqyrëse, si kërkesat për autorizimet dhe konsultimet, inspektimet dhe hetimet paraprahe.
2. Çdo autoritet mbikëqyrës merr të gjitha masat e përshtatshme të kërkuara për t'iu përgjigjur një kërkesë të një autoriteti tjetër mbikëqyrës pa vonesë të panevojshme dhe jo më vonë se një muaj pas marrjes së kërkesës. Kjo kërkesë mund të përfshijë veçanërisht transmetimin e informacionit mbi zhvillimin e një hetimi.
3. Kërkesat për ndihmë përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm, duke përfshirë qëllimin dhe shkaqet e kërkesës. Informacioni i shkëmbyer përdoret vetëm për qëllimin për të cilin është kërkuar.
4. Autoriteti mbikëqyrës i kërkuar nuk refuzon përmbushjen e kërkesës, përveç kur:
 - (a) nuk është kompetent për përmbajtjen e kërkesës ose për masat që kërkohen për ta ekzekutuar; ose
 - (b) përmbushja e kërkesës do të shkelte këtë Rregullore ose të drejtën e Bashkimit ose shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet autoriteti mbikëqyrës që merr kërkesën.
5. Autoriteti mbikëqyrës i kërkuar njofton autoritetin mbikëqyrës kërkuar për rezultatet ose, sipas rastit, përparimin e masave të marra për t'iu përgjigjur kërkesës. Autoriteti mbikëqyrës i kërkuar jep arsytet për çdo refuzim për të respektuar një kërkesë në pajtim me paragrafin 4.
6. Autoritetet mbikëqyrëse të kërkuara, si rregull, e japin informacionin e kërkuar nga autoritetet e tjera me mjete elektronike, duke përdorur një format të standardizuar.
7. Autoritetet mbikëqyrëse të kërkuara nuk kërkojnë tarifë për asnjë veprim të ndërmarrë prej tyre në pajtim me një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë. Autoritetet mbikëqyrëse mund të bien dakord për rregullat për të zhdëmtuar njëri-tjetrin për shpenzimet specifike që rrjedhin nga dhënia e ndihmës së ndërsjellë në rrethana të veçanta.
8. Nëse një autoritet mbikëqyrës nuk e jep informacionin e referuar në paragrafin 5 të këtij Neni brenda një muaji nga marrja e kërkesës së një autoriteti tjetër mbikëqyrës, autoriteti mbikëqyrës kërkuar mund të miratojë një masë provizore në territorin e Shtetit të tij Anëtar në pajtim me Nenin 55(1). Në këtë rast, nevoja urgjente për të vepruar sipas Nenit 66(1) prezumohet të përmbushet dhe kërkon një vendim urgjent detyrues nga Bordi në pajtim me Nenin 66(2).
9. Komisioni, me anë të akteve zbatuese mund të specifikojë formatin dhe procedurat për ndihmë të ndërsjellë të referuar në këtë nen dhe masat për shkëmbimin e informacionit me mjete elektronike ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe Bordit, veçanërisht formatin e standardizuar të referuar në paragrafin 6 të këtij Neni. Këto akte zbatuese miratohen në pajtim me procedurën e shqyrtimit të referuar në Nenin 93(2).

Operacionet e përbashkëta të autoriteteve mbikëqyrëse

1. Autoritetet mbikëqyrëse, sipas rastit, kryejnë operacione të përbashkëta duke përfshirë hetime të përbashkëta dhe masa ekzekutive të përbashkëta në të cilat angazhohen anëtarë ose personeli i autoriteteve mbikëqyrëse të Shteteve të tjera Anëtare.
2. Nëse kontrolluesi ose përpunuesi ka struktura në disa Shtete Anëtare ose nëse një numër i konsiderueshëm i subjekteve të të dhënave në më shumë se një Shtet Anëtar mund të preket nga operacionet përpunuese, një autoriteti mbikëqyrës i secilit prej atyre Shteteve Anëtare ka të drejtën të marrë pjesë në operacionet e përbashkëta. Autoriteti mbikëqyrës që është kompetent sipas nenit 56(1) ose (4) fton autoritetin mbikëqyrës të secilit prej atyre Shteteve Anëtare të marrin pjesë në operacionet e përbashkëta dhe përgjigjen pa vonesë ndaj kërkesës së një autoriteti mbikëqyrës për të marrë pjesë.
3. Një autoritet mbikëqyrës, në pajtim me të drejtën e Shtetit Anëtar, dhe me autorizimin e autoritetit mbikëqyrës autorizues, mund të japë kompetenca, duke përfshirë kompetencat hetuese për anëtarët ose personelin e autoritetit mbikëqyrës autorizues të përfshirë në operacionet e përbashkëta, ose nëse e drejta e Shtetit Anëtar të autoritetit mbikëqyrës pritës e lejon anëtarët ose personelin e autoritetit mbikëqyrës autorizues të ushtrojnë kompetencat e tyre në pajtim me të drejtën e Shtetit Anëtar të autoritetit mbikëqyrës autorizues. Këto kompetenca hetimore mund të ushtrohen nën udhëzimin dhe në prezencë të anëtarëve ose personelit të autoritetit mbikëqyrës pritës. Anëtarët ose personeli autoritetit mbikëqyrës autorizues i nënshtrohen së drejtës së Shtetit Anëtar të autoritetit mbikëqyrës pritës.
4. Nëse në pajtim me paragrafin 1, personeli i një autoriteti mbikëqyrës autorizues operon në një Shtet tjetër Anëtar, Shteti Anëtar i autoritetit mbikëqyrës pritës merr përgjegjësi për veprimet e tyre, duke përfshirë përgjegjësinë, për çdo dëm të shkaktuar prej tyre gjatë operacioneve të tyre, në pajtim me të drejtën e Shtetit Anëtar në territorin e të cilit ata operojnë.
5. Shteti Anëtar në territorin e të cilit është shkaktuar dëmi e zhdëmton një dëm të tillë sipas kushteve të zbatueshme për dëmin e shkaktuar nga personeli vet. Shteti Anëtar i autoritetit mbikëqyrës autorizues personeli i të cilit ka shkaktuar dëm ndaj një personi në territorin e një Shteti tjetër Anëtar rimbursion Shtetin tjetër Anëtar plotësisht për çdo shumë që ai ka paguar për personat që kanë të drejtën në emër të tyre.
6. Pa cenuar ushtrimin e të drejtave kundrejt palëve të treta dhe me përjashtim të paragrafit 5, secili Shtet Anëtar, në rastin e parashikuar në paragrafin 1, nuk kërkon rimbursim nga një Shtet tjetër Anëtar në lidhje me dëmin e referuar në paragrafin 4.
7. Nëse synohet të kryhet një operacion i përbashkët dhe brenda një muaji, një autoritet mbikëqyrës nuk e përmbush detyrimin e parashikuar në fjalinë e dytë të paragrafit 2 të këtij Neni, autoritetet e tjera mbikëqyrëse mund të miratojnë një masë provizore në territorin e Shtetit Anëtar të tij në pajtim me Nenin 55. Në këtë rast, prezumohet të përmbushet nevoja urgjente për të vepruar sipas Nenit 66(1) dhe kërkohet një opinion ose një vendim detyrues urgjent nga Bordi në pajtim me Nenin 66(2).

Seksioni 2

Njëtrajtshmëria

Mekanizmi i njëtrajtshmërisë

Me qëllim kontributin në zbatimin e njëtrajtshëm të kësaj Rregulloreje në të gjithë Bashkimin, autoritetet mbikëqyrëse bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe sipas rastit, me Komisionin, nëpërmjet mekanizmit të njëtrajtshmërisë sipas parashikimit në këtë Seksion.

Neni 64

Opinionin e Bordit

1. Bordi nxjerr një mendim nëse një autoritet mbikëqyrës kompetent synon të miratojë ndonjë nga masat e mëposhtme. Për këtë qëllim, autoriteti mbikëqyrës kompetent i komunikon Bordit projekt vendimin, kur ai:

- (a) synon të miratojë një listë të operacioneve të përpunimit duke iu nënshtruar kërkesave të një vlerësimi të ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave në pajtim me Nenin 35(4);
- (b) ka të bëjë me një çështje në pajtim me Nenin 40(7), nëse një projekt kod i sjelljes ose një ndryshim apo zgjerim i një kodi të sjelljes është në pajtim me këtë Rregullore;
- (c) synon të miratojë kritere për akreditimin e një organi në pajtim me Nenin 41(3) ose një organ certifikimi në pajtim me Nenin 43(3);
- (d) synon të përcaktojë klauzola standarde për mbrojtjen e të dhënave të referuara në pikën (d) të Nenit 46(2) dhe në Nenin 28(8);
- (e) synon të autorizojë klauzola kontraktuale të referuara në pikën (a) të nenit 46(3); ose
- (f) synon të aprovojë rregulla të brendshme detyruese brenda kuptimit të Nenit 47.

2. Çdo organ mbikëqyrës, Kryetar Bordi ose Komision mund të kërkojë që një çështje me zbatim të përgjithshëm ose që ka efekte në më shumë se një Shtet Anëtar të shqyrtohet nga Bordi me qëllim përfitim të një mendimi, veçanërisht nëse një autoritet mbikëqyrës kompetent nuk respekton detyrimet për ndihmë të ndërsjellë në pajtim me Nenin 61 ose për operacione të përbashkëta në pajtim me Nenin 62.

3. Në rastet e referuara në paragrafët 1 dhe 2, Bordi nxjerr një vendim në lidhje me çështjen e paraqitur atij, me kusht që të mos ketë nxjerr ndonjë opinion për të njëjtën çështje. Ky opinion miratohet brenda tetë javëve me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të Bordit. Ky afat mund të zgjatet me tetë javë të tjera duke marrë parasysh kompleksitetin e lëndës. Në lidhje me projekt vendimin e përmendur në paragrafin 1 të qarkulluar tek anëtarët e Bordit në pajtim me paragrafin 5, një anëtar që nuk ka kundërshtuar brenda një afati të arsyeshëm të treguar nga Kryetari, konsiderohet të jetë dakord me projekt vendimin.

4. Autoritetet mbikëqyrëse dhe Komisioni, pa vonesë të panevojshme, i komunikon Bordit me mjete elektronike, duke përdorur një format të standardizuar çdo informacion të vlefshëm, duke përfshirë sipas rastit një përmbledhje të fakteve, projekt vendimin, shkaqet të cilat e bëjnë ardhjen në fuqi të këtyre masave të nevojshme, dhe mendimet e autoriteteve të tjera mbikëqyrëse të interesuara.

5. Kryetari i Bordit, pa vonesë të panevojshme, njofton me mjete elektronike:

- (a) anëtarët e Bordit dhe Komisionin për çdo informacion të rëndësishëm që i është komunikuar duke përdorur një format të standardizuar. Sekretariati i Bordit, sipas rastit, paraqet përkthime të informacionit përkatës; dhe
- (b) autoritetin mbikëqyrës të referuar, sipas rastit, në paragrafët 1 dhe 2, dhe Komisionin për opinionin dhe e bën atë publik.

6. Autoriteti kompetent mbikëqyrës nuk e miraton projekt vendimin e tij të referuar në

paragrafin 1 brenda afatit të përmendur në paragrafin 3.

7. Autoriteti mbikëqyrës i referuar në paragrafin 1 merr parasysh rregullisht opinionin e Bordit dhe, brenda dy javësh pas marrjes së opinionit, ia komunikon Kryetarit të Bordit me mjete elektronike nëse ai do të mbajë apo ndryshojë projekt vendimin dhe sipas rastit, ndryshon projekt vendimin, duke përdorur një format të standardizuar.

8. Nëse autoriteti mbikëqyrës i interesuar njofton Kryetarin e Bordit brenda afatit të referuar në paragrafin 7 të këtij Neni që ai nuk synon të ndjekë opinionin e Bordit, pjesërisht ose plotësisht, duke dhënë shkaqet përkatëse, zbatohet neni 65(1)

Neni 65

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve nga Bordi

1. Me qëllim që të garantohet zbatimi i saktë dhe i njëtrajtshëm i kësaj Rregulloreje në raste të veçanta, Bordi miraton një vendim detyrues në rastet e mëposhtme:

(a) nëse në një çështje të referuar në Nenin 60(4), një autoriteti mbikëqyrës i interesuar ka ngritur një kundërshtim të rëndësishëm dhe të arsyeshëm për një projekt vendim të autoritetit epror ose autoriteti epror ka refuzuar një kundërshtim të tillë si jo i rëndësishëm ose i paarsyetuar. Vendimi detyrues trajton të gjitha çështjet që përfshihen në kundërshtimin e rëndësishëm dhe të arsyetuar, veçanërisht nëse ka një shkelje të kësaj Rregulloreje.

(b) nëse ka mendime kontradiktore se cili nga autoritetet mbikëqyrëse është kompetent për strukturën kryesore;

(c) nëse një autoritet mbikëqyrës kompetent nuk kërkon opinionin e Bordit në rastet e përmendura në Nenin 64(1), ose nuk respekton opinionin e Bordit të nxjerrë sipas Nenit 64. Në këtë rast, çdo autoritet mbikëqyrës i interesuar ose Komisioni mund t'ia komunikojë çështjen Bordit.

2. Vendimi i referuar në paragrafin 1 miratohet brenda një muaji nga referimi i çështjes me një shumicë prej dy të tretash të anëtarëve të bordit. Ky afat mund të zgjatet me një muaj tjetër për shkak të kompleksitetit të çështjes. Vendimi i referuar në paragrafin 1 është i arsyetuar dhe i drejtohet autoritetit mbikëqyrës epror dhe të gjithë autoriteteve mbikëqyrës të interesuar dhe është detyrues për ta.

3. Nëse Bordi nuk është në gjendje të miratojë një vendim brenda afateve të përmendura në paragrafin 2, ai e miraton vendimin brenda dy javëve pas skadimit të muajit të dytë të referuar në paragrafin 2 me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të Bordit. Nëse anëtarët e bordit ndahen, vendimi miratohet me votën e Kryetarit.

4. Autoritetet mbikëqyrës të interesuar miratojnë një vendim për çështjen e paraqitur Bordit sipas paragrafit 1 gjatë afateve të referuara në paragrafin 2 dhe 3.

5. Kryetari i Bordit ua njofton vendimin e referuar në paragrafin 1, pa vonesë të panevojshme, autoriteteve mbikëqyrëse të interesuar. Ai njofton për këtë Komisionin. Vendimi publikohet në faqen e internetit të Bordit pa vonesë pasi autoriteti mbikëqyrës të ketë njoftuar vendimin e referuar në paragrafin 6.

6. Autoriteti mbikëqyrës epror, ose sipas rastit, autoriteti mbikëqyrës tek i cili është paraqitur ankesa e miraton vendimin e tij përfundimtar mbi bazën e vendimit të referuar në paragrafin 1 të këtij Neni, pa vonesë të panevojshme dhe jo më vonë se një muaj pasi Bordi të ketë njoftuar vendimin e tij. Autoriteti mbikëqyrës kryesor, ose sipas rastit, autoriteti mbikëqyrës ku është paraqitur ankimi, njofton Bordin për datën kur vendimi përfundimtar i njoftohet përkatësisht kontrolluesit ose përpunuesit dhe subjektit të të dhënave. Vendimi përfundimtar i autoriteteve mbikëqyrëse të

interesuar miratohet sipas temave të Nenit 60(7), (8) dhe (9). Vendimi përfundimtar i referohet vendimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij Neni dhe specifikon që vendimi i referuar në atë paragraf të publikohet në faqen e internetit të Bordit në pajtim me paragrafin 5 të këtij Neni. Vendimi përfundimtar mund të bashkëngjisë vendimin e përmendur në paragrafin 1 të këtij Neni.

Neni 66

Procedura e urgjencës

1. Në rrethana të veçanta, nëse një autoritet mbikëqyrës i interesuar është i mendimit që ka një nevojë urgjente për të vepruar me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave, ai nëpërmjet shmangies nga mekanizmi i njëtrajtshmërisë i referuar në Nenet 63, 64 dhe 65, ose procedura e referuar në Nenin 60, mund të miratojë menjëherë masa provizore të destinuara për të prodhuar efekte ligjore në territorin e tij me një periudhë të caktuar vlefshmërie që nuk i kalon tre muaj. Autoriteti mbikëqyrës, pa vonesë, ia komunikon ato masa dhe arsye për miratim autoriteteve mbikëqyrëse të tjerë të interesuar, Bordit dhe Komisionit.
2. Nëse një autoritet mbikëqyrës ka marrë një masë në pajtim me paragrafin 1 dhe është i mendimit që masat përfundimtare duhet të miratohen me urgjencë, ai mund të kërkojë një mendim urgjent ose vendim detyrues urgjent nga Bordi, duke dhënë arsyet për kërkimin e një mendimi ose vendimi të tillë.
3. Çdo autoritet mbikëqyrës mund të kërkojë një opinion urgjent ose një vendim detyrues urgjent, sipas rastit, nga Bordi nëse një autoritet mbikëqyrës kompetent nuk ka marrë një masë të duhur në një situatë ku ka një nevojë urgjente për të vepruar, me qëllim që të mbrohen liritë dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave, duke dhënë shkaqet për kërkimin e këtij opinionit ose vendimi, duke përfshirë për nevojën urgjente për të vepruar.
4. Nëpërmjet shmangies nga neni 64(3) dhe Neni 65(2), një opinion urgjent ose një vendim detyrues urgjent i referuar në paragrafët 2 dhe 3 të këtij Neni miratohet brenda dy javëve me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të Bordit.

Neni 67

Shkëmbimi i informacionit

Komisioni mund të miratojë akte zbatuese me objekt të përgjithshëm me qëllim që të specifikojë masat për shkëmbimin e informacionit me mjete elektronike ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe Bordit, veçanërisht formatin e standardizuar referuar në Nenin 64. Këto akte zbatuese miratohen në pajtim me procedurën shqyrtimit të referuar në Nenin 93(2).

Seksioni 3

Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave

Neni 68

Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave

1. Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (Bordi) themelohet si një organ i Bashkimit dhe ka personalitet juridik.
2. Bordi përfaqësohet nga Kryetari.
3. Bordi përbëhet nga kryetari i një autoriteti mbikëqyrës i çdo Shteti Anëtar dhe Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave, ose përfaqësuesit e tyre përkatës.
4. Nëse në një Shtet Anëtar është përgjegjës më shumë se një autoriteti mbikëqyrës për monitorimin e zbatimit të dispozitave në pajtim me këtë Rregullore, caktohet një përfaqësues i përbashkët në pajtim me të drejtën e atij Shteti Anëtar.
5. Komisioni ka të drejtën të marrë pjesë në aktivitetet dhe mbledhjet e Bordit pa të drejtë vote. Komisioni mund të caktojë një përfaqësues. Kryetari i Bordit i komunikon Komisionit aktivitetet e Bordit.
6. Në rastet e referuara në Nenin 65, Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave ka të drejtat e votës vetëm për vendimet që kanë të bëjnë me parimet dhe rregullat e zbatueshëm në institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit që përputhen në lëndë me ato të kësaj Rregulloreje.

Neni 69

Pavarësia

1. Bordi në ushtrimin e detyrave ose ushtrimi i kompetencave në pajtim me Nenet 70 dhe 71 vepron në mënyrë të pavarur.
2. Pa prekur kërkesat nga Komisioni të referuara në pikën (b) të Nenit 70(1) dhe në Nenin 70(2), Bordi, në përmbushjen e detyrave dhe ushtrimi i kompetencave të veta, nuk kërkon dhe nuk merr udhëzime nga askush.

Neni 70

Detyrat e Bordit

1. Bordi garanton zbatimin e njëtrajtshëm të kësaj Rregulloreje. Për këtë qëllim, Bordi, iniciativën e vet ose sipas rastit, me kërkesë të Komisionit, veçanërisht:
 - (a) monitoron dhe garanton zbatimin e saktë të kësaj Rregulloreje në rastet e parashikuara në Nenet 64 dhe 65 pa cenuar detyrat e autoriteteve mbikëqyrëse të brendshme;
 - (b) këshillon Komisionin për çdo çështje në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në Bashkim, duke përfshirë çdo ndryshim të propozuar të kësaj Rregulloreje;
 - (c) këshillon Komisionin për formatin dhe procedurat për shkëmbimin e informacionit ndërmjet kontrolluesve, përpunuesve dhe autoriteteve mbikëqyrëse për rregullat e brendshme detyruese;
 - (d) nxjerr udhëzime, rekomandime dhe praktika më të mira për procedurat për fshirjen e lidhjeve, kopjeve ose përsëritjeve të të dhënave personale nga shërbimet e komunikimit të ofruara publikisht sipas referimit në Nenin 1(2);
 - (e) shqyrton, me iniciativën e vet, me kërkesë të një prej anëtarëve të tij ose me kërkesë të Komisionit, çdo çështje që mbulojnë zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe nxjerr udhëzime, rekomandime dhe praktikat më të mira me qëllim që të inkurajohet aplikimi i njëtrajtshëm i kësaj Rregulloreje;

(f) nxjerr udhëzime, rekomandime dhe praktikat me të mira në pajtim me pikën (e) të këtij paragrafi për specifikimin më tej të kriterëve dhe kushteve për vendimet e bazuara në profilizimin në pajtim me Nenin 22(2);

(g) nxjerr udhëzime, rekomandime dhe praktikat me të mira në pajtim me pikën (e) të këtij paragrafi për konstatimin e shkeljeve të të dhënave personale dhe përcaktimin e vonësës së panevojshme të përmendur në Nenin 33(1) dhe (2) dhe për rrethanat e veçanta në të cilat një kontrolluesi ose përpunuesi i kërkohet të njoftojë shkeljen e të dhënave personale;

(h) nxjerr udhëzime, rekomandime dhe praktikat me të mira në pajtim me pikën (e) të këtij paragrafi në lidhje me rrethanat në të cilat një shkelje e të dhënave personale mund të rezultojë në një risk të lartë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë të referuar në nenin 34(1);

(i) nxjerr udhëzime, rekomandime dhe praktikat me të mira në pajtim me pikën (e) të këtij paragrafi për qëllimin e specifikimit të mëtejshëm të kriterëve dhe kërkesave për transferimet e të dhënave personale bazuar në rregullat e brendshme detyruese të cilat respektohen nga kontrolluesit dhe rregullat e brendshme detyruese që respektohen nga përpunuesit dhe mbi kërkesat e tjera të nevojshme për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave të interesuar të referuar në Nenin 47;

(j) nxjerr udhëzime, rekomandime dhe praktikat me të mira në pajtim me pikën (e) të këtij paragrafi për qëllimin e specifikimit të kriterëve dhe kërkesave për transferimet e të dhënave personale në bazë të nenit 49(1);

(k) përpilon udhëzime për autoritetet mbikëqyrëse në lidhje me zbatimin e masave të referuara në nenin 58(1),

(2) dhe (3) dhe caktimin e gjobave administrative në pajtim me nenin 83;

(l) rishikon zbatimin praktik të udhëzimeve, rekomandimeve dhe praktikave më të mira referuara në pikat (e) dhe (f);

(m) nxjerr udhëzime, rekomandime dhe praktikat më të mira në pajtim me pikën (e) të këtij paragrafi për vendosjen e procedurave të zakonshme të raportimit nga personat fizikë të shkeljeve të kësaj Rregulloreje në pajtim me Nenin 54(2);

(n) inkurajon përpilimin e kodeve të sjelljes dhe ngritjen e mekanizmave të certifikimit për mbrojtjen e të dhënave vulat dhe shenjat për mbrojtjen e të dhënave në pajtim me Nenin 40 dhe 42;

(o) kryhen akreditimin e organeve të certifikimit dhe rishikimin e tij periodik në pajtim me Nenin 43 dhe mban një regjistër publik për organet e akredituara në pajtim me nenin 43(6) dhe të kontrolluesve dhe përpunuesve të akredituar të vendosur në vende të tretë në pajtim me Nenin 42(7);

(p) Specifikon kërkesat e referuara në Nenin 43(3) me qëllim akreditimin e organeve të certifikimit sipas Nenit 42;

(q) i paraqet Komisionit një opinion për kërkesat e certifikimit të referuar në Nenin 43(8);

(r) i paraqet Komisionit një opinion mbi ikonat e referuara në Nenin 12(7);

(s) i paraqet Komisionit një opinion për vlerësimin e përshtatshmërisë së nivelit të mbrojtjes në një vend të tretë ose organizatë ndërkombëtare, duke përfshirë për vlerësimin nëse një vend i tretë, territor ose një ose më shumë sektorë të specifikuar brenda atij vendi të tretë, ose organizatë ndërkombëtare nuk vazhdon të garantojë një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes. Për këtë qëllim, Komisioni i paraqet Bordit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, duke përfshirë korrespondencën me qeverinë e vendit të tretë, në lidhje me atë vend të tretë, territorin ose sektorin e specifikuar ose me organizatën ndërkombëtare;

(t) nxjerr opinione për projekt vendimet e autoriteteve mbikëqyrëse në pajtim me mekanizmin e njëtrajtshmërisë të referuar në Nenin 64(1), për çështjet e paraqitura në pajtim me nenin 64(2) dhe për të lëshuar vendime detyrues në pajtim me Nenin 65, duke përfshirë çështjet e referuara në Nenin 66;

- (u) nxit bashkëpunimin dhe shkëmbimin e efektshëm dypalësh dhe shumëpalësh të informacionit dhe praktikat më të mira ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse;
 - (v) nxit programet e përbashkëta të trajnimit dhe lehtëson shkëmbimet e personelit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe sipas rastit, me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të tretë ose me organizatat ndërkombëtare;
 - (w) nxit shkëmbimin e njohurive dhe dokumentacionit për legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave dhe praktikës me autoritetet mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave në të gjithë botën;
 - (x) nxjerr opinione mbi kodet e sjelljes të hartuara në nivelin e Bashkimit në pajtim me Nenin 40(9); dhe
 - (y) mban një regjistër elektronik me akses publik të vendimeve të marra nga autoritetet mbikëqyrëse dhe gjykatat për çështjet e trajtuara në mekanizmin e njëtrajtshmërisë.
2. Nëse Komisioni kërkon këshillim nga Bordi, ai mund të tregojë një afat, duke marrë parasysh urgjencën e çështjes.
 3. Bordi ia paraqet mendimet, udhëzimet, rekomandimet dhe praktikat më të mira Komisionit dhe komitetit të cilat përmenden në Nenin 93 dhe i bën ato publike.
 4. Bordi, sipas rastit, konsultohet me palët e interesuara dhe u jep atyre mundësinë për të komentuar brenda një afati të arsyeshëm. Bordi, pa cenuar nenin 76, bën publike rezultatet e procedurës së konsultimit.

Neni 71

Raportet

1. Bordi përpilon një raport vjetor në lidhje me mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin në Bashkim dhe sipas rastit, në vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare. Raporti bëhet publik dhe i transmetohet Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit.
2. Raporti vjetor përfshin një rishikim të zbatimit praktik të udhëzimeve, rekomandimeve dhe praktikave më të mira të referuara në pikën (1) të Nenit 70(1), si dhe të vendimeve detyruese të referuara në Nenin 65.

Neni 72

Procedura

1. Bordi i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të tij, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Rregullore.
2. Bordi i miraton rregullat e veta procedurale me shumicën prej dy të tretat e anëtarëve të tij dhe organizon masat e veta operationale

Neni 73

Kryetari

1. Bordi zgjedh një kryetar dhe dy zëvendëskryetar nga anëtarët e vet me shumicë të thjeshtë.
2. Mandati i Kryetarit dhe i zëvendëskryetarëve është pesë vjet dhe është i rinovueshëm një herë.

Neni 74

Detyrat e Kryetarit

1. Kryetari ka detyrat e mëposhtme:
 - (a) thirrjen e mbledhjeve të Bordit dhe përgatitja e rendit të ditës;
 - (b) njoftimin e vendimeve të miratuara nga Bordi në pajtim me Nenin 65 të autoritetit mbikëqyrës epror dhe autoriteteve mbikëqyrëse të interesuar;
 - (c) garantimin e përmbushjes në kohë të detyrave të Bordit, veçanërisht në lidhje me mekanizmin e njëtrajtshmërisë së referuar në nenin 63.
2. Bordi parashikon caktimin e detyrave ndërmjet Kryetarit dhe zëvendëskryetarëve në rregullat e veta procedurale.

Neni 75

Sekretariati

1. Bordi ka një sekretariat, i cili ofrohet nga Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave.
2. Sekretariati i përmbush detyrat e tij ekskluzivisht nën udhëzimet e Kryetarit të Bordit.
3. Personeli i Mbikëqyrësit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave i angazhuar në kryerjen e detyrave të dhëna Bordit nga kjo Rregullore i nënshtrohet linjave të veçanta të raportimit nga personeli i përfshirë në kryerjen e detyrave të dhëna Mbikëqyrësit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave.
4. Sipas rastit, Bordi dhe Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave harton dhe publikon një Memorandum Mirëkuptimi që zbaton këtë Nen, duke përcaktuar termat e bashkëpunimit të tyre dhe që zbatohet për personelin e Mbikëqyrësit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave të përfshirë në përmbushjen e detyrave të caktuara Bordit nga kjo Rregullore.
5. Sekretariati i jep Bordit mbështetje analitike, administrative dhe logjistike.
Sekretariati është përgjegjës veçanërisht për:
 - (a) aktivitetin e përditshëm të Bordit;
 - (b) komunikimin ndërmjet anëtarëve të bordit, Kryetarit dhe Komisionit;
 - (c) komunikimi me institucionet dhe publikun;
 - (d) përdorimin e mjeteve elektronike për komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm;
 - (e) përkthimin e informacionit të rëndësishëm;
 - (f) përgatitjen dhe ndjekjen e mbledhjeve të Bordit;
 - (g) përgatitjen, përpilimin dhe publikimin e opinioneve, vendimeve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe teksteve të tjera të miratuara nga Bordi.

Neni 76

Konfidencialiteti

1. Diskutimet në Bord janë konfidenciale nëse Bordi e konsideron të nevojshme, sipas parashikimit në rregullat e veta procedurale.
2. Aksesit tek dokumentet e paraqitura anëtarëve të Bordit, ekspertëve dhe përfaqësuesve të palëve të treta rregullohen nga Rregullorja (KE) nr. 1049/2001 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (1).

Mjetet e ankimit, përgjegjësia dhe penalitetet

Neni 77

E drejta për të paraqitur ankim tek autoriteti mbikëqyrës

1. Pa cenuar mjetet e tjera administrative ose gjyqësore të mbrojtjes, çdo subjekt të dhënash ka të drejtën të bëjë një ankim tek autoriteti mbikëqyrës, veçanërisht në Shtetin Anëtar ose në vendbanimin e tij ose të saj të zakonshëm, vendin e punës ose vendin e shkeljes së pretenduar nëse subjekti i të dhënave është i mendimit që përpunimi i të dhënave personale në lidhje me të e shkel këtë Rregullore.
2. Autoriteti mbikëqyrës ku është paraqitur ankimi njofton ankimuesin mbi progresin dhe rezultatin e ankimit duke përfshirë mundësinë e një mjeti ankimi gjyqësor në pajtim me Nenin 78.

Neni 78

E drejta për një mjet gjyqësor të efektshëm ndaj një autoriteti mbikëqyrës

1. Pa cenuar mjetet e tjera administrative ose jo-gjyqësore të mbrojtjes, secili person fizik ose juridik ka të drejtën e një mjeti gjyqësor të efektshëm ndaj një vendimi ligjërisht detyrues të autoritetit mbikëqyrës në lidhje me të.
2. Pa cenuar mjetet e tjera administrative ose jo-gjyqësore të mbrojtjes, çdo subjekt i të dhënave ka të drejtën e një mjeti gjyqësor të efektshëm nëse autoriteti mbikëqyrës që është kompetent në pajtim me Nenet 55 dhe 56 nuk e trajton një ankim ose nuk e njofton subjektin e të dhënave brenda tre muajve mbi përparimin ose rezultatin e ankimit të paraqitur në pajtim me Nenin 77.
3. Gjykimi ndaj një autoriteti mbikëqyrës fillon para gjykatave të Shtetit Anëtar ku është vendosur autoriteti mbikëqyrës.
4. Nëse gjykimi fillon ndaj një vendim të autoritetit mbikëqyrës, që është paraprirë nga një opinion ose vendim i Bordit në mekanizmin e njëtrajshmërisë, autoriteti mbikëqyrës ia paraqet këtë opinion ose vendim gjykatës.

Neni 79

E drejta për një mjet gjyqësor të efektshëm ndaj një kontrolluesi ose përpunuesi

1. Pa cenuar asnjë mjet të disponueshëm administrativ ose jo-gjyqësor mbrojtjeje, duke përfshirë të drejtën për të paraqitur një ankim tek autoriteti mbikëqyrës në pajtim me Nenin 77, çdo subjekt të dhënash ka të drejtën për një mjet të efektshëm gjyqësor nëse ai ose ajo është i mendimit se të drejtat e tij ose të saj sipas kësaj Rregulloreje janë shkelur si rezultat i përpunimit të të dhënave të tij ose të saj personale në mos-përputhje me këtë Rregullore.
2. Gjykimi ndaj një kontrolluesi ose përpunuesi fillon para gjykatave të Shtetit Anëtar ku

kontrolluesi ose përpunuesi ka një strukturë. Si alternativë, një gjykim i tillë mund të fillohet para gjykatave të Shtetit Anëtar ku subjekti i të dhënave ka vendbanimin e tij ose të saj të zakonshëm, përveç kur kontrolluesi ose përpunuesi është një autoritet publik i një Shteti Anëtar që vepron në ushtrim të kompetencave të tij publike.

Neni 80

Përfaqësimi i subjektit të të dhënave

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të autorizojë një organ, organizatë ose shoqatë jo-fitimprurëse që është krijuar rregullisht në pajtim me të drejtën e një Shteti Anëtar, që ka objektiva ligjore që janë në interesin publik dhe është aktive në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave në lidhje me mbrojtjen e të dhënave të tyre personale të paraqesë një ankim në emër të tij ose të saj, të ushtrojë të drejtat e referuara në Nenet 77, 78 dhe 79 në emër të tij ose të saj dhe të ushtrojë të drejtën për të marrë kompensimin e referuar në Nenin 82 në emër të tij ose të saj nëse parashikuar nga e drejta e Shtetit Anëtar.
2. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që çdo organ, organizatë ose shoqatë e referuar në paragrafin 1 të këtij Neni, pavarësisht nga autorizimi i subjektit të të dhënave të ketë të drejtën të paraqesë, në atë Shtet Anëtar, një ankesë tek organi mbikëqyrës që është kompetent në pajtim me Nenin 77 dhe të ushtrojë të drejtat e referuara në Nenet 78 dhe 79 nëse është e mendimit që të drejtat e një subjekti të dhënash sipas kësaj Rregulloreje janë shkelur si rezultat i përpunimit.

Neni 81

Pezullimi i gjykimit

1. Nëse një gjykatë kompetente e një Shteti Anëtar ka informacion për një gjykim në lidhje me të njëjtën çështje në lidhje me përpunimin nga i njëjti kontrollues ose përpunues, që ka filluar në gjykatë në një Shtet tjetër Anëtar, ajo kontakton atë gjykatë në Shtetin tjetër Anëtar për të konfirmuar ekzistencën e një gjykimi të tillë.
2. Nëse ka filluar gjykimi në lidhje me të njëjtën çështje për sa i takon përpunimit të të njëjtin kontrollues ose përpunues në një gjykatë në një Shtet tjetër Anëtar, çdo gjykata kompetente e ndryshme nga gjykata e investuar fillimisht mund të pezullojë gjykimin.
3. Nëse ky gjykim ka filluar në shkallë të parë, çdo gjykata e ndryshme nga gjykata e investuar fillimisht, me kërkesë të një prej palëve mund të deklarojë mungesën e juridiksionit nëse gjykata e investuar fillimisht ja juridiksion për çështjet në fjalë dhe e drejta e saj e lejon konsolidimin e saj.

Neni 82

E drejta për kompensim dhe përgjegjësia

1. Çdo person i cili ka pësuar dëm material ose jo-material si rezultat i një shkeljeje të kësaj Rregulloreje ka të drejtë të marrë kompensim nga kontrolluesi ose përpunuesi për dëmin e pësuar.
2. Çdo kontrollues i përfshirë në përpunim është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga përpunimi që shkel këtë Rregullore. Një përpunues është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga

përpunimi vetëm nëse ai nuk ka përmbushur detyrimet e kësaj Rregulloreje veçanërisht drejtuar përpunuesve ose nëse ka vepruar tej ose në kundërshtim me udhëzimet e ligjshme të kontrolluesit.

3. Një kontrollues ose përpunues përjashtohet nga përgjegjësia sipas paragrafit 2 nëse ai provon që ai nuk është në asnjë mënyrë përgjegjës për dëmin.

4. Nëse është përfshirë më shumë se një kontrollues ose përpunues, ose një kontrollues dhe një përpunues në të njëjtin përpunim dhe nëse ata sipas paragrafëve 2 dhe 3, janë përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar nga përpunimi, secili kontrollues ose përpunues mbahet përgjegjës për të gjithë dëmin me qëllim që të garantohet kompensim i efektshëm i subjektit të të dhënave.

5. Nëse një kontrollues ose përpunues, në pajtim me paragrafin 4, ka paguar kompensim të plotë për dëmin e pësuar, ky kontrollues ose përpunues ka të drejtën të pretendojë nga kontrolluesit ose përpunuesit e tjerë të përfshirë në të njëjtin përpunim atë pjesë të kompensimit që përputhet me pjesën e tyre të përgjegjësisë për dëmin, në pajtim me kushtet e parashikuara në paragrafin 2.

6. Procedimi gjyqësor për ushtrimin e së drejtës për të përftuar kompensimin fillohet para gjykatave kompetente sipas ligjit të Shtetit Anëtar të referuar në Nenin 79(2).

Neni 83

Kushte të përgjithshme për caktimin e gjobave administrative

1. Çdo autoritet mbikëqyrës garanton ë caktimi i gjobave administrative në pajtim me këtë Nen në lidhje me shkeljet e kësaj Rregulloreje të referuar në paragrafët 4, 5 dhe 6 në çdo rast konkret është i efektshëm, proporcional dhe pengues.

2. Gjobat administrative, në varësi të rrethanave të çdo rasti individuale, vendosen si shtesë ose në vend të masave të referuara në pikat (a) deri (h) dhe (j) të nenit 58(2). Në momentin e vendimmarrjes nëse do të vendoset gjobë administrative dhe vendimmarrjes për shumën e gjobës administrative në çdo rast individual vëmendje e duhur i kushtohet sa më poshtë:

(a) natyrës, rëndësisë dhe kohëzgjatjes së shkeljes duke marrë parasysh natyrën, objektin ose qëllimin e përpunimit përkatës si dhe numrin e subjekteve të të dhënave të prekur dhe nivelin dëmit të pësuar prej tyre;

(b) karakteri të qëllimshëm dhe neglizhent të shkeljes;

(c) çdo masë të marrë nga kontrolluesi ose përpunuesi për të lehtësuar dëmin e pësuar nga subjektet e të dhënave;

(d) Shkallës së përgjegjësisë së kontrolluesit ose përpunuesit duke marrë parasysh masat teknike dhe organizative të zbatuara prej tyre në pajtim me Nenet 25 dhe 32;

(e) çdo shkelje të mëparshme përkatëse nga kontrolluesi ose përpunuesi;

(f) shkallës së bashkëpunimit me autoritetin mbikëqyrës me qëllim që të korrigjohet shkelja dhe zbutur efektet negative të mundshme të shkeljes;

(g) kategorive të të dhënave personale të ndikuara nga shkelja;

(h) mënyrës në të cilën shkelja erdhi në dijeni të autoritetit mbikëqyrës, veçanërisht, nëse dhe në cilën masë kontrolluesi ose përpunuesi njoftuan shkeljen;

(i) nëse masat e referuara në Nenin 58(2) janë urdhëruar më parë ndaj kontrolluesit ose përpunuesit përkatës në lidhje me të njëjtën çështje, respektimit të këtyre masave;

(j) respektimi i kodeve të aprovuara të sjelljes në pajtim me Nenin 40, mekanizmat e aprovuara të certifikimit në pajtim me Nenin 42; dhe

(k) çdo faktori tjetër rëndues ose lehtësues për rrethanat e çështjes, si përfitimet financiare të përfutuara ose humbjeve të mënjanuara, drejtpërdrejtë ose jo nga shkelja.

3. Nëse një kontrollues ose përpunues, në mënyrë të qëllimshme ose neglizhencë, për të njëjtat operacione ose të lidhura me to, shkel disa dispozita të kësaj Rregulloreje, shuma totale e gjobës administrative nuk kalon shumë e specifikuar për shkeljen më të rëndë.

4. Shkeljet e dispozitave të mëposhtme, në pajtim me paragrafin 2, u nënshtrohen gjobave administrative deri në 10 000 000 Euro ose në rastin e një ndërmarrjeje deri në 2% të xhiros të përgjithshme vjetore botërore të vitit financiar pararendës, cilado ë të jetë më i lartë:

(a) detyrimet e kontrolluesit dhe përpunuesit në pajtim me Nenet 8, 11, 25 deri 39 dhe 42 dhe 43;

(b) detyrimet e organit të certifikimit në pajtim me Nenet 42 dhe 43;

(c) detyrimet e organit të monitorimit në pajtim me Nenin 41(4).

5. Shkeljet e dispozitave të mëposhtme, në pajtim me paragrafin 2, u nënshtrohen gjobave administrative deri në 20 000 000 Euro ose në rastin e një ndërmarrjeje deri në 4% të xhiros të përgjithshme vjetore botërore të vitit financiar pararendës, cilado ë të jetë më i lartë:

(a) parimet bazë për përpunimin, duke përfshirë kushtet për pëlqimin, në pajtim me Nenet 5, 6 7 dhe 9;

(b) të drejtat e subjekteve të të dhënave në pajtim me Nenet 12 dhe 22;

(c) transferimet e të dhënave personale tek një marrë në një vend të tretë ose organizatë ndërkombëtare në pajtim me Nenet 44 deri 49;

(d) çdo detyrim në pajtim me të drejtën e Shtetit Anëtar të miratuar sipas Kapitullit IX;

(e) Mosrespektimi i një urdhri ose një kufizimi të përkohshëm ose të përhershëm për përpunimin ose pezullimin e fluksit të të dhënave nga autoriteti mbikëqyrës në pajtim me Nenin 58(2) ose mosdhënie aksesit në shkelje të Nenit 58(1).

6. Mosrespektimi i një urdhri nga një autoritet mbikëqyrës sipas referimit në Nenin 58(2), në pajtim me paragrafin 2 të këtij Neni, u nënshtrohen gjobave administrative deri në 20 000 000 Euro ose në rastin e një ndërmarrjeje deri në 4% të xhiros të përgjithshme vjetore botërore të vitit financiar pararendës, cilado ë të jetë më i lartë.

7. Pa cenuar kompetencat korigjuese të autoriteteve mbikëqyrëse në pajtim me Nenin 58(2), çdo Shtet Anëtar mund të përcaktojë rregullat nëse dhe në cilën masë gjobat administrative mund të vendosen për autoritetet publike he organet e ngritura në atë Shtet Anëtar.

8. Ushtrimi i kompetencave sipas këtij Neni nga autoriteti mbikëqyrës u nënshtrohet garancive të duhura procedurale në pajtim me të drejtën e Bashkimit dhe Shtetit Anëtar, duke përfshirë mjetet mbrojtëse gjyqësore dhe procesin e rregullt.

9. Nëse sistemi ligjor i Shtetit Anëtar nuk parashikon gjoba administrative, ky Nen mund të zbatohet në atë mënyrë që gjoba të fillohet nga autoriteti mbikëqyrës kompetent dhe të vendoset nga gjykatat kombëtare kompetente, duke siguruar që këto mjete gjyqësore të jenë të efektshme dhe të kenë një efekt të barasvlershëm me gjobat administrative të vendosura nga autoritetet mbikëqyrëse. Në çdo rast, gjobat e caktuara duhet të jenë efektive, proporcionale dhe penguese. Këto Shtete Anëtare i njoftojnë Komisionit dispozitat e së drejtës së vet që ata i miratojnë në pajtim me këtë paragraf brenda datës 25 maj 2018 dhe, pa vonesë, çdo ligj ndryshues pasues ose ndryshim që prek ato.

1. Shtetet Anëtare caktojnë rregullat për penalitetet e tjera për shkeljet e kësaj Rregulloreje veçanërisht për shkeljet që nuk u nënshtrohen gjobave administrative në pajtim me Nenin 83 dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar që ato të zbatohen. Këto penalitete duhet të jenë efektive, proporcionale dhe penguese.

2. Secili Shtet Anëtar i njofton Komisionit dispozitat e së drejtës së vet që ai i miraton në pajtim me paragrafin 1 brenda datës 25 maj 2018 dhe, pa vonesë, çdo ndryshim pasues që prek ato.

KAPITULLI IX

Dispozitat në lidhje me situatat e përpunimit specifik

Neni 85

Përpunimi dhe liria dhe shprehjes dhe informacionit

1. Shtetet Anëtare mund të harmonizojnë me ligj të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale në pajtim me këtë Rregullore me të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informimit, duke përfshirë përpunimin për qëllime gazetareske dhe qëllimet e shprehjes akademike, artistike ose letrare.

2. Për përpunimin e kryer për qëllime gazetareske ose për qëllime të shprehjes akademike, artistike ose letrare, Shtetet Anëtare parashikojnë përjashtime ose shmangie nga Kapitulli II (parimet), Kapitulli III (të drejtat e subjektit të të dhënave), Kapitulli IV (kontrolluesi dhe përpunuesi), Kapitulli V (transferimi i të dhënave personale tek vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare), Kapitulli VI (autoritete mbikëqyrëse të pavarura), Kapitulli VII (bashkëpunimi dhe njëtrajtshmëria) dhe Kapitulli IX (situata specifike të përpunimit të të dhënave) nëse ato janë të nevojshme për të harmonizuar të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale me lirinë e shprehjes dhe informacionit.

3. Secili Shtet Anëtar i njofton Komisionit dispozitat e së drejtës së vet që ai ka miratuar në pajtim me paragrafin 2 dhe, pa vonesë, çdo ligj ndryshues të mëvonshëm ose ndryshim që prek ato.

Neni 86

Përpunimi dhe aksesit publik tek dokumentet zyrtare

Të dhënat personale në dokumentet zyrtare që mbahen nga një autoritet publik ose organ publik ose një organ privat për përmbushjen e një detyre që kryhet në interesin publik mund të deklarohen nga autoriteti ose organi në pajtim me të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar të cilit i nënshtrohet autoriteti ose organi publik për të harmonizuar aksesin publik tek dokumentet zyrtare me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale në pajtim me këtë Rregullore.

Neni 87

Përpunimi i numrit kombëtar të identifikimit

Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë më tej kushtet specifike për përpunimin e një numrin kombëtar identifikimi ose çdo identifikues tjetër i zbatimit të përgjithshëm. Në këtë rast numri kombëtar i identifikimit ose një identifikues tjetër i zbatimit të përgjithshëm përdoret vetëm me garancitë e përshtatshme për t dejat dhe liritë e të dhënave në pajtim me këtë Rregullore.

Përpunimi në kontekstin e punësimit

1. Shtetet Anëtare, me ligj ose marrëveshje kolektive, mund të parashikojnë rregulla specifike për të garantuar mbrojtjen e të drejtave dhe lirive në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e punësimit, veçanërisht për qëllimet e rekrutimit, përmbushjen e kontratës së punësimit, duke përfshirë përmbushjen e detyrimeve të parashikuara me ligj ose nga marrëveshjet kolektive, menaxhimin, planifikimin dhe organizimin e punës, barazinë dhe diversitetin në vendin e punës, shëndetin dhe sigurinë në punë, mbrojtjen e pronës së punëdhënësit ose klientit dhe për qëllimet e ushtrimit dhe gëzimit, në bazë kolektive dhe individuale, të të drejtave dhe përfitimeve në lidhje me punësimin dhe për qëllimet e prishjes së marrëdhënies së punësimit.
2. Këto rregulla përfshijnë masa të përshtatshme dhe specifike për të garantuar dinjitetin njerëzor të subjektit të të dhënave, interesat legjitime dhe të drejtat themelore, duke pasur konsideratë të veçantë për transparencën e përpunimit, transferimin e të dhënave personale brenda grupit të ndërmarrjeve ose grupit të ndërmarrjeve të angazhuara në një aktivitet ekonomik të përbashkët dhe sistemet e monitorimit në vendin e punës.
3. Secili Shtet Anëtar i njofton Komisionit dispozitat e së drejtës së vet që ai i miraton në pajtim me paragrafin 1 brenda datës 25 maj 2018 dhe, pa vonesë, çdo ndryshim pasues që prek ato.

Neni 89

Garancitë dhe shmangiet në lidhje me përpunimin për qëllime arkivimi në interesin publik, qëllime të kërkimit shkencor ose historik ose qëllime statistikore

1. Përpunimi për qëllime arkivore në interes publik, qëllime të kërkimit shkencor ose historik ose qëllime statistikore, u nënshtrohet garancive të përshtatshme, në pajtim me këtë Rregullore, për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave. Këto garanci sigurojnë masat teknike dhe organizative që janë në fuqi veçanërisht për të garantuar respektimin e parimit të minimizimit të të dhënave. Këto masa mund të përfshijnë anonimizimin me kusht që këto qëllime të përmbushen në këtë mënyrë. Nëse këto qëllime mund të përmbushen nëpërmjet përpunimit të mëtejshëm që nuk lejon ose nuk vazhdon të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave, këto qëllime përmbushen në atë mënyrë.
2. Nëse të dhënat personale përpunohen për qëllime të kërkimeve shkencore ose historike ose qëllime statistikore, e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar mund të parashikojë shmangie nga të drejtat e referuara në nenet 15, 16, 18 dhe 21, në pajtim me kushtet dhe garancitë e referuara në paragrafin 1 të këtij neni në masën që këto të drejta mund të bëjnë të pamundur ose të dëmtojnë thelbësisht arritjen e qëllimeve specifike dhe këto shmangie janë të nevojshme për arritjen e atyre qëllimeve.
3. Nëse të dhënat personale përpunohen për qëllime arkivore në interesin publik, e drejta e Bashkimit ose e Shtetit Anëtar mund të parashikojë shmangie nga të drejtat e referuara në nenet 15, 16, 18, 19, 20 dhe 21, në pajtim me kushtet dhe garancitë e referuara në paragrafin 1 të këtij neni në masën që këto të drejta mund të bëjnë të pamundur ose të dëmtojnë thelbësisht arritjen e qëllimeve specifike dhe këto shmangie janë të nevojshme për arritjen e atyre qëllimeve.
4. Nëse përpunimi i referuar në paragrafët 2 dhe 3 shërben në të njëjtën kohë për një qëllim tjetër, shmangiet zbatohen vetëm për përpunimin për qëllimet e referuara në ato paragrafë.

Detyrimi i fshehtësisë

1. Shtetet Anëtare mund të miratojnë rregulla specifike për të përcaktuar kompetencat e autoriteteve mbikëqyrëse të parashikuara në pikat (e) dhe (f) të Neneve 58(1) në lidhje me kontrolluesit ose përpunuesit që, në pajtim me të drejtën e Bashkimit ose Shtetit Anëtar ose rregullave të përcaktuara nga organet kompetent kombëtare, i nënshtrohen një detyrimi të fshehtësisë profesionale ose detyrimeve të tjera të barasvlershme të fshehtësisë nëse kjo është e nevojshme dhe proporcionale për të harmonizuar të drejtën e mbrojtjes së të drejtëve personal me detyrimin e fshehtësisë. Këto rregulla zbatohen vetëm në lidhje me të dhënat personale që kontrolluesi ose përpunuesi ka marrë si rezultat ose ka përfutur në aktivitetin e mbuluar nga ai detyrim i fshehtësisë.
2. Secili Shtet Anëtar i njofton Komisionit rregullat e miratuara në pajtim me paragrafin 1 brenda datës 25 maj 2018 dhe pa vonesë, çdo ndryshim pasues që prek ato.

Neni 91

Rregullat ekzistuese të mbrojtjes së të dhënave të kishave dhe shoqatave fetare

1. Nëse në një Shtet Anëtar, kishat dhe shoqatat ose komunitetet fetare zbatojnë, në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, rregulla të gjithëpërfshirës në lidhje me mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin, këto rregulla mund të vazhdojnë të zbatohen, me kusht që ata sillen në pajtim me këtë Rregullore.
2. Kishat dhe shoqatat fetare që zbatojnë rregulla gjithëpërfshirëse në pajtim me paragrafin 1 të këtij Neni i nënshtrohen mbikëqyrës së një autoriteti mbikëqyrës të pavarur, që mund të jenë specifik, me kusht që ai të përmbushë kushtet e parashikuara në Kapitullin VI të kësaj Rregulloreje.

KAPITULLI X

Aktet e deleguara dhe aktet zbatuese

Neni 92

Ushtrimi i delegimit

1. Tagri për të miratuara aktet e deleguara i caktohet Komisionit në pajtim me kushtet e parashikuara në këtë Nen.
2. Delegimi i tagrit të përmendur në Nenin 12(8) dhe Nenin 43(8) i caktohet Komisionit për një periudhë të pakufizuar kohe nga data 24 maj 2016.
3. Delegimi i tagrit të përmendur në Nenin 12(8) dhe Nenin 43(8) mund të revokohet në çdo kohë nga Parlamenti Evropian ose nga Këshilli. Një vendim revokimi e pushon delegimin e tagrit të specifikuar në atë vendim. Ai hyn në fuqi në ditën pas atij të publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian ose në një datë të mëvonshme të specifikuar në të. Ai nuk cenon vlefshmërinë e asnjë akti të deleguar që është në fuqi.

4. Menjëherë pas miratimit të një akti të deleguar, Komisioni ia njofton atë njëkohësisht Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

5. Një akt i deleguar i miratuar në pajtim me Nenin 12(8) dhe Nenin 43(8) hyn në fuqi vetëm nëse nuk është shprehur asnjë kundërshtim nga Parlamenti Evropian ose Këshilli brenda një periudhe prej tre muajsh nga njoftimi i atij akti Parlamentit Evropian dhe Këshillit ose, nëse para skadimit të këtij afati, Parlamenti Evropian dhe Këshilli kanë vënë së bashku në dijeni Komisionin që ata nuk do të bëjnë kundërshtim. Ky afat mund të zgjatet me tre muaj me iniciativën e Parlamentit Evropian ose të Këshillit.

Neni 93

Procedura e komitetit

1. Komisioni mbështetet nga një komitet. Komiteti është një komitet në kuptimin e Rregullores (BE) Nr 182/2011.
2. Nëse bëhet referencë në këtë paragraf, zbatohet Neni 5 i Rregullores (BE) Nr 182/2011.
3. Nëse bëhet referencë në këtë paragraf, zbatohet Neni 8 i Rregullores (BE) Nr 182/2011 në lidhje me Nenin 5 të saj.

KAPITULLI XI

Dispozita të fundit

Neni 94

Shfuqizimi i Direktivës 95/46/KE

1. Direktiva 95/46/KE shfuqizohet me fuqi nga data 25 maj 2018.
2. Referencat tek Direktiva e shfuqizuar interpretohen të jenë referencat tek kjo Rregullore. Referencat tek Pala e Punës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale të ngritur nga Neni 29 të Direktivës 95/46/KE interpretohet si referencë tek Bordi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave të ngritur nga kjo Rregullore.

Neni 95

Marrëdhënia e Direktivën 2002/58/KE

Kjo Rregullore nuk vendos detyrime shtesë për personat fizikë ose juridikë në lidhje me përpunimin në lidhje me dhënien e shërbimeve të ofruara publikisht të komunikimeve elektronike në rrjetet publike të komunikimit në Bashkim në lidhje me çështjet për të cilat u nënshtrohen detyrimeve specifike për të njëjtin objektiv të caktuar nga Direktiva 2002/58/KE.

Neni 96

Marrëdhënia me Marrëveshjet e lidhura më parë

Marrëveshjet ndërkombëtare që përfshijnë transferimin e të dhënave personale tek vendet e tretë ose organizatat ndërkombëtare që janë lidhur nga Shtetet Anëtare para datës 24 maj 2016 dhe që janë në pajtim me të drejtën e Bashkimit sipas rastit para kësaj date, mbetet në fuqi deri sa të ndryshohen, zëvendësohen ose revokohen.

Neni 97

Raportet e Komisionit

1. Deri në datën 25 maj 2020 dhe pas kësaj një herë në katër vjet, Komisioni paraqet një raport mbi vlerësimin dhe rishikimin e kësaj Rregulloreje për Parlamentin Evropian dhe Këshillin. Raportet bëhen publikë.
2. Në kontekstin e vlerësimeve dhe rishikimeve të përmendura në paragrafin 1 Komisioni shqyrton, veçanërisht, zbatimin dhe funksionimin e:
 - (a) Kapitullit V mbi transferimin e të dhënave personale tek vendet e tretë ose organizatat ndërkombëtare veçanërisht vendimet e miratuara në pajtim me Nenin 45(3) të kësaj Rregulloreje dhe vendet e miratuara mbi bazën e Nenit 25(6) të Direktivës 95/46/KE.
 - (b) Kapitullit VII mbi bashkëpunimin dhe njëtrajtshmërinë.
3. Për qëllimet e paragrafit 1, Komisioni mund të kërkojë informacion nga Shtetet Anëtare dhe autoritetet mbikëqyrëse.
4. Në kryerjen e vlerësimeve dhe rishikimeve të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të Komisioni merr parasysh pozicionet dhe konstatimet e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe të organeve ose burimeve të tjera përkatëse.
5. Komisioni, sipas rastit, paraqet propozime të përshtatshme për të ndryshuar këtë Rregullore, veçanërisht duke marrë parasysh zhvillimet në teknologjinë e informacionit dhe në dritën e gjendjes së përparimit të shoqërisë së informacionit.

Neni 98

Rishikimi i akteve ligjore të Bashkimit për mbrojtjen e të dhënave

Komisioni, sipas rastit, paraqet propozime legjislativë me synim ndryshimin e akteve ligjore të tjerë të Bashkimit mbi mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim që të garantohet mbrojtja e njëtrajtshme dhe uniforme e personave fizikë në lidhje me përpunimin. Kjo ka të bëjë veçanërisht me rregullat në lidhje me mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit dhe mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave.

Neni 99

Hyrja në fuqi dhe zbatimi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e njëzetë pas asaj të botimit të Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.
2. Ajo zbatohet duke filluar nga data 25 maj 2018.

Kjo Rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjithë Shtetet Anëtare. Bërë në Bruksel, më 27 prill 2016.

Për Parlamentin Evropian

Presidenti

M. SCHULZ

Për Këshillin

Presidenti

J.A. HENNIS-PLASSCHAERT

- 1) GZ C 229, 31.7.2012, f. 90.
- 2) GZ C 391, 18.12.2012, f. 127.
- 3) Pozicioni i Parlamentit Evropian i datës 12 mars 2014 (i pabotuar akoma në Gazetën Zyrtare) dhe pozicioni i Këshillit në leximin e parë të datës 8 prill 2016 (i pabotuar akoma në Gazetën Zyrtare), Pozicioni i Parlamentit Evropian i datës 14 prill 2016
- 4) Direktiva 95/46/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 tetor 1995 mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave (GZ L 281 23.11.1995, f 31).
- 5) Rekomandim i Komisionit të datës 6 maj 2003 në lidhje me përkufizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla ose të mesme (C(2003) 1422) (OJ L 124, 20.5.2003, f. 36).
- 6) Rregullorja (EC) Nr 45/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 18 dhjetor 2000 mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet dhe organet e Komunitetit dhe mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave (GZ L 8 12.1.2001, f 1).
- 7) Direktiva (BE) 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 27 prill 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllimin e parandalimit, hetimit, zbulimit dhe ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe që shfuqizon Vendimin Kuadër të Këshillit 2008/977/IHA (shih faqen 89 të kësaj Gazete Zyrtare).
- 8) Direktiva 2000/31/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 8 qershor 2000 mbi aspekte të caktuara ligjore të shërbimeve të shoqërisë së informacionit veçanërisht tregtinë elektronike në Tregun e Brendshëm ('Direktiva mbi tregtinë elektronike') (GZ L 178, 17.7.2000, f. 1).
- 9) Direktiva 2011/24/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 9 mars 2011 mbi zbatimin e të drejtave të pacientëve në kujdesin shëndetësor ndër-kufitar (GZ L 88, 4.4.2011, f 45).
- 10) Direktiva e Këshillit 93/13/EEC e datës 5 prill 1993 mbi kushtet e padrejta në kontratat me konsumatorët (GZ L 95, 21.4.1993, f. 29).
- 11) Rregullore (EC) Nr 1338/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 dhjetor 2008 mbi statistikat komunitare mbi shëndetin publik dhe shëndetin dhe sigurinë në punë (GZ L 354, 31.12.2008 f. 70).
- 12) Rregullore (BE) Nr 182/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 16 tetor 2011

e cila përcakton rregullat dhe parimet e përgjithshme në lidhje me mekanizmat e kontrollit nga Shtetet Anëtare të ushtrimit të kompetencave zbatuese të Komisionit (GZ L 55, 28.2.2011, f. 13).

13) Rregulloja (BE) Nr 1215/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 12 dhjetor 2012 mbi juridiksionin dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në çështjet Civile dhe tregtare (GZ L 351, 20.12.2012, f. 1).

14) Direktiva 2003/98/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 nëntor 2003 mbi ripërdorimin e informacionit të sektorit publik (GZ L 345, 31.12.2003, f 90).

15) Rregullore (BE) Nr 536/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 prill 2014 mbi kërkimet klinike mbi produktet mjekësore për përdorim njerëzor dhe anulimin e Direktivës 2001/20/KE (GZ L 158, 27.5.2014, f. 1).

16) Rregullorja (EC) Nr 223/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2009 mbi statistikat evropiane dhe që shfuqizon Rregulloren (KE Euroatom) Nr 1101/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi transmetimin e të dhënave që i nënshtrohen konfidencialitetit statistikor në Zyrën Statistike të Komuniteteve Evropiane, Rregullore e Këshillit (KE) Nr 322/97 mbi Statistikat Komunitare dhe Vendimin e Këshillit 89/382/KEE Euroatom që ngre një Komitet mbi Programet Statistike të Komuniteteve Evropiane (GZ L 87, 31.3.2009, f. 164).

17) GZ C 192, 30.6.2012, f. 7.

18) Direktiva 2002/58/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 12 korrik 2002 në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimit elektronik) (GZ L 201, 31.7.2002, f. 37).

19) Direktiva (BE) 2015/1535 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 9 shtator 2015 që përcakton procedurën për dhënien e informacionit në fushën e rregullimeve teknike dhe të rregullave mbi shërbimet e Shoqërisë së Informacionit (GZ L 241, 17.9.2015, f. 1).

20) Rregullore (KE) Nr 765/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 korrik 2008 që cakton kërkesat për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut në lidhje me marketingun e produkteve dhe anulimin e Rregullores (KEE) Nr 339/93 (GZ L 218, 13.8.2008, f. 30).

21) Rregullore (EC) Nr 1049/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 30 maj 2001 mbi aksesin publik tek dokumentet e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit. (GZ L 145, 31.5.2001 f. 43).